



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

(1) MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

- dhe -

(2) ANËTARËT E BASHKIMIT TË SHOQERIVE TË PËRZGJEDHUR

**MABCO CONSTRUCTIONS SA,
YDA INSAAT SANAYI VE TICARET ANONIM SIRKETI,
2A GROUP SH.P.K.**

- dhe -

SHOQËRIA KONCESIONARE

**KONTRATË KONCESIONI/PPP
PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN,
OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE
TRANSFERIMIN E AEROPORTIT
NDËRKOMBËTAR TË VLORËS
(VIA)**



KJO KONTRATË PËR DHËNIEN ME KONCESION/PPP PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË VLORËS (VIA) lidhet më 20 prill 2021

NDËRMJET:

- (1) **MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**, përfaqësuar nga Znj. Belinda Balluku , në cilësinë e ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën ("**Autoriteti Kontraktues**"); dhe
- (2) Konsorciumi i krijuar në përputhje me marrëveshjen datë 23.12.2020, nr 48897 dhe i përbërë nga shoqëritë: **MABCO CONSTRUCTIONS SA**, një shoqëri e organizuar sipas ligjeve të Zvicrës, me adresë të regjistruar në Via Cattori 7, Lugano Paradiso, 6900, Zvicër, dhe e përfaqësuar rregullisht me prokurë nr [] nga Z. Valon Lluka ("**Mabetex**"),

YDA INSAAT SANAYI VE TICARET ANONIM SIRKETI, një shoqëri e organizuar sipas ligjeve të Turqisë, me numër identifikimi të subjektit 92203, me adresë të regjistruar në Kizilirmak Mahallesi Dumlupinar Bulvari, No: 9A Içkapi No: 90, Çankaya, Ankara, Turqi, dhe e përfaqësuar rregullisht nga Valon Lluka ("**YDA**"), dhe

2A GROUP SH.P.K, një shoqëri e organizuar sipas ligjeve të Kosovës, me numër unik identifikimi 810846800, me adresë të regjistruar në rrugën Hyzri Talla, Bregu i Diellit, Kosovë,], dhe e përfaqësuar rregullisht me prokurë të posaçme nr rep. 812, kol. 221, datë 19.04.2021 nga Z. Valon Lluka ("**2A Group**");

(së bashku, "**Ofertuesit**");

- (3) [] , një shoqëri e organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli të regjistruar në [◆], dhe e përfaqësuar rregullisht nga [◆], në cilësinë eshoqërisë koncesionare të themeluar në përputhje me nenin 2.3 të kësaj Kontrate ("**Koncesionari**").

DUKE QENË SE:

- A Në përputhje me Ligjin nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 10.07.2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënie me koncesion /partneritet publik privat", i ndryshuar, Rregullores së Ministrit të Transportit Nr.130 datë 09.11.2012 "Për certifikimin dhe regjistrimin e Aerodromeve", Dokumenteve të Tenderit, Urdhërit nr. 440, datë 27.11.2019, Autoriteti Kontraktues ngrii komisionin për hartimin e dokumenteve të procedurës konkurruese ("**Dokumentet e Tenderit**") për dhënie me koncesion/PPP "Për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA) nga Koncesionari te AK" ("**Projekti**").
- B Më 19 dhjetor 2019, Autoriteti Kontraktues shpalli procedurën konkurruese duke ftuar ofertuesit të dorëzojnë ofertat e tyre për Projektin, dhe më 1 mars 2021 Ofertuesit paraqitën një ofertë detyruese për Projektin së bashku me dokumentet e tjera ("**Oferta**").
- C Komisioni i Autoritetit Kontraktues për dhënie me koncesion të Projektit përcaktoi Ofertuesit si ofertuesin fitues për Projektin dhe Autoriteti Kontraktues i dha të drejtën Ofertuesve të bëhen palë e kësaj kontrate për dhënie me koncesion të Projektit ("**Kontrata**").
- D Autoriteti Kontraktues i ka kthyer Ofertuesve sigurimin e Ofertës dhe Ofertuesit i kanë dorëzuar Autoritetit Kontraktues Sigurimin e Kontratës (siç është përkufizuar më poshtë), në përputhje me Dokumentet e Tenderit.

PËRMBAJTJA

1.	PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME	3
2.	DATA E NËNSHKRIMIT, DATA EFEKTIVE DHE KUSHTET PARAPRAKE.....	15
3.	AFATI.....	18
4.	DHËNIA E TË DREJTAVE TË PROJEKTIT	18
5.	TARIFA KONCESIONARE	19
6.	TARIFAT.....	19
7.	VENDNDODHJA DHE ASETET E AEROPORTIT.....	20
8.	INXHINIERI I PAVARUR	22
9.	DEKLARIMET DHE GARANCITË E PALËVE.....	24
10.	DETYRIMET E KONCESIONARIT	25
11.	DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES.....	42
12.	NGJARJA E FORCËS MADHORE.....	46
13.	VEPRIMI MATERIAL I PAFAVORSHËM QEVERITAR	48
14.	SIGURIMI.....	49
15.	ZGJIDHJA E KONTRATËS	49
16.	DËMSHPËRBLIMI	55
17.	DORËZIMI	57
18.	KUFIZIMET E TRANSFERIMIT TEK KONCESIONARI	63
19.	TRANSFERIMI, KALIMI DHE ZËVËNDËSIMI.....	64
20.	HEQJA DORË NGA IMUNITETI.....	65
21.	ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE	65
22.	LIGJI RREGULLUES	66
23.	NJOFTIMET	66
24.	DISPOZITA TË NDRYSHME.....	67
	LISTA E SHTOJCAVE	71



ËSHTË RËNË DAKORD:

1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

1.1 Termat e mëposhtëm dhe shprehjet e përdorura në këtë Kontratë kanë kuptimet përkatëse si më poshtë:

"2A Group" ka kuptimin e dhënë në pjesën hyrëse të kësaj Kontrate;

"Aerodrom" nënkupton një zonë të përcaktuar (duke përfshirë çdo ndërtesë, instalim, dhe pajisje) në tokë ose mbi ujë, ose mbi një strukturë fikse në tokë, fikse në det, ose strukturë lundruese që do të përdoret tërësisht ose pjesërisht për mbërritjen, nisjen dhe lëvizjen e Avionëve mbi sipërfaqe;

"Aeroport" nënkupton një Aerodrom me aktivitet dhe facilitet të zgjeruar, kryesisht për transport ajror tregtar;

"Afati" ka kuptimin e dhënë në nenin 3.1;

"Afati i Fundit" ka kuptimin e dhënë në nenin 2.5;

"Albcontrol" nënkupton shoqërinë që menaxhon dhe kontrollon hapësirën ajrore shqiptare (FIR), në përputhje me standartet ndërkombëtare të lundrimit ajror, ose çdo pasardhës i tij;

"Anketa e Pasagjerëve" do të thotë anketa e pasagjerëve, e cila i bashkëlidhet Marrëveshjes së Anketës së Pasagjerëve;

"Anketuesi i Pasagjerëve" nënkupton një shoqëri e tretë anketuese, e pavarur dhe jo e lidhur me Koncesionarin, dhe e kualifikuar dhe me reputacion, për të kryer dhe administruar në mënyrë të pavarur, pa u ndikuar anketimin e pasagjerëve, bashkëlidhur Marrëveshjes së Anketimit të Pasagjerëve.

Të "Ardhurat Bruto" nënkupton për çdo vit kalendarik ose pjesë të tij, shumën e të ardhurave të mëposhtme:

- a) të gjitha të ardhurat bruto nga Shërbimet Aeroportuale dhe Shërbimet Tregtare;
- b) të gjitha të ardhurat nga policat e sigurimit;
- c) çdo lloj tjetër të ardhurash bruto të depozituara në Llogarinë Bankare, duke përfshirë edhe të ardhurat nga pagesa e Garancisë së të Ardhurave sipas nenit 11.3;

Të "Ardhurat Maksimale" ka kuptimin e dhënë në nenin 11.3(a);

Të "Ardhurat Minimale" ka kuptimin e dhënë në nenin 11.3(a);

"Asetet e Aeroportit" do të thotë, në një kohë të caktuar, Pasuritë e të Luajtshme dhe Pasuritë e Paluajtshme;

"Autoriteti i Aviacionit Civil" ose "AAC" nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Shqipërisë, i themeluar me Ligj Nr.10 233, datë 11.2.2010 "Për Autoritetin e



Aviacionit Civil" të ndryshuar, dhe ka autoritetin dhe përgjegjësitë e përshkruara në Ligjin e Zbatueshëm, ose cdo pasardhës i tij;

"**Autoriteti Kompetent**" nënkupton çdo autoritet, ministri, agjenci, inspektorat, departament, gjykatë, gjykatë arbitrazhi, agjenci administrative ose komision, ose ndonjë organ tjetër qeveritar, bashkie, administrativ ose ent rregullator, (në secilin rast deri në masën ku secila nga të mësipërmet ka juridiksion mbi secilën ose të gjitha Palët, këtë Kontratë dhe/ose çështje të kësaj Kontrate);

"**Autoriteti Kontraktues**" ka kuptimin e dhënë në pjesën hyrëse të kësaj Kontrate;

"**Avion**" nënkupton çdo mjet, i cili mund të qëndrojë në atmosferë nga kundërveprimi i ajrit, përveç kundërveprimit të ajrit kundrejt sipërfaqes së tokës;

"**Avion Civil**" nënkupton çdo avion, përjashtuar Avionët Shtetërorë;

"**Avion Shtetëror**" nënkupton Avionët e përdorur nga shërbimet e forcave të armatosura, doganës dhe policisë;

"**Buxheti Operacional**" ka kuptimin e dhënë në nenin 10.53;

"**Certifikata e Aeroportit**" është një dokument i lëshuar nga AAC, e cila dëshmon se Aeroporti plotëson të gjithë standardet dhe kërkesat e lidhura me operimin dhe facilitetet e tij dhe se ai ka aftësinë për t'i përmbushur në vazhdimësi këto standard dhe kërkesat e aplikueshme gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së certifikatës, sipas Legjislacionit të Zbatueshëm;

"**Certifikata e Fillimit të Punimeve**" ka kuptimin e dhënë në nenin 10.3.2;

"**Certifikata e Dorëzimit**" ka kuptimin e dhënë në nenin 17.24;

"**Certifikata e Operimit**" nënkupton certifikatën që Palët nënshkrujnë në Datën e Operimit, në përputhje me Shtojcën 32;

"**Data e Fillimit të Periudhës së Dorëzimit**" nënkupton datën e cila është 180 ditë përpara Datës së pritshme të Mbarimit të Afatit;

"**Data e Fillimit të Punimeve**" ka kuptimin e dhënë në nenin 10.3;

"**Data e Mbarimit të Afatit**" nënkupton datën në cilën Afati i kësaj Kontrate përfundon, në përputhje me nenin 3 të saj;

"**Data e Nënshkrimit**" ka kuptimin e shprehur në nenin 2.1;

"**Data e Operimit**" nënkupton datën që Palët kanë nënshkruar Certifikatën e Operimit, në përputhje me Shtojcën 32; datë e cila nuk mund të jetë më vonë se Data e Synuar e Operimit;

"**Data e Përfundimit të Kontratës**" nënkupton datën më e hershme midis Datës së Mbarimit të Afatit dhe Datës së Zgjidhjes së Parakohshme, e përcaktuar në përputhje me këtë Kontratë;

"**Data e Synuar e Fillimit të Punimeve**" nënkupton datën jo më vonë se 180 ditë nga Data Efektive ose çdo datë tjetër të dakordësuar ndërmjet Palëve me shkrim;



"Data e Synuar e Operimit" nënkupton datën jo më vonë se 36 muaj nga Data e Fillimit të Punimeve ose cdo datë tjetër të dakordësuar ndërmjet Palëve me shkrim;

"Data e Zgjidhjes së Parakohshme" nënkupton datën e zgjidhjes së Kontratës nga secila prej Palëve para Datës së Mbarimit të Afatit, që i njoftohet Palës tjetër në përputhje me nenin 15;

"Data Efektive" ka kuptimin e shprehur në nenin 2.13;

"Defekt" është një defekt i objektit që vjen si rezultat i mospërbushjes sipas standardit të detyrimeve të Koncesionarit;

"Deklarata e Mbylljes" ka kuptimin e shprehur në nenin 2.112;

"Ditë Pune" nënkupton çdo ditë tjetër përveç të shtunës, të dielës ose çdo dite tjetër që bankat duhet të mbyllen sipas rregullave të:

- (a) vendit të biznesit ku Pala është e detyruar të kryejë pagesa; dhe
- (b) vendit ku ndodhet Vendndodhja;

"Dokumentacioni i Autoritetit Kontraktues" nënkupton të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktues me shkrim dhe në mënyrë zyrtare, deri në Datën Efektive ;;

"Dorëzimi" nënkupton dorëzimin dhe transferimin e Gëzimit të Plotë dhe të Qetë të Vendndodhjes, e të gjitha të drejtave mbi Pasuritë e Paluajtshme, të VIA-s dhe të infrastrukturës së VIAS-s dhe të Shërbimeve Aeroportuale dhe Shërbimeve Tregtare tek Autoriteti Kontraktues në përputhje me nenin 17;

"Dorëzimi i Vendndodhjes" nënkupton dorëzimin e territorit të Vendndodhjes nga Autoriteti Kontraktues te Koncesionari, në çdo rast të çliruar nga të gjitha pengesat për të filluar Punimet, apo nga të gjitha pretendimet e palëve të treta për të cilat Autoriteti Kontraktues është përgjegjës.

"Dokumentet e Projektit" ka kuptimin e dhënë në nenin 10.1 të kësaj Kontrate;

"Dokumentet e Tenderit" ka kuptimin e dhënë në klauzolën A të kësaj Kontrate;

"E Drejtë Kalimi" ka kuptimin e dhënë në nenin 7.1(b);

"Emergjenca" nënkupton një rrethanë, situatë, apo ngjarje, siç është rënë dakord në Planin e Manaxhimit të Emergjencave, ku siguria e VIA është në rrezik, apo ku ka një rrezik plagosjeje, vdekjeje, apo dëmtimi të pasurive në Vendndodhje;

"EPC" nënkupton inxhinierinë, prokurimin, dhe ndërtimin;

"Garancia e të Ardhurave" ka kuptimin e dhënë në nenin 11.3 b (b);

"Gëzimi i Plotë dhe i Qetë" ka kuptimin e dhënë në nenin 7.1(a);

"Gjendje Ekzistuese" nënkupton gjendjen e Vendndodhjes para Datës Efektive që ka ardhur si pasojë e:



- a) Pranisë në Vendndodhje të Materialeve të Rrezikshme;
- b) Pranisë në Vendndodhje të sistemeve të infrastrukturës publike;
- c) Pranisë në Vendndodhje të Objekteve Arkeologjike; dhe/ose
- d) Pranisë në Vendndodhje të Objekteve të Trashëgimisë Kulturore;

"**Humbje**" do të thotë çdo dëm, kosto, shpenzime të kryera, pagesa, humbje ose detyrime.

"**IATA**" nënkupton Shoqatën e Transportit Ajror Ndërkombëtar ;

"**ICAO**" nënkupton Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil;

"**Inspektimi Fillestar**" ka kuptimin e dhënë në nenin 17.7;

"**Inspektimi i Dorëzimit**" ka kuptimin e dhënë në nenin 17.24;

"**Pajisjet e Montuara**" do të thotë të gjitha instalimet dhe pajisjet e montuara në, apo mbi terminal, ndërtesë apo struktura të vendosura në Vendndodhje, duke përfshirë pajisje, impiante dhe makineritë, sistemet e transportimit të bagazheve, ashensorë, shkallë lëvizëse, boilerë, sisteme ngrohje apo ftohje qëndrore, aspirimi, ndriçimi, hidraulike, sisteme sanitare, apo spërkatëse, impiante elektrike dhe gjenerimi, dhe pajisje elektronike, por duke mos përfshirë pajisje të kontrollit të trafikut ajror;

"**Institucione Financiare**" nënkupton çdo subjekt ligjor që siguron financimin e borxhit ose rifinancimin e Koncesionarit në kuadër të Projektit dhe për ushtrimin e të Drejtave të Koncesionit, si dhe pasuesit të tyre të lejuar, duke përfshirë çdo agjent ose administrues për një person ose persona të tillë dhe duke përfshirë një aksionar ose filial të një aksionari, në përputhje me Marrëveshjet e Financimit;

"**Inxhinieri i Dorëzimit**" nënkupton inxhinierin apo shoqërinë inxhinierike apo ekspertët e caktuar nga Autoriteti Kontraktues për qëllim të Procesit të Dorëzimit;

"**Inxhinieri i Pavarur**" nënkupton Personin ose Personat e pavarur, të huaj dhe/ose shqiptarë, me përvojë të viteve të fundit në projektimin dhe ndërtimin e Aeroporteve me madhësi dhe karakterisitika të ngjashme me VIA-n, i kontraktuar nga Autoriteti Kontraktues në përputhje me nenin 8.1 të kësaj Kontrate, dhe detyrat kryesore të të cilit janë parashikuar në Shtojcën 7 të kësaj Kontrate;

"**Kapitali Neto**" nënkupton në Datën e Përfundimit të Kontratës një shumë të barabartë me shumën e të gjithë Kontributeve të Kapitalit, të bëra para Datës së Zgjidhjes së Parakohshme, minus shumën e të gjithë Shpërndarjeve të Kapitalit, të bëra para Datës së Zgjidhjes së Parakohshme, me kushtin që nëse kjo diferencë rezulton në një vlerë më të vogël se 0 (zero), atëherë ajo vlerë do të konsiderohet 0 (zero);

"**Kapitali Neto i Rregulluar**" nënkupton në Datën e Përfundimit të Kontratës, një shumë të barabartë me shumën e Vlerës së Rregulluar të të gjithë Kontributeve të Kapitalit, të bëra para Datës së Zgjidhjes së Parakohshme, minus shumën e Vlerës së Rregulluar të të gjithë Shpërndarjeve të Kapitalit, të bëra para Datës së Zgjidhjes së Parakohshme, me kushtin që nëse kjo diferencë rezulton në një vlerë më të vogël se 0 (zero), atëherë ajo vlerë do të konsiderohet 0 (zero);

"**Kërkesat e Dorëzimit**" ka kuptimin e dhënë në nenin 17.10;

"**Kodi Ajror**" nënkupton kodin ajror të miratuar nëpërmjet Ligjit 96/2020 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë";

"**Koncesionar**" nënkupton SPV-në e krijuar dhe njoftuar në përputhje me nenin 2.3(b);

"**Kontrata**" nënkupton këtë Kontratë dhe të gjitha shtojcat e saj, të cilat do të konsiderohen si pjesë përbërëse e saj, me ndryshimet dhe/ose rideklarime herë pas here;

"**Kontributi i Kapitalit**" nënkupton çdo kontribut në para në kapitalin e Koncesionarit dhe çdo borxh apo parapagim i dhënë Koncesionarit nga aksionari/ortaku apo ndonjë Shoqëri e Lidhur me të;

"**Kostot e Rinovimit**" ka kuptimin e dhënë në nenin 17.7;

"**Kriteret e Kualifikimit**" nënkupton kriteret e përcaktuara në shtojcën 9 të Dokumenteve të Tenderit, duke përfshirë eksperiencën përkatëse, kriteret teknike dhe ekonomike;

"**Kushtet e Dorëzimit**" nënkupton përfundimin e suksesshëm të Punimeve të Rinovimit dhe mundësia për t'i dorëzuar Autoritetit Kontraktues një aeroport të kompletuar dhe funksional, i operuar dhe mirëmbajtur në përputhje të plotë me Termat e Referencës, Manualin e Operimit dhe Mirëmbajtjes, dhe në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm dhe me vetë këtë Kontratë;

"**Kushtet Paraprake të Autoritetit Kontraktues**" ka kuptimin që i është dhënë në nenin 2.4;

"**Kushtet Paraprake të Koncesionarit**" ka kuptimin e dhënë në nenin 2.3;

"**Kushtet Paraprake**" nënkupton Kushtet Paraprake të Autoritetit Kontraktues dhe Kushtet Paraprake të Koncesionarit;

"**Legjislacioni i Zbatueshëm**" nënkupton, në lidhje me çdo Palë, çdo akt detyrues ndërkombëtar, çdo dispozitë kushtetuese, ligj, statut, rregull, rregullore, urdhëresë, traktat, urdhër, dekret, vendim, certifikatë, akt, regjistrim, licencë, franchisë, leje, autorizim, udhëzim, Miratim Qeveritar, pëlqim ose kërkesë të një Autoriteti Kompetent që ka juridiksion mbi Palën ose pronën e saj, të zbatueshëm sipas ligjit apo statutit, duke përfshirë interpretimin dhe administrimin e saj nga Autoriteti Kompetent;

"**Lejet dhe Licencat**" nënkupton çdo pëlqim, leje, licencë, autorizim, miratim ose certifikatë, lëshimi ose rinovimi i të cilave është nën përgjegjësinë e ndonjë Autoriteti Kompetent dhe që kërkohet në lidhje me zbatimin e kësaj Kontrate;

"**Llogari Bankare**" nënkupton çdo llogari bankare të Koncesionarit të hapur në një bankë apo institucion financiar, e cila i është komunikuar Autoritetit Kontraktues, në të cilën do të depozitohen të gjitha të Ardhurat Bruto të Koncesionarit, dhe/ose nga e cila Koncesionari kryen çdo pagesë ose transaksion financiar që lidhet në mënyrë direkte ose jo, me Punimet, Shërbimet Aeroportuale, Shërbimet Tregtare, operimin dhe mirëmbajtjen e VIA-s, zgjerimin e terminalit të VIA-s dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet me zbatimin e Projektit;

"**Mabetex**" ka kuptimin e dhënë në pjesën hyrëse të kësaj Kontrate;

"**Manuali i Aeroportit**" nënkupton manualin që do të përfshijë të gjithë informacionin për zonën e zhvillimit të VIA-s, facilitetet, shërbimet, paisjet, procedurat e operimit dhe të

mirëmbajtjes së aerodromit, organizimin dhe menaxhimin, duke përfshirë dhe sistemin e menaxhimit të sigurisë në operim (SMS) sipas aneksit 14 dhe SARP të ICAO;

"Manuali i operimit dhe mirëmbajtjes" nënkupton manualin që përmban detaje dhe plane që nuk përfshihen në Manualin e Aeroportit, në të cilin do të përcaktohen detajet dhe procedurat, për operimin e sigurt dhe mirëmbajtjen e aeroportit, si dhe bashkëveprimin me palë të treta;

"Masterplan" nënkupton dokumentin konceptual i cili përshkruan fazat e ndryshme për zhvillimin e VIA-s, në formë narrative dhe skicore, i përgatitur nga Koncesionari në përputhje me shtojcën 12 (Kërkesat Teknike) të Dokumenteve të Tenderit dhe i përditësuar nga Koncesionari në përputhje me shtojcat 4 dhe 6 të kësaj Kontrate, Legjislacionin e Zbatueshëm dhe Praktikën e Mirë të Industrisë;

"Marrëveshja e Anketimit të Pasagjerëve" nënkupton marrëveshjen mes Koncesionarit dhe Anketuesit të Pasagjerëve, e cila do të ketë formën e një ankete, e cila i bashkëlidhet marrëveshjes, dhe sipas së cilës Anketuesi i Pasagjerëve do të bie dakord të monitorojë, një herë në vit, në muajin me procesimin më të lartë të pasagjerëve, vlerësimin e pasagjerëve, duke i raportuar Koncesionarit rezultatet e anketës, së bashku me të dhënat mbështetëse përkatëse, në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate;

"Marrëveshja për Bashkimin e Përkohshëm" nënkupton marrëveshjen për bashkimin e përkohshëm të nënshkruar nga Ofertuesit në datën 22 dhjetor 2020 e cila rregullon kushtet dhe detyrat e Ofertuesve, me qëllim pjesëmarrjen në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të Projektit;

"Marrëveshja e Drejtpërdrejtë" nënkupton një marrëveshje të drejtpërdrejtë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, Koncesionarit dhe Institucioneve Financiare të cilat ndër të tjera mund të përfshijnë:

- (a) të drejtën e Institucioneve Financiare për të ndërhyrë brenda një periudhe të caktuar për të siguruar që detyrimet e Koncesionarit janë në përputhje me qëllim parandalimin e ndonjë rrethanë që mund të sjellë zgjidhjen e kësaj Kontrate nga ana e Autoritetit Kontraktues dhe/ose të drejtën e Institucioneve Financiare të prokurojnë një detyrë ose një transferim të të drejtave dhe detyrimeve të Koncesionarit sipas kësaj Kontrate në disa rrethana të caktuara;
- (b) detyrimin e Autoritetit Kontraktues për të mos marrë asnjë veprim për të mbyllur, caktuar një administrator ose sanksionuar një rregullim (ose të ngjashme) vullnetar në lidhje me Koncesionarin pa i dhënë një kohë të caktuar njoftimi Institucioneve Financiare,
- (c) rastet e zëvendësimit të Koncesionarit nga Autoriteti Kontraktues në Marrëveshjen e Financimit në rast zgjidhjeje të Marrëveshjes sipas nenit 15.9, 15.10 dhe 15.11,

sipas kushteve të pranueshme nga Koncesionari, duke vepruar në mënyrë të arsyeshme, dhe Institucionet Financiare;

"Marrëveshje e Financimit" nënkupton marrëveshjen (duke përfshirë, pa kufizim, marrëveshjen e barrëve siguruuese), ashtu siç mund të ekzekutohet mes Koncesionarit dhe Institucioneve Financiare, përpara apo pas Datës Efektive në lidhje me financimin ose rifinancimin e borxhit për Koncesionarin, mes të tjerave për dizejnimin, projektimin, inxhinierinë; prokurimin, ndërtimin, operimin, dhe përfundimin e Punimeve (Construction

Works), marrëveshje të cilat do të jenë në mënyrë të arsyeshme të kënaqshme në formë dhe substancë për Autoritetin Kontraktues, dhe çdo marrëveshje ri-financimi, e cila do të jetë e kënaqshme në mënyrë të arsyeshme për Autoritetin Kontraktues;

"Marrëveshja e Inxhinierit të Pavarur" nënkupton marrëveshjen e lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Inxhinierit të Pavarur në lidhje me realizimin e detyrave të Inxhinierit të Pavarur në përputhje me këtë Kontratë;

"Marrëveshja e Operimit dhe Mirëmbajtjes" nënkupton marrëveshjen për operimin dhe mirëmbajtjen e VIA-s, e lidhur midis Koncesionarit dhe Operatorit të miratuar nga Autoriteti Kontraktues;

"Materiali i Rrezikshëm" nënkupton ndonjë substance natyrale ose artificiale (në formë të ngurtë apo lëngshme ose në formë të gazit apo avullit) i aftë t'i shkaktojë dëm cilëso qenie njerëzore ose ndonjë organizëm tjetër të gjallë të mbështetur nga mjedisi, ose i aftë të shkatërrojë mjedisin ose shëndetin publik ose që shfaq kërcënim për sigurinë publike duke përfshirë, pa u kufizuar në: ndonjë ndotës dhe ndonjë substancë të rrezikshme, toksike, radioaktive, të dëmshme, shpërthyes, brejtës ose substanca të rrezikshme dhe të gjitha substancat e rregulluara sipas Legjislacionit të Zbatueshëm për mjedisin;

"Ndryshim i Ligjit" nënkupton:

- (d) hyrjen në fuqi të ndonjë Ligji (duke përfshirë çdo Ligj në fushën e Tatimeve dhe Taksave) që nuk është në fuqi në Datën e Nënshkrimit;
- (e) modifikimin, shfuqizimin ose zëvendësimin e ndonjë Ligji pas Datës së Nënshkrimit; dhe
- (f) një ndryshim pas Datës së Nënshkrimit në interpretimin ose zbatimin nga çdo Autoritet Kompetent i çdo ligji (duke përfshirë çdo Ligj në fushën e Tatimeve dhe Taksave),

por nuk do të përfshijë asnjë nga çështjet e mësipërme për aq sa ato përbëjnë:

- (i) masa korigjuese ose sanksione të ushtruara ligjërisht nga Autoriteti Kompetent si rezultat i ndonjë shkeljeje të Ligjit (duke përfshirë çdo Ligj në fushën e Tatimeve dhe Taksave) nga Ofertuesit dhe/ose Koncesionari; ose
- (ii) Zbatimi i drejtpërdrejtë.

"Ngjarje e Forcës Madhore" ka kuptimin e dhënë në nenin 12.1;

"Niveli C" nënkupton shërbimet e IATA, niveli "C" (ashtu siç përcaktohen në IATAs Airport Development Reference Manual, ashtu siç mund të amendohet, shtohet, apo përditësohet kohë pas kohe, së bashku me kërkesat e vendosura në shtojcën 6;

"Niveli D" nënkupton shërbimet e IATA, niveli "D" (ashtu siç përcaktohen në IATAs Airport Development Reference Manual, ashtu siç mund të amendohet, shtohet, apo përditësohet herë pas here;

"Njësia e Zbatimit të Projektit" ose **"NjZP"** nënkupton njësinë që krijohet nga Autoriteti Kontraktues për monitorimin e zbatimit të kësaj Kontrate, brenda Datës Efektive;

"Njoftimi për Dëmshpërblim" ka kuptimin e dhënë në nenin 16.8;



"**Njoftimi i Refuzimit**" ka kuptimin e dhënë në nenin 17.24;

"**Objekte Arkeologjike**" ka kuptimin e dhënë në përkufizimin "pasuri arkeologjike" të Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë";

"**Objekte të Trashëgimisë Kulturore**" ka kuptimin e dhënë në përkufizimin "pasuri kulturore materiale" të Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë";

"**Oferta**" ka kuptimin që i është dhënë në klauzolën B;

"**Ofertues**" ka kuptimin e caktuar në pjesën hyrëse të kësaj Kontrate;

"**Operator**" nënkupton Koncesionarin, ose një shoqëri tjetër e caktuar nga Koncesionari dhe e miratuar nga Autoriteti Kontraktues e cila do të operojë dhe mirëmbajë VIA në përputhje me Marrëveshjen e Operimit dhe Mirëmbajtjes;

"**Operator Pasardhës**" nënkupton Personin, i caktuar nga Autoriteti Kontraktues për të operuar dhe mirëmbajtur (Aeroportin), në përputhje me nenin 17;

"**Palë**" nënkupton, sipas rastit, nga njëra anë Ofertuesit dhe/ose Koncesionarin dhe nga ana tjetër Autoritetin Kontraktues; së bashku "**Palët**";

"**Pala e Dëmshpërblyer**" nënkupton Palën e cila është dëmshpërblyer nga Pala Dëmshpërblyese në përputhje me nenin 16;

"**Pala Dëmshpërblyese**" nënkupton Palën e cila dëmshpërblen Palën e Dëmshpërblyer në përputhje me nenin **Error! Reference source not found.**;

"**Pasuri e Luajtshme**" do të thotë çdo impiant i luajtshëm, makineritë, mjetet motorike, veglat, pajisjet, pajimet, aparaturat, orëditë, dhe të gjitha dhe çdo pajisje apo artikull i ngjashëm, i përdorur dhe që përdoret në lidhje me operimin dhe mirëmbajtjen e VIA-s (pa përfshirë Pajisjet e Montuara);

"**Pasuritë e Paluajtshme**" do të thotë të gjitha ndërtesat dhe strukturat në Vendndodhje (duke përfshirë Vendndodhjen) duke përfshirë por pa u kufizuar në, ndërtimet si terminalet, fushën e pistës së Avionëve, rrugët e uljes dhe ngritjes së Avionëve, shesh pushimet dhe vendqëndrimet e Avionëve, çdo rrugë lidhëse midis tyre dhe/ose me Asetet e tjera të Aeroportit, si dhe çdo ndërtim të ardhshëm që zhvillohet mbi Vendndodhje me kusht që të jenë pasuri të paluajtshme të ndërtuara nga Koncesionari në kuadrin e Projektit të Zbatimit dhe Masterplanit, në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm;

"**Pasuri e Paprekshme**" do të thotë të dhëna, plane, skica, specifikime, dokumenta inxhinierikë, analiza të të dhënave të tokës, sisteme, procedura, software, dokumenta të blerjes së pasurive, ditare, plane të zhvendosjes së utiliteteve, harta të të dhënave, raporte dhe shembuj të lidhura me Projektin;

"**Perimetri i Rrethimit të Aeroportit**" është perimetri i rrethimit të pandërprerë i cili mbyll të gjithë hapësirën e cila i korrespondon Vendndodhjes;

"**Përfaqësuesit e Institucioneve Financiare**" do të thotë agjenti(ët), apo trusti(et) e Institucioneve Financiare;

"Periudha e Përgjegjësisë së Defekteve" nënkupton një periudhë 24 mujore, duke filluar nga Data e Certifikimit;

"Periudha e Dorëzimit" do të thotë periudha e cila fillon në Datën e Fillimit të Periudhës së Dorëzimit dhe përfundon në Datën e Dorëzimit;

"Periudha e Garancisë" ka kuptimin e dhënë në nenin 11.3;

"Person" do të thotë çdo individ, partneritet, korporatë, shoqëri tregtare, trust, organ qeveritar, agjenci, ministri apo departament, apo një entitet tjetër, duke përfshirë pa kufizim çdo Autoritet Kompetent;

"Plani i Financimit" nënkupton planin e shkruar për financimin ose rifinancimin e Projektit, që përmban midis të tjerave Marrëveshjen e Financimit, Marrëveshjen e Drejtëpërdrejtë, strukturën e financimit, raportin midis borxhit dhe kontributit në kapital të Ofertuesve, vlerën e investimit, i përgatitur nga Koncesionari në përputhje me planin e biznesit dhe vlerën e investimit të propozuar nga Ofertuesit në Ofertë të barabartë me 104,310,500 €, dhe i miratuar nga Autoriteti Kontraktues, përfshirë dhe ndryshimet e herë pas herëshme të miratuara sipas kësaj Kontrate;

"Plani i Menaxhimit Mjedisor" nënkupton planin e përgatitur nga Koncesionari në bazë të Legjislacionit të Zbatueshëm dhe Praktikën e Mirë të Industrisë dhe i miratuar nga Autoriteti Kontraktues në përputhje me këtë Kontratë, i cili parashikon, planet, afatet, procedurat, udhëzimet për arritjen e objektivave mjedisore në Vendndodhje;

"Plani i Përgjithshëm i Aeroportit" nënkupton planin e përgatitur nga Koncesionari në përputhje me shtojcën 12 (Kërkesat Teknike) të Dokumenteve të Tenderit, Legjislacionin e Zbatueshëm dhe Praktikën e Mirë të Industrisë;

"Plani i Punimeve" nënkupton planin e shkruar të përgatitur nga Koncesionari i cili detajon fazat e ndryshme të Punimeve nga projektimi deri tek certifikimi i Aeroportit;

"Plani Tranzitor i Dorëzimit" ka kuptimin e dhënë në nenin 17.4;

"Praktika e Mirë e Industrisë" nënkupton shkallën e aftësive dhe kujdesit që do të pritej në mënyrë të arsyeshme dhe të zakonshme nga një kontraktues me përvojë në të njëjtin lloj sipërmarrjesh (projektim, inxhinieri, instalim, ndërtim, kompletim, kolaudim, testim, operim dhe mirëmbajtje) në lidhje me projekte të një madhësie të njëjtë, fushëveprimi, shkalle, natyrë dhe kompleksiteti të ngjashëm me këtë Projekt;

"Procesi i Dorëzimit" – do të thotë procesi i përcaktuar në nenin 17, në të cilin Vendndodhja dhe Asetet e Aeroportit i transferohen Autoritetit Kontraktues apo një Operatori Pasardhës, në përfundim të Afatit të kësaj Kontrate;

"Projekt" ka kuptimin e dhënë në Klauzolën A;

"Projekti i Zbatimit" nënkupton dokumentin përfundimtar i cili detajon në mënyrë të hollësishme skicat e projektimit dhe ndërtimit të Aeroportit, i përgatitur nga Koncesionari në përputhje me Dokumentet e Tenderit, Legjislacionin e Zbatueshëm, Masterplanin, standardet e ndërtimit të aeroporteve sipas Aneksit 14 të ICAO, kërkesat e arsyeshme dhe të ligjshme të Autoritetit Kontraktues dhe Autoritetit Kompetent;



"Pronar Përfitues" nënkupton, individin i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit SPV-në, përmes pronësisë direkte ose indirekte të 25 % ose më shumë të aksioneve ose të drejtave të votimit ose të pjesëmarrjen në kapitalin e SPV-së, përmes mbajtjes së aksioneve, ose formave të tjera të kontrollit.

"Punime" nënkupton të gjitha aktivitetet për planifikimin inxhinierik, ndërtimin dhe certifikimin e Aeroportit dhe për zbatimin e Projektit në përgjithësi, që do të kryehen nga ose për llogari të Koncesionarit në përputhje me Planin e Zbatimit;

"Punimet e Rinovimit" ka kuptimin e dhënë në nenin 17.7;

"Shërbimet Aeroportuale" nënkupton shërbimet e përcaktuara në Shtojcën 2;

"Shërbimet Tregtare" nënkupton shërbimet e përcaktuara në Shtojcën 2;

"Shoqëri e Lidhur" nënkupton, lidhur me një Palë, një shoqëri, korporatë ose një person tjetër juridik i cili është:

- (a) drejtpërdrejtë ose tërthorazi në kontrollin e asaj Pale (për qëllim të këtij përkufizimi, një "Shoqëri Mëmë");
- (b) drejtpërdrejt ose tërthorazi në kontrollin e një Shoqërie Mëmë; ose
- (c) drejtpërdrejt ose tërthorazi nën kontroll të përbashkët me një Shoqëri Mëmë;

me kusht që "kontrolli" kërkon mbajtjen e shumicës së të drejtave të votës së ortakëve, aksionarëve ose anëtarëve (sipas rastit) ose aftësinë për të ushtruar ndikim dominues sipas një kontrate ose statutit të shoqërisë ose ndonjë dokumenti të barasvlershëm të asaj Pale;

"Shoqëria Zëvendësuese" do të thotë çdo Person i emëruar nga Institucionet Financiare, apo përfaqësuesit e Institucioneve Financiare, siç mund të jetë rasti, dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktues për të zëvendësuar Koncesionarin në këtë Kontratë, në përputhje me Nenin 19.4;

"Shpërndarja e Kapitalit" nënkupton (i) çdo Kontribut të Kapitalit, i cili mund t'i jetë kthyer ose ripaguar tërësisht ose pjesërisht, ndonjë aksionari/ortaku apo Shoqërie të Lidhur me të, (ii) çdo dividend ose shpërndarje tjetër, e paguar nga Koncesionari kundrejt çdo aksionari/ortaku ose Shoqërie të Lidhur me të, në lidhje me çdo Kontribut në Kapital, (iii) çdo shumë e paguar nga Koncesionari kundrejt çdo aksionari/ortaku ose Shoqërie të Lidhur me të, në formë interesi, tarife, apo primi, në lidhje me çdo Kontribut në Kapital, dhe (iv) çdo shumë tjetër e paguar nga Koncesionari kundrejt çdo aksionari/ortaku, Shoqërie të Lidhur me të, apo çdo Personi, në të cilin Koncesionari zotëron aksione të çdo lloji ose çdo lloj interesi tjetër mbi kapitalin, përveç shumave të paguara në kuadër të mallrave të shitura apo shërbimeve të kryera nga ky aksionar/ortak, apo Shoqëri e Lidhur me të, apo ky Person kundrejt Koncesionarit, sipas kontratës përkatëse, e cila është në përputhje me Praktikën e Mirë të Industrisë;

"Shuma e Dorëzimit" ka kuptimin e dhënë në nenin 17.26;

"Sigurimi i Kontratës" nënkupton garancinë e paraqitur nga Koncesionari në Datën e Nënshkrimit, e lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë ose nga një shoqëri sigurimi sipas përcaktimeve të Kontratës, me kërkesë të Koncesionarit dhe në favor të Autoritetit Kontraktues, me një vlerë të barabartë me pesë milion e dyqind e pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet e pesë euro (5,215,525 €);



"SPV" ka kuptimin e dhënë në nenin 2.3 (b);

"Takimi për Dorëzimin" ka kuptimin e dhënë në nenin 17.6;

"Taksë" nënkupton çdo tatim, taksë, sekuestro, detyrim, honorar ose pagesë tjetër ose tatim i një natyre të ngjashme (duke përfshirë çdo sanksion ose interes të pagueshëm në lidhje me ndonjë paafësi paguese ose ndonjë vonesë në pagesë) duke përfshirë tatimin mbi të ardhurat dhe tatimi mbi fitimin;

"Tarifat" nënkupton tarifat për Shërbimet Aeroportuale dhe tarifat për Shërbimet Tregtare;

"Tarifa Koncesionare" ka kuptimin e dhënë në nenin 5.1;

"Termet e Referencës" nënkupton kushtet dhe parametrat që duhen respektuar për zbatimin e Projektit sipas Shtojcës 6 të kësaj Kontrate;

"Të Drejtat e Koncesionit" ka kuptimin e dhënë në nenin 4;

"Treguesit Kryesorë të Performancës" nënkupton objektivat, parametrat, dhe indikatorët e performancës, të listuar në Shtojcën 4, nga ku Tregues Kryesor i Performancës nënkupton secilin prej tyre;



"Vendndodhje" nënkupton të gjithë sipërfaqen e përbërë nga trualli në pronësi të Autoritetit Kontraktues dhe e pasqyruar në Shtojcën 1, ku do të realizohet ndërtimi i VIA-s sipas Projektit të Zbatimit si dhe operimi dhe mirëmbajtja e tij dhe ku do të zbatohen të drejtat dhe detyrimet e Koncesionarit sipas kësaj Kontrate;

"Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar" ka kuptimin e përcaktuar në nenin 13;

"Vërtetimi i Tarifës Koncesionare" ka kuptimin e përcaktuar në nenin 10.57(b);

"VIA" nënkupton Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorës, i cili ndërtohet në Vendndodhje dhe përfshin Vendndodhjen, Pasuritë e Paluajtshme, Pasuritë e Luajtshme dhe çdo ndërtim të ardhshëm që i shtohet Pasurive të Paluajtshme të Aeroportit;

"Vlera e Rregulluar" nënkupton në Datën e Zgjidhjes së Parakohshme, vlerën e çdo Kontributi të Kapitalit, apo Shpërndarjeje të Kapitalit, sipas rastit, vlerë e cila do të përcaktohet duke marrë vlerën e Kontributit të Kapitalit, apo Shpërndarjes të Kapitalit, sipas rastit, duke e rregulluar këtë vlerë për çdo vit kalendarik apo për një pjesë të tij, përgjatë periudhës nga data e çdo Kontributi në Kapital apo Shpërndarjeje të Kapitalit, sipas rastit, duke aplikuar një faktor rregullues në rritje si më poshtë:

- (a) në rast se Zgjidhja e Parakohshme ndodh jo më vonë se tre vite nga Data e Fillimit të Punimeve, aplikohet një faktor rregullues në rritje për çdo vit kalendarik, apo çdo pjesë të tij, i barabartë me një normë interesi të kapitalizuar (të përbërë) prej 10% (dhjetë përqind) në vit;
- (b) në rast se Zgjidhja e Parakohshme ndodh pas tre viteve nga Data e Fillimit të Punimeve, aplikohet një faktor rregullues në rritje për çdo vit kalendarik, apo çdo pjesë të tij, i barabartë me një normë interesi të thjeshtë sa norma mesatare e interesit të 10 (dhjetë) viteve të fundit, të përcaktuar nga Indeksi ndërkombëtar S&P 500;

"Vlerësues" ka kuptimin e përcaktuar në nenin 11.3(d);

"VNM" nënkupton Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis;

"YDA" ka kuptimin e dhënë në pjesën hyrëse të kësaj Kontrate;

"Zgjidhja e Parakohshme" nënkupton zgjidhjen e kësaj Kontrate para Datës së Mbarimit të Afatit, nga secila prej Palëve, në përputhje me nenin 15.

Në këtë Kontratë, vetëm nëse konteksti e kërkon ndryshe:

- (a) njëjësi përfshin shumësin dhe anasjelltas;
- (b) një referencë për një gjini nuk do të përjashtojë gjinitë e tjera;
- (c) fjalët për personat përfshijnë personat fizikë, organet e shoqërive, shoqatat dhe ortakëritë e peregjistruara (pavarësisht nëse ndonjëri prej tyre ka ose jo një personalitet të veçantë juridik);
- (d) një referencë ndaj një Pale i referohet Autoritetit Kontraktues, Ofertuesve ose Koncesionarit ose pasuesve të tyre, sipas rastit;
- (e) referenca për çdo dispozitë ligjore do të konsiderohet se përfshin çdo akt ligjor, nënligjor, rregullor, rregull, ose urdhër për zbatimin e tij dhe çdo ri-miratim ose ndryshim të mëvonshëm të tij;
- (f) fjalët "përfshirë", "të tjera", "në veçanti", "për shembull" dhe fjalët të ngjashme nuk do të kufizojnë përgjithësinë e fjalëve të mëparshme dhe do të interpretohen sikur ato të pasqyrojnë menjëherë nga fjalët "pa kufizim";
- (g) referencat tek "me shkrim" përfshijnë shtypjen, printimin, transmetimin elektronik dhe faksimil dhe mënyrat e tjera të prodhimit ose riprodhimit të fjalëve në një formë të dukshme dhe shprehjet që referojnë tek shkrimi do të interpretohen sipas rastit;
- (h) titujt e kreve dhe shtojcave, përmbajtja dhe faqja e parë janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin ose kuptimin e kësaj Kontrate;
- (i) përveç kur parashikohet ndryshe, referencat tek nenet dhe shtojcat janë referenca tek nenet dhe shtojcat e kësaj Kontrate, dhe referencat në çdo shtojcë tek paragrafët, pjesët dhe anekset, përveç nëse parashihet ndryshe, janë referenca tek paragrafët, pjesët dhe anekset e shtojcës ose pjesës së shtojcës ku shfaqen këto referenca;
- (j) referencat tek kjo Kontratë janë referenca tek kjo Kontratë të ndryshuara ose të modifikuara herë pas here;
- (k) referenca tek një marrëveshje, kontratë, dokument ose akt do të interpretohet si një referencë tek kjo, siç është ndryshuar, plotësuar apo me shtesa herë pas here.

1.2 Shtojcat dhe secili aneks dhe shtesë e tyre përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate.

1.3 Përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Kontratë, në rast të një konflikti të drejtpërdrejtë midis ndonjë dispozite të Kontratës, të ndonjë shtojce, Ofertës dhe Dokumenteve të Tenderit, radha e përparësisë do të jetë si më poshtë:



- (a) Kontrata;
- (b) Shtojcat e saj
- (c) Dokumentet e Tenderit;
- (d) Oferta.

2. DATA E NËNSHKRIMIT, DATA EFEKTIVE DHE KUSHTET PARAPRAKE

Data e Nënshkrimit

- 2.1 Kjo Kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga Ofertuesit dhe Autoriteti Kontraktues (“Data e Nënshkrimit”) dhe vazhdon deri në Datën e Mbarimit të Afatit, përveç nëse zgjatet ose është objekt i zgjidhjes së parakohshme sipas kushteve të kësaj Kontrate.
- 2.2 Gjatë periudhës midis Datës së Nënshkrimit dhe Datës Efektive, vetëm të drejtat dhe detyrimet e Palëve sipas neneve 1, 2, 8, 20, 21, 22, 23 do të jenë në fuqi dhe të zbatueshëm plotësisht.

Kushtet Paraprake

- 2.3 Përveçse sa parashikohet në nenin 2.2, të drejtat dhe detyrimet e Ofertuesve dhe/ose Koncesionarit sipas kësaj Kontrate janë të kushtëzuara nga përmbushja nga ana e Ofertuesve dhe/ose Koncesionarit (sipas rastit) e kushteve paraprake të mëposhtme:

- (a) Dorëzimin e dokumenteve të mëposhtme pranë Autoritetit Kontraktues, të përshtatura dhe përfunduara, në një formë dhe përmbajtje të pëlqyeshme për këtë të fundit dhe Autoriteti Kontraktues t’i ketë miratuar me shkrim këto dokumente:

- (i) Masterplanin e VIA-s;
- (ii) Projektin e Zbatimit, të hartuar në përputhje me Dokumentet e Tenderit;
- (iii) Planin e Punimeve;
- (iv) Projektin e Detajuar Teknik, në 3 kopje fizike dhe 1 kopje elektronike. Koncesionari dhe Inxhinieri i Pavarur do të sigurohen që Projekti i Detajuar Teknik të jetë në përputhje me standartin e Nivelit C;
- (v) Planin e Përgjithshëm të Aeroportit;
- (vi) VNM paraprake;
- (vii) Planin e Financimit;
- (viii) Skicat e Punimeve (të projektuara);
- (ix) Planin e Menaxhimit Mjedisor;
- (x) Koncept Design e Projektit;

- (b) Themelimin e shoqërisë koncesionare nga ana e Ofertuesve e cila do të kryejë rolin e një subjekti për qëllime të veçanta si një njësi ekonomike e themeluar sipas Legjislacionit të Zbatueshëm, në të cilin Ofertuesit janë aksionerë/ortakë të



drejtpërdrejtë ose të tërthortë ("SPV") respektivisht me 58% për Mabetex Group, 40% për YDA Group dhe 2% për 2A Group, dhe i dorëzojnë tek Autoriteti Kontraktues kopje origjinale dhe të plota, në formë dhe përmbajtje të pëlqyeshme për Autoritetin Kontraktues, të dokumenteve të mëposhtme:

- (i) Statutit të Shoqërisë dhe certifikatën e regjistrimit të Koncesionarit pranë regjistrimit tregtar; dhe
 - (ii) vendimet e miratuara nga aksionarët/ ortakët e Koncesionarit që autorizojnë nënshkrimin nga ana e Koncesionarit të kësaj Kontrate;
 - (iii) vërtetimet ose dokumentacionin e nevojshëm për identifikimin e Pronarit Përfitues të SPV-së sipas kuptimit të Ligjit nr.112/2020 "Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues".
- (c) Nënshkrimin e Kontratës nga Koncesionari si dhe nënshkrimin e versionit të Kontratës në gjuhën angleze nga Autoriteti Kontraktues, Ofertuesit dhe Koncesionari;
 - (d) Dorëzimin nga secili prej Ofertuesve i një certifikatë sipas të cilës secili prej Ofertuesve konfirmon midis të tjerave (i) angazhimet e tyre në lidhje me kapitalin dhe borxhin ndaj Koncesionarit, (ii) disponueshmërinë e të ardhurave të nevojshme për zbatimin e Projektit dhe (iii) që Plani i Financimit është i zbatueshëm plotësisht;
 - (e) Dorëzimin nga Ofertuesit, në një formë dhe përmbajtje të pranueshme për Autoritetin Kontraktues, i dokumenteve që provojnë që pjesët e kapitalit që do të kontribuojnë secili prej Ofertuesve në kapitalin e Koncesionarit janë paguar rregullisht dhe plotësisht;
 - (f) Dorëzimin nga Ofertuesit, në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues, i dokumenteve që provojnë që kushtet që duhen përmbushur për disbursimin e çdo huaje të nevojshme për financimin e Projektit në përputhje me Kontratën dhe Planin e Financimit, janë përmbushur ose është hequr dorë prej tyre;
 - (g) Dorëzimin e dokumenteve bankare që vërtetojnë hapjen e Llogarive Bankare në emër të Koncesionarit që do të jenë të vetmet llogari bankare që do të përdoren nga ky i fundit për kryerjen e veprimeve bankare në lidhje me Projektin;
 - (h) Dorëzimi i Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar nga Koncesionari dhe Albcontrol;
 - (i) Dorëzimin e një liste emërore për përzgjedhjen e Inxhinierit të Pavarur;
 - (j) Dorëzimin e listës së policave të sigurimit, në përputhje me formën e përcaktuar në Shtojcën 33

(së bashku "**Kushtet Paraprake të Koncesionarit**").

2.4 Përveçse sa parashikohet në nenin 2.2, të drejtat dhe detyrimet e Autoritetit Kontraktues sipas kësaj Kontrate janë të kushtëzuara nga përmbushja nga ana e Autoritetit Kontraktues e kushteve paraprake të mëposhtme:

- (a) Miratimin e Kontratës nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe botimin e vendimit të miratimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë;



- (b) Krijimin e NJPZ-së;
- (c) Marrjen e miratimeve që duhet të merren nga Autoriteti Kontraktues para Datës Efektive, sipas kësaj Kontrate dhe Legjislacionit të Zbatueshëm, duke përfshirë midis të tjerave miratimin nga Autoriteti i Konkurrencës, Komisioni i Ndhmës Shtetërore dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
- (d) Përzgjedhjen e Inxhinierit të Pavarur, dhe lidhjen e Marrëveshjes së Inxhinierit të Pavarur në përputhje me nenin 8 të kësaj Kontrate dhe në mënyrë të pranueshme nga Koncesionari;
- (e) Vënien në dispozicion të të dhënave për fizibilitetin e fluturimeve në VIA, që do të merren nga Albcontrol. (studimi aeronautik duhet të konfirmojë fizibilitetin dhe mundësinë e fluturimit në VIA);
- (f) Regjistrimin e Kontratës në regjistrin e koncesioneve;

(së bashku "Kushtet Paraprake të Autoritetit Kontraktues").

Përfundimi i Kontratës

- 2.5 Nëse brenda dyqind e dyzet (240) ditësh nga Data e Nënshkrimit ("Afatit të Fundit"), Ofertuesit dhe/ose Koncesionari nuk përmbushin ndonjë ose të gjitha prej Kushteve Paraprake të Koncesionarit, ose nga i cili nuk është hequr dorë nga Autoriteti Kontraktues, Autoriteti Kontraktues ka të drejtën (por jo detyrimin) të zgjidhë këtë Kontratë duke njoftuar Koncesionarin dhe Ofertuesit tridhjetë (30) ditë para. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të tërheqë Sigurimin e Kontratës përveç nëse mospërmbushja është shkaktuar nga vonesa e pajustificuar e Autoritetit Kontraktues.
- 2.6 Nëse brenda Afatit të Fundit, Autoriteti Kontraktues nuk përmbush ndonjë prej Kushteve Paraprake të Autoritetit Kontraktues, ose nga i cili nuk është hequr dorë nga Ofertuesit dhe Koncesionari, Koncesionari dhe/ose Ofertuesit kanë të drejtën (por jo detyrimin) të zgjidhin këtë Kontratë duke njoftuar Autoritetin Kontraktues tridhjetë (30) ditë para. Menjëherë pas zgjidhjes së Kontratës sipas këtij neni 2.6, Autoriteti Kontraktues do t'i kthejë Koncesionarit Sigurimin e Kontratës.
- 2.7 Nëse brenda Afatit të Fundit, Palët nuk përmbushin ndonjë prej Kushteve Paraprake, nga i cili nuk është hequr dorë, secila Palë ka të drejtë (por jo detyrimin) të zgjidhë këtë Kontratë duke njoftuar Autoritetin Kontraktues tridhjetë (30) ditë para. Menjëherë pas zgjidhjes së Kontratës sipas këtij neni 2.6, Autoriteti Kontraktues do t'i kthejë Koncesionarit Sigurimin e Kontratës.
- 2.8 Në rastet e parashikuara në nenet 2.5, 2.6 dhe 2.7 më sipër, pas mbarimit të periudhës tridhjetë (30) ditore, Kontrata do të zgjidhet automatikisht pa nevojën për njoftim të mëtejshëm, përveç nëse të gjitha Kushtet Paraprake të paplotësuara janë përmbushur deri në këtë datë ose Palët kanë rënë dakord me shkrim për të zgjidhur datën e afatit për përmbushjen e Kushteve Paraprake të paplotësuara.
- 2.9 Palët do të sillen në mirëbesim në përmbushjen e Kushteve Paraprake.
- 2.10 Autoriteti Kontraktues nuk mban përgjegjësi për asnjë humbje të Koncesionarit dhe/ose të Ofertuesve në rast zgjidhjeje të Kontratës sipas neneve 2.5, 2.6, 2.7 dhe 2.8.

Koncesionari

- 2.11 Me regjistrimin e SPV-së në regjistrin tregtar të Shqipërisë, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Ofertuesve sipas kësaj Kontrate do t'i transferohen SPV-së, dhe si rrjedhojë, përvec rasteve kur parashikohet ndryshe në Kontratë, SPV-ja do të bëhet Palë e Kontratës në datën e nënshkrimit të Kontratës nga SPV ("Data e Transferimit"). Ofertuesit duhet të garantojnë që parashikimet e kësaj Kontrate do të përfshihen në dokumentet themeluese të SPV-së. Ofertuesit dhe SPV-ja (pas themelimit, Koncesionari) janë përgjegjës solidarë për përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Kontrate deri në përfundimin e Afatit.

Data Efektive

- 2.12 Pas përmbushjes të Kushteve Paraprake ose heqjes dorë nga përmbushja e ndonjërit prej tyre, Palët do të nënshkruajnë certifikatën e mbylljes, bashkëlidhur si Shtojca 9 e cila konfirmon përmbushjen, ose heqjen dorë nga, e Kushteve Paraprake, me kusht që deklarata e mbylljes të mos ndryshojë ose zvogëlojë të drejtat dhe detyrimet e Palëve sipas kësaj Kontrate ("Deklarata e Mbylljes"), si dhe Shtojcën 5 "Për Dorëzimin e Vendndodhjes", me anë të së cilës Autoriteti Kontraktues i dorëzon Koncesionarit Vendndodhjen, në përputhje me nenin 7.
- 2.13 Data e nënshkrimit të Deklaratës së Mbylljes do të jetë Data Efektive e Kontratës ("Data Efektive"), e cila përkon me përmbushjen e afatit prej dyqind e dyzet (240) ditësh nga Data e Nënshkrimit ("Afati i Fundit").

Periudha Tranzitore

- 2.14 Gjatë periudhës kohore midis Datës së Nënshkrimit dhe Datës Efektive, Autoriteti Kontraktues duhet t'i lejojë dhe sigurojë Koncesionarit akses në Vendndodhje për të kryer matje, testime si dhe për të kryer punë të tjera të nevojshme për të përmbushur Kushtet Paraprake të Koncesionarit. Koncesionari ka për detyrë të respektojë të gjitha standardet e sigurisë në objekt në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm.

3. AFATI

- 3.1 Përveçse në rastet e përfundimit të parakohshëm të Kontratës ose shtyrje të kohëzgjatjes në përputhje me kushtet e saj, Afati i Kontratës është i barabartë me një periudhë që fillon në Datën Efektive dhe përfundon 35 (tridhjetë e pesë) vjet më pas ("Afati").

4. DHËNIA E TË DREJTAVE TË PROJEKTIT

- 4.1 Autoriteti Kontraktues, si përfaqësues i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet kësaj Kontrate i jep Koncesionarit të drejtën ekskluzive dhe detyrimin për projektimin, financimin, ndërtimin, kolaudimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e VIA-s, dhe të të drejtave dhe detyrimeve të tjera të parashikuar në këtë Kontratë, në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm dhe Kontratën.
- 4.2 Në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate dhe Shtojcën 24, Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit të drejtën e përcaktimit dhe arkëtimit të Tarifave dhe të ardhurave të tjera të lejuara nga Kontrata.
- 4.3 Në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate, Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit gjatë Afatit të Kontratës të drejta ekskluzive mbi Projektin. Autoriteti Kontraktues nuk do bartë ose t'i cedojë ndonjë personi të tretë në çfarëdo forme, me apo pa shpërbllim, të drejtat e Koncesionarit ose ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate, përveç nëse në Kontratë është përcaktuar ndryshe.
- 4.4 Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit të drejtën reale mbi Vendndodhjen dhe Pasuritë e

Paluajtshme të përcaktuara në nenin 7.

(të drejtat e mësipërmë do të referohen si “Të Drejtat e Koncesionit”).

5. TARIFA KONCESIONARE

- 5.1 Koncesionari do t'i paguajë Autoritetit Kontraktues një kompensim monetar për kalimin e të drejtave të Projektit në formën e një tarife koncesionare vjetore të barabartë me dy përqind (2%) të të Ardhurave Bruto vjetore, duke filluar nga Data e Operimit (“Tarifa Koncesionare”).
- 5.2 Tarifa Koncesionare paguhet nga Koncesionari brenda datës 15 maj të vitit pasardhës për çdo vit, në përputhje me rregullat e caktuara nga ministria përgjegjëse për financat për arkëtimin e të ardhurave për llogari të buxhetit të Shtetit Shqiptar.
- 5.3 Nëse Koncesionari nuk paguan Tarifën Koncesionare në përputhje me këtë Kontratë, Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Koncesionarin me shkrim. Nëse Koncesionari nuk paguan Tarifën Koncesionare brenda tridhjetë (30) ditësh nga marrja e njoftimit, Autoriteti Kontraktues njofton menjëherë ministrin përgjegjës për financat, për të kërkuar ekzekutimin e pagesës së Tarifës Koncesionare nëpërmjet përmbaruesit gjyqësor, në përputhje me nenin 29 të Ligjit për Koncesionet.

6. TARIFAT

- 6.1 Koncesionari përcakton Tarifat për Shërbimet Aeroportuale dhe për Shërbimet Tregtare që do të zbatohen pas Datës së Operimit përgjatë Afatit të Kontratës në mënyrë jodiskriminuese dhe në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, Praktikën e Mirë të Industrisë. Koncesionari do të njoftojë paraprakisht Autoritetin Kontraktues përpara vendosjes së Tarifave për Shërbimet Aeroportuale. Përgjatë Periudhës së Garancisë, Koncesionari do të njoftojë paraprakisht Autoritetin Kontraktues përpara vendosjes së Tarifave për Shërbimet Tregtare.

Tarifat për Shërbimet Aeroportuale

- 6.2 Në përcaktimin e Tarifave për Shërbimet Aeroportuale, Koncesionari do të veprojë në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, veçanërisht me nenin 29 të Kodit Ajror dhe aktet nënligjore që bazohen tek Kodi Ajror, me detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë që rrjedhin nga Marrëveshja mbi krijimin e një Zone të Përbashkët Evropiane të Aviacionit dhe me Konventën e Çikagos.

Tarifat për Shërbimet Tregtare

- 6.3 Tarifat për Shërbimet Tregtare do të jenë të bazuara në vlerat e tregut, dhe në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm dhe Praktikën e Mirë të Industrisë.
- 6.4 Në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm dhe kushtet e Kontratës, Koncesionari ka të drejtën dhe detyrimin e faturimit, arkëtimin dhe depozitimit të Tarifave në Llogaritë Bankare, përgjatë kohëzgjatjes së Afatit. Koncesionari mban përgjegjësi ekskluzive dhe merr përsipër të gjitha risqet që lidhen me të drejtat dhe detyrimet e tij sipas këtij neni 6.4.
- 6.5 Nëse Koncesionari dështon në faturimin ose arkëtimin e Tarifave, brenda nëntëdhjetë (90) ditësh nga data kur këto Tarifa janë bërë të pagueshme, ky dështim do të konsiderohet si mospërbushje e Kontratës. Autoriteti Kontraktues e njofton me shkrim Koncesionarin për mospërbushjen në fjalë dhe nëse Koncesionari nuk korrigjon mospërbushjen në fjalë brenda:



- (a) tridhjetë (30) ditëve nga marrja e njoftimit me shkrim, nëse dështimi i faturimit ose i arkëtimit ka të bëjë me Tarifa të pagueshme nga Shoqëri të Lidhura me Koncesionarin; ose
- (b) gjashtëdhjetë (60) ditëve nga marrja e njoftimit me shkrim, nëse dështimi i faturimit ose i arkëtimit ka të bëjë me Tarifa të pagueshme nga çdo Person, përveç Shoqërive të Lidhura me Koncesionarin;

Autoriteti Kontraktues ka të drejtën e zgjidhjes së parakohshme të Kontratës në përputhje me nenin 15.4(h), përveç nëse dhe për aq kohë sa Koncesionari provon që Koncesionari po kryen të gjitha përpjekjet e mundshme dhe të ligjshme për arkëtimin e Tarifave të papaguara dhe/ose nëse Koncesionari provon në një mënyrë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues që Koncesionari është në pamundësi për të faturuar ose arkëtuar Tarifat e papaguara pavarësisht përpjekjeve të tij të mundshme.

6.6 Koncesionari do të mbledhë gjithashtu taksat e mëposhtme, në emër dhe për llogari të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm dhe marrëveshjen që do të lidhet midis Koncesionarit dhe Autoritetit Kompetent për këtë efekt:

- (a) Taksën e kalimit të kufirit;
- (b) Tarifën e sigurisë, duke përfshirë tarifën e sigurisë që përfiton AAC-ja, siç miratohet nga ministria përgjegjëse për transportin dhe ministria përgjegjëse për financat;
- (c) Çdo taksë dhe/ose tarifë tjetër që mund të vendoset nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

6.7 Për mbledhjen e taksave sipas nenit 6.6(b), Koncesionari dhe Autoriteti Kompetent do të parashikojnë në një marrëveshje përkatëse mënyrën dhe afatet për pagesat e taksave dhe/ose tarifave dhe rimbursimin e kostove të mundshme administrative që lidhen drejtëpërdrejtë me mbledhjen e këtyre taksave.

7. VENDNDODHJA DHE ASETET E AEROPORTIT

7.1 Duke pasur parasysh detyrimet e Koncesionarit sipas kësaj Kontrate, Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit, nga Data e Nënshkrimit deri në Datën e Përfundimit të Afatit, të drejtat mbi Vendndodhjen si më poshtë vijon:

- (a) të drejtën për posedimin dhe përdorimin (por jo pronësinë), dhe të drejtën ekskluzive për të zënë, shfrytëzuar dhe gëzuar Vendndodhjen, përfshirë cdo pronë të paluajtshme pjesë të Vendndodhjes,, nëse ka, në përputhje me këtë Kontratë dhe Shtojcën 5 për Dorëzimin e Vendndodhjes pa asnjë barrë, detyrim apo kufizim, dhe pa ndërhyrje të panevojshme nga ana e Autoritetit Kontraktues, subjekteve publike apo palëve të treta ("Gëzim i Plotë dhe i Qetë i Pronës");
- (b) të drejtën për kalim mbi dhe nën, dhe hyrjen dhe daljen nga dhe në çdo vend të Vendndodhjes, pa ndërhyrje të panevojshme nga ndonjë palë e tretë për qëllimin e zbatimit të Projektit ("E Drejta e Kalimit");
- (c) Koncesionari ka të drejtë të ndërtojë dhe mirëmbajë Aeroportin, përfshirë Pasuritë e Paluajtshme, në Vendndodhje dhe Koncesionari përballon të gjitha rreziqet dhe kostot që rrjedhin nga ose në lidhje me Punimet dhe ka të drejtat e nevojshme të përdorimit për të zbatuar këtë Kontratë.

- (d) Taksat të cilat sipas Legjislacionit të Zbatueshëm i paguan pronari, në lidhje me Vendndodhjen, do të paguhet nga Autoriteti Kontraktues.
- 7.2 Të drejtat e Koncesionarit mbi Vendndodhjen rregullohen nga kjo Kontratë dhe nga Shtojca 5 për Dorëzimin e Vendndodhjes. Rrjedhimisht, kjo Kontratë dhe Shtojca 5 për Dorëzimin e Vendndodhjes janë dokumentet e vetme të nevojshme në lidhje me të drejtat mbi Vendndodhjen, që do të kërkohen të dorëzohen nga Koncesionari, në emër të tij ose në emër të Autoritetit Kontraktues, tek Autoritetet Kompetente, me qëllim marrjen ose rinovimin e Lejeve dhe Licencave që mund të nevojiten për kryerjen e punimeve, përfshirë dhe lejen e ndërtimit.
- 7.3 Nga data e regjistrimit të tyre pranë regjistrimit të pronave të paluajtshme dhe deri në Datën e Përfundimit të Afatit, Koncesionari do të ketë të drejtën e pronësisë mbi Pasuritë e Paluajtshme. Pavarësisht nga sa më sipër, e drejta e pronësisë e Koncesionarit mbi Pasuritë e Paluajtshme është e kufizuar nga detyrimi i Koncesionarit për të mos tjetërsuar (shitur, dhuruar ose transferuar në çfaredo mënyre) Pasuritë e Paluajtshme, pjesërisht ose plotësisht, në favor të palëve të treta, pa miratimin me shkrim të Autoritetit Kontraktues. Ky kufizim si dhe detyrimi i Koncesionarit për të transferuar të drejtën e pronësisë mbi dhe dorëzimin e Pasurive të Paluajtshme në favor të Autoritetit Kontraktues në përputhje me nenin 17, do të regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Për efekt qartësie, Autoriteti Kontraktues do të mbajë të drejtën e pronësisë mbi Vendndodhjen gjatë gjithë Afatit të Kontratës. Taksat dhe shpenzimet në lidhje me regjistrimin e pronësisë dhe pronësive të Pasurive të Paluajtshme, si dhe shpenzimet për regjistrimin e të drejtave të përdorimit të Vendndodhjes do të paguhet nga Koncesionari.
- 7.4 Në Datën e Përfundimit të Afatit, Koncesionari i kthen Autoritetit Kontraktues Vendndodhjen, në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate dhe i kalon Autoritetit Kontraktues të drejtën e pronësisë dhe të posedimit mbi Pasuritë e Paluajtshme, në përputhje me nenin 17.
- 7.5 Në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm dhe këtë Kontratë, Vendndodhja nuk do të përdoret nga Koncesionari për ndonjë qëllim tjetër, të ndryshëm nga çka parashikohet në këtë Kontratë.
- 7.6 Koncesionari do të garantojë, ose do të mundësojë që t'i garantohet hyrja në Vendndodhje Autoritetit Kontraktues ose përfaqësuesve të tij, përfshirë NJZP-në ose këshilltarëve të Autoritetit Kontraktues me qëllimin:
- (a) Vëzhgimin dhe inspektimin e aktiviteteve të Koncesionarit;
 - (b) Verifikimin e përmbushjes së detyrimeve të Koncesionarit;
 - (c) Monitorimin e niveleve të shërbimit IATA dhe volumin e Pasagjerëve në VIA sipas neneve 10.35;

me kusht që Autoriteti Kontraktues dhe përfaqësuesit e tij do t'i nënshtrohen dhe do të respektojnë procedurat zbatueshme të sigurisë të zbatuara nga Koncesionari për individët të cilët kanë akses në Vendndodhje dhe nuk do të pengojnë, ndërhyjnë ose vonojnë ekzekutimin e Punimeve ose aktivitetin e VIA-s.

- 7.7 Nëse pas Datës Efektive, Koncesionarit do t'i kërkohet nga Legjislacioni i Zbatueshëm që të marrë masa korigjuese në lidhje me ndonjë Gjendje Ekzistuese, atëherë Koncesionari do të marrë masa të korigjuese të nevojshme, në mënyrë që të lejojë vazhdimin e aktivitetit në VIA dhe / ose Punimeve. Koncesionari ka të drejtën të kompensohet nga Autoriteti Kontraktues për çdo kosto shtesë të arsyeshme dhe të provuar, që do të përballojë për marrjen e këtyre masave korigjuese, përveç në rast se marrja e këtyre vjen si pasojë e neglizhencës ose fajit të Koncesionarit. Në rastin e Gjendjes Ekzistuese që vjen si pasojë e pranisë në Vendndodhje e



Materialeve të Rrezikshme, kompensimet e mësipërme do të jenë në masën që këto kosto tejkalojnë kërkesën e kostove të parashikuara për realizimin e masave korigjuese sipas Dokumenteve të Tenderit dhe VNM-së. Në rast se Koncesionari has pengesa si rezultat i këtyre masave korigjuese, Koncesionari ka të drejtë të përfitojë shtyrje të afateve përkatëse të Punimeve, duke filluar nga momenti i shfaqjes pengesës deri në mbarimin e masave korigjuese.

- 7.8 Koncesionari pranon që çdo fosil, monedhë, send me vlerë ose antikitet ose sende të tjera të ngjashme janë dhe do të mbeten pronë e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshem. Në rast të zbulimit të ndonjë sendi të tillë pas marrjes në dorëzim të Vendndodhjes, Koncesionari do të veprojë në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm dhe vecanërisht do të:
- (a) do të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktues; dhe
 - (b) nëse sendet e zbuluara janë të lëvizshme, do të lejojë Autoritetin Kontraktues ose çdo Autoritet Kompetent të hyjë në zonën përkatëse për të kryer heqjen e tyre; dhe
 - (c) do të ndjekë udhëzimet e Autoriteti Kontraktues ose çdo Autoriteti Kompetent;
 - (d) do të lejojë Autoritetin Kontraktues ose çdo Autoriteti Kompetent që të kryejë studime siç kërkohen nga Legjislacioni i Zbatueshëm si dhe të kryejë të gjitha veprimet që gjykohen të nevojshme nga Autoriteti Kontraktues ose çdo Autoriteti Kompetent.

8. INXHINIERI I PAVARUR

- 8.1 Para Datës Efektive, Koncesionari do t'i propozojë Autoritetit Kontraktues një listë prej të paktën tre (3) Personash që kanë përvojë në ndërtimin dhe zbatimin e punimeve të Aeroporteve me madhësi dhe aktivitet të ngjashëm me Aeroportin që do të ndërtohet në kuadër të Projektit. Koncesionari do të përgatisë gjithashtu termat e referencës për përzgjedhjen e Inxhinierit të Pavarur, në përputhje me Shtojcën 7. Autoriteti Kontraktues do të zgjedhë një nga ekspertët e propozuar nga Koncesionari dhe do t'ia njoftojë Koncesionarit brenda Afatit të Fundit.
- 8.2 Marrëveshja e Inxhinierit të Pavarur do të ketë një afat që fillon në Datën Efektive dhe përfundon 30 ditë pas Datës së Operimit.
- 8.3 Në përputhje me Marrëveshjen e Inxhinierit të Pavarur, Inxhinieri i Pavarur nuk do të ushtrojë një funksion të ngjashëm ose çdo funksion tjetër për llogari të personave të tretë, duke përfshirë huadhënësit ose ndonjë Institucion Financiar që mund të sigurojë herë pas here financimin e borxhit të Koncesionarit.
- 8.4 Detyrat e Inxhinierit të Pavarur përcaktohen në Marrëveshjen e Inxhinierit të Pavarur, në përputhje me Kontratën dhe Shtojcën 7, por as emërimi ose angazhimi i Inxhinierit të Pavarur, as ushtrimi ose mos-ushtrimi nga Inxhinieri i Pavarur i detyrave të tij nuk do të lehtësojnë në asnjë mënyrë Koncesionarin nga asnjë përgjegjësi ose nga asnjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate, përvec se kur kjo Kontratë apo Marrëveshja e Inxhinierit të Pavarur ngarkon Inxhinierin e Pavarur shprehimisht për të ushtruar detyrat përkatëse në lidhje me këto përgjegjësi të Koncesionarit.
- 8.5 Përpara zgjidhjes së një mosmarrëveshje, Inxhinieri i Pavarur u jep Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit mundësinë që të shprehin mendimet e tyre në lidhje me çështjen përkatëse.
- 8.6 Koncesionari dhe Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojnë dhe do të njohin tagrat që i janë dhënë Inxhinierit të Pavarur dhe secila nga Palët do të sigurojë qasje, informacion dhe ndihmë

në mënyre të tillë që Inxhinieri i Pavarur mund të kryejë detyrat e tij sipas Marrëveshjes së Inxhinierit të Pavarur.

8.7 Koncesionari dhe Autoriteti Kontraktues bien dakord të pranojnë si përfundimtar dhe detyrues çdo vendim të marrë nga Inxhinieri i Pavarur gjatë ushtrimit të detyrave të tij, sipas Marrëveshjes së Inxhinierit të Pavarur dhe nëse nuk është rënë dakord ndryshe në Marrëveshjen e Inxhinierit të Pavarur.

8.8 Në rast se veprimtaria e Inxhinierit të Pavarur në funksion të zbatimit të kësaj Kontrate dhe Marrëveshjes së Inxhinierit të Pavarur, pezullohet, ndalohe apo braktiset për cfarëdolloj arsye, , Palët bien dakord që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë përfaqësues i autorizuar nga ai, do të kryejë funksionin e Inxhinierit të Pavarur deri në emërimin e Inxhinierit të Pavarur apo zëvendësimin e tij, sipas nenit 8.1.

8.9 Autoriteti Kontraktues detyrohet të emërojë dhe/ose zëvendësojë Inxhinierin e Pavarur brenda 30 ditëve kalendarike nga njoftimi që Koncesionari do t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues për emërimin apo zëvendësimin e Inxhinierit të Pavarur. Në rast të vonesave të pajustificuara nga ana e Autoritetit Kontraktues në emërimin ose zëvendësimin e Inxhinierit të Pavarur të cilat shkaktojnë vonesa në afatet e kryerjes së Punimeve nga ana e Koncesionarit, atëherë ky i fundit do të përfitojë shtyrje të këtyre afateve përkatëse në të njëjtën kohëzgjatje të vonesave.

8.10 Koncesionari pranon dhe merr përsipër:

(a) të sigurojë që Inxhinierit të Pavarur i është dhënë qasje e mjaftueshme në çdo kohë, në Vendndodhje dhe çdo ambient tjetër në të cilin po ndodh projektimi ose ndonjë pjesë e Punimeve, për qëllimin e monitorimit të Punimeve, me kusht që Inxhinieri i Pavarur ose përfaqësuesit e tij, sipas rastit, t'i nënshtrohen dhe të jenë në përputhje me procedurat e zbatueshme të sigurisë të zbatuara nga Koncesionari për individët që kanë qasje në Vendndodhje;

(b) të sigurojë që Inxhinierit të Pavarur t'i jepet, me njoftim të arsyeshëm dhe gjatë orëve normale të punës, qasje pranë personave, përfshirë pranë nënkontraktorëve të Koncesionarit, dhe dokumentacionit që Inxhinieri i Pavarur mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të zbatuar detyrat e tij;

(c) të njoftojë paraprakisht dhe të lejojë pjesëmarrjen e Inxhinierit të Pavarur në takimet për ecurinë e Punimeve, të cilat zhvillohen ndërmjet Koncesionarit dhe nënkontraktorëve të Koncesionarit;

(d) të sigurojë çdo ndihmë dhe qasje në çdo pajisje ose materiale siç mund të kërkohet nga Inxhinieri i Pavarur;

(e) të lejojë Inxhinierin e Pavarur, me anë të një njoftimi paraprak prej (1) Dite Pune, të inspektojë, kontrollojë, hetojë, testojë, çdo aspekt të Punimeve dhe ecurinë e tyre, me kusht që Inxhinieri i Pavarur të angazhohet për shmangien, në mënyrë të arsyeshme, të çdo ndërprerje të panevojshme të Punimeve;

(f) të mos ndërhyjë ose të pengojë në kryerjen e detyrave të Inxhinierit të Pavarur që rrjedhin nga kjo Kontratë ose nga Marrëveshja e Inxhinierit të Pavarur;

(g) të korrigjojë menjëherë çdo defekt, gabim, vonesë ose mospërmbushje të identifikuar nga Inxhinieri i Pavarur.

8.11 Tarifat dhe shpenzimet e Inxhinierit të Pavarur do të merren përsipër nga Koncesionari në

përputhje me Marrëveshjen e Inxhinierit të Pavarur. Çdo kosto e marre persiper nga Koncesionari per Inxhinerin e Pavarur konsiderohet si shpenzim i Projektit per qëllimin e realizimit te investimeve.

9. DEKLARIMET DHE GARANCITË E PALËVE

9.1 Secila Palë garanton që gjatë Afatit të Kontratës:

- (a) do të ketë, mbajë dhe përmbushë kërkesat e të gjitha Lejeve dhe Licencave për të cilat Pala ka përgjegjësinë për t'i siguruar dhe mbajtur;
- (b) do të veprojë në përputhje me të gjithë Legjislacionin e Zbatueshëm dhe, nëpërmjet veprimeve apo mosveprimeve të saj të qëllimshme apo të pakujdesshme, nuk do të bëjë që Pala tjetër të shkelë Legjislacionin e Zbatueshëm apo këtë Kontratë; dhe
- (c) do t'i japë Palës tjetër të gjitha dokumentet, të dhënat, certifikatat apo informacione të tjera në lidhje me objektin e kësaj Kontrate me kërkesën e arsyeshme të Palës tjetër (gjithashtu dhe në lidhje me kërkesën e bërë ndaj Palës tjetër nga një Autoritet Kompetent për sa më sipër), dhe do t'i dorëzojë çdo Autoriteti Kompetent të gjitha dokumentet, të dhënat, certifikatat apo informacione të tjera në lidhje me objektin e kësaj Kontrate që mund të kërkohen herë pas herë nga ana e Autoritetit Kompetent.

9.2 Koncesionari dhe /ose Ofertuesit deklaron dhe garanton Autoritetin Kontraktues si më poshtë:

- (a) është i organizuar në mënyrë të rregullt, ekziston në mënyrë të vlefshme dhe është në gjendje të mirë financiare, sipas Legjislacionit të Zbatueshëm;
- (b) Koncesionari (në cilësinë e SPV-së) është një shoqëri me qëllim të posaçëm dhe se aktivitetet tregtare në të cilin lejohet të përfshihet janë të kufizuara në sa është e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të Koncesionarit në kuadrin e kësaj Kontrate, përgjatë Afatit të saj;
- (c) ka kompetencë për të:
 - (i) nënshkruar këtë Kontratë dhe çdo dokumentacion tjetër të lidhur me të në të cilin është palë;
 - (ii) zbatuar këtë Kontratë dhe çdo dokumentacion tjetër të lidhur me të, zbatimin i të cilëve kërkohet nga kjo Kontratë; dhe
 - (iii) përmbushur detyrimet e veta sipas kësaj Kontrate dhe ka ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të autorizuar nënshkrimin, zbatimin dhe përmbushjen e saj;
- (d) nënshkrimi, zbatimin dhe përmbushja e detyrimeve referuar në nenin 9.2 (c) nuk shkelin apo bien ndesh me asnjë Legjislacion të Zbatueshëm, dispozitë të dokumenteve statutove të tij, urdhër apo vendim gjyqësor apo të ndonjë Autoriteti Kompetent që i zbatohet atij apo asetëve të tij ose detyrimeve kontraktuale për ose që prekin atë apo ndonjë nga asetet e tij;
- (e) ka nënshkruar këtë Kontratë dhe detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate përbëjnë detyrimet ligjore, të vlefshme dhe të zbatueshme e të ekzekutueshme në përputhje me kushtet përkatëse sipas ligjeve të zbatueshëm për falimentimin, riorganizimin, paaftësinë



paguese, moratoriumin apo ligje të tjera të ngjashme që prekin të drejtat e kreditorit në përgjithësi;

- (f) nuk ka ndodhur asnjë rast mospërbushjeje (apo rast që nëpërmjet njoftimit dhe/ose kalimit të kohës do të përbënte rast mospërbushjeje) lidhur me të dhe se një rast i tillë nuk do të ndodhte si rezultat i hyrjes së tij në këtë Kontratë apo përbushjes së detyrimeve të tij sipas saj;
- (g) asnjë padi ose procedurë gjyqësore, arbitrazhi apo administrative para një gjykate, tribunali, organi qeveritar, agjencie, zyrtari apo arbitri nuk ka filluar ose, në dijeninë e tij, nuk është kërcënuar se do të fillojë kundër tij apo Shoqërive të Lidhura me të që, nëse do të zgjidhej jo në favor të tij, do të shkaktonte një ndryshim material negativ në gjendjen financiare të kësaj Pale apo në aftësinë e saj për të përbushur detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate, ose që mund të ndikojë në ligjshmërinë, vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e kësaj Kontrate ndaj tij;
- (h) nuk mbështetet në asnjë deklaratë të Palës tjetër të ndryshme nga ato të përcaktuara shprehimisht në këtë Marrëveshje.
- (i) Ortakët/Aksionarët e Koncesionarit janë: Mabco Constructions SA, Yda Insaat Sanayi Ve Ticaret Anonim Sirketi, 2A Group Sh.P.K.

9.3 Autoriteti Kontraktues deklaron dhe garanton si më poshtë:

- (a) ka nënshkruar këtë Kontratë dhe detyrimet e tij sipas kësaj Kontratë përbëjnë detyrimet ligjore, të vlefshme dhe të zbatueshme e të ekzekutueshme ndaj tij në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë Kontratë;
- (b) zotëron të drejta pronësie të plota dhe të vlefshme mbi Vendndodhjen;
- (c) nuk ka tjetërsuar Vendndodhjen ose ndonjë pjesë të saj;
- (d) hidrovoret dhe/ose kanalet kulluese veprimtaria e të cilave prek ose ka të bëjë me Vendndodhjen janë në gjendje funksionale;
- (e) ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore në lidhje me organizimin e procedurës konkurruese si dhe atë të përzgjedhjes së Koncesionarit, si dhe ka përbushur detyrimet ligjore në lidhje me konsultimin e autoriteteve të tjera kompetente në lidhje me këtë procedurë (nëse është e zbatueshme);
- (f) përputhshmërinë e Dokumentacionit të Autoritetit Kontraktues, të vënë në dispozicion të Koncesionarit me gjendjen dhe kushtet reale të Vendndodhjes.

10. DETYRIMET E KONCESIONARIT

Periudha nga Data Efektive deri në Datën e Fillimit të Punimeve

10.1 Menjëherë pas Datës Efektive, Koncesionari do të:

- (a) Aplikojë dhe marrë Lejet dhe Licencat përkatëse për fillimin e Punimeve, përfshirë por pa u kufizuar në:
 - (i) lejen zhvillimore;



- (ii) lejen e ndërtimit;
- (iii) lejen mjedisore/VNM e thelluar;
- (iv) çdo leje, licencë ose miratim tjetër të nevojshëm për fillimin e Punimeve;
- (v) çdo policë sigurimi që nevojitet për fazën e Punimeve sipas Shtojcës 33.

Për të mënjeluar çdo dyshim, Palët bien dakord që në rast të vonesave në lëshimin e Lejeve dhe Licencave si dhe çdo leje, licence ose miratimi të përcaktuar në këtë nen, të cilat shkaktohen për arsye që nuk lidhen me përmbushjen e detyrimeve (procedurale dhe materiale përkatëse) nga ana e Koncesionarit, atëherë Koncesionari do të përfitojë një shtyrje të afateve të Datës së Fillimit të Punimeve me një kohëzgjatje proporcionale me këto vonesa.

(b) Dorëzojë Autoritetit Kontraktues Lejet dhe Licencat e mësipërme;

10.2 Koncesionari njofton Autoritetin Kontraktues lidhur me kryerjen e detyrimeve të parashikuara në nenin 10.1. Brenda shtatë (7) Ditë Pune nga marrja e këtij njoftimi nga Autoriteti Kontraktues, Koncesionari dhe Autoriteti Kontraktues do të nënshkruajnë certifikatën e fillimit të Punimeve, bashkëlidhur si Shtojca 23 (“**Certifikata e Fillimit të Punimeve**”).

10.3 Data e nënshkrimit të Certifikatës së Fillimit të Punimeve do të jetë Data e Fillimit të Punimeve (“**Data e Fillimit të Punimeve**”).

10.4 Koncesionari do të nisë Punimet jo më vonë se Data e Synuar e Fillimit të Punimeve;

10.5 Nëse Koncesionari nuk fillon Punimet brenda Datës së Synuar të Fillimit të Punimeve, Koncesionari do t’i paguajë Autoritetit Kontraktues penaltet në vlerën e dhjetë mijë eurove (10,000 €) për çdo muaj vonesë përtej Datës së Synuar të Fillimit të Punimeve. Palët bien dakord që penalteti i përcaktuar në këtë nen:

(i) nuk paguhet nëse Data e Fillimit të Punimeve është penguar ose shtyrë si pasojë e:

- një Ngjarjeje të Forcës Madhore, dhe/ose Veprimi Material i Pafavorshëm Qeveritar; ose
- vonesave në lëshimin e Lejeve dhe Licencave si dhe çdo leje, licence miratimi të përcaktuar në këtë nen, të cilat shkaktohen për arsye që nuk lidhen me përmbushjen e detyrimeve (procedurale dhe materiale përkatëse) nga ana e Koncesionarit, atëherë Koncesionari do të përfitojë një shtyrje të afateve të Datës së Fillimit të Punimeve me një kohëzgjatje proporcionale me këto vonesa;
- nëse Palët bien dakord për një Datë të mëvonshme të Synuar të Fillimit të Punimeve; dhe

(ii) do të paguhet për periudhë jo më të gjatë se 180 ditë, pas lëshimit të faturës përkatëse nga ana e Autoritetit Kontraktues. Nëse në përfundim të periudhës 180 ditore Koncesionari nuk ka paguar shumën totale ose një pjesë të shumës totale të penalteteve, dhe Inxhinieri i Pavarur konfirmon me shkrim mospërmbushjen nga ana e Koncesionarit, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të tërheqë këtë vlerë nga Sigurimi i Kontratës.



Punimet

- 10.6 Koncesionari fillon Punimet në Datën e Fillimit të Punimeve, pasi ka njoftuar me shkrim paraprakisht Autoritetit Kontraktues, jo më vonë se 7 Ditë Pune përpara Datës së Fillimit të Punimeve. Koncesionari prokuron mjetet e nevojshme dhe kryen Punimet me investimet dhe shpenzimet e tija, në përputhje të plotë me kërkesat e Legjislacionit të Zbatueshëm, këtë Kontratë, Masterplanin, Planin e Financimit, Projektin e Zbatimit, Projektin e Detajuar Teknik, Planin e Menaxhimit Mjedisor, Treguesit Kryesorë të Performancës dhe Praktikën e Mirë të Industrisë. Koncesionari pranon detyrimet e tij dhe angazhohet si më poshtë:

Nënkontraktorët

- 10.7 Koncesionari do të përmbushë detyrimet e tij sipas Kontratës në lidhje me Punimet, Shërbimet Aeroportuale dhe Shërbimet Tregtare, vetë ose nëpërmjet nënkontraktorëve. Koncesionari është tërësisht përgjegjës për veprimet, vonesën dhe pakujdesinë e nënkontraktorëve të tij si dhe të përfaqësuesve dhe punëtorëve të nënkontraktorëve sikur të ishin veprimet, vonesat dhe pakujdesia e vetë Koncesionarit. Koncesionari ka për detyrë:
- (i) të mbajë një regjistër të të gjithë nënkontraktorëve si dhe nga një kopje të të gjitha kontratave të lidhura me nënkontraktorët, të cilin e vë në dispozicion të Autoritetit Kontraktues, NJZP-së dhe Inxhinierit të Pavarur;
 - (ii) të mos nënkontrakttojë më shumë se dyzet përqind (40%) të vlerës totale të Kontratës, në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm;
 - (iii) të prokurojë punët dhe shërbimet kundrejt nënkontraktorëve në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, Praktikën e Mirë të Industrisë dhe të ruajë dokumentacionin përkatës për secilën procedurë, për efekt verifikimi nga Autoritetit Kontraktues, NJZP-ja dhe Inxhinieri i Pavarur.
 - (iv) Në kuptim të nenit 10.7 (ii) nuk do të quhen marrëveshje nënkontraktore Marrëveshja e Operimit dhe Mirëmbajtjes si dhe marrëveshjet e lidhura ndërmjet Koncesionarit dhe Ofertuesve.

Defektet

- 10.8 Gjatë Periudhës së Përgjegjësisë së Defekteve, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë t'i kërkojë dhe Koncesionari ka detyrimin të kryejë riparimin e çdo Defekti në Punime që shfaqet gjatë kësaj periudhe, me shpenzimet e veta dhe në përputhje me këtë Kontratë. Koncesionari është përgjegjës dhe kryen sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur çdo ndërtim, riparim ose Punime të tjera që kërkohen si rrjedhojë e një Defekti, sipas kushteve të mëposhtme:

- (a) Koncesionari njofton menjëherë Autoritetin Kontraktues dhe Inxhinierin e Pavarur mbi shfaqjen e një defekti (ose pas marrjes së njoftimit nga Autoriteti Kontraktues mbi shfaqjen e një defekti); dhe
- (b) Fillon menjëherë riparimin e Defektit ose zëvendësimin përkatës; dhe
- (c) Njëkohësisht bën të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të zbutur dhe mos përkeqësuar pasojën e atij Defekti.
- (d) Nëse Koncesionari dështon në riparimin e Defektit sipas këtij neni, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë, pas marrjes së konfirmimit me shkrim nga Inxhinieri i

Pavarur, të kontraktojë një person të tretë për riparimin e Defektit dhe të t'i faturojë kostot përkatëse Koncesionarit.

- (e) Me përfundimin e riparimit të Punimeve, Inxhinieri i Pavarur verifikon nëse riparimi është kryer në përputhje me Termat e Referencës. Nëse Inxhinieri i Pavarur i konfirmon me shkrim Autoritetit Kontraktues se riparimi nuk i respekton Termat e Referencës, ky i fundit i kërkon Koncesionarit të kryejë punimet e nevojshme sipas konstatimit të Inxhinierit të Pavarur;
- (f) Çdo pjesë e Punimeve e cila riparohet gjatë Periudhës së Përgjegjësisë së Defekteve do të jetë e garantuar nga Koncesionari për një periudhë të barabartë me 365 ditë duke filluar nga dita e verikimit dhe pranimit të riparimit nga Inxhinieri i Pavarur;
- (g) Koncesionari do të kryjë përpjekje të arsyeshme për marrjen e garancive mbi pajisjet dhe materialet e përdorura në kuadër të Punimeve nga prodhuesit e pajisjeve dhe materialeve në fjalë. Koncesionari do të ndjekë procedurat përkatëse për zëvendësimin dhe/ose riparimin e pajisjeve dhe materialeve të garantuara nga ana e prodhuesve të tyre. Instalimi i pajisjeve dhe materialeve të garantuara sipas këtij neni duhet të kryhet nga Koncesionari dhe/ose nënkontraktorët e tij në përputhje me garancinë përkatëse. Çdo garanci mbi produktin që përdoret në kuadër të Punimeve, afati i së cilës tejkalon Periudhën e Përgjegjësisë së Defekteve, do të kalohet/cedohet në përfitim të Autoritetit Kontraktues ose në përfitim të një enti të caktuar prej tij.

Ndryshimet

10.9 Për efekt të këtij neni, ndryshim do të thotë një ndryshim në Punime që përfshin ndryshime në afate, projektim, natyrën e punimeve, cilësi, formë, karakteristika, pozicion, dimensione, nivel ose vendosje të Punimeve, i kërkuar nga Koncesionari ose Autoritetit Kontraktues, ose si rrjedhojë i ndryshimeve në Projektin e Detajuar Teknik, në Projektin e Zbatimit ose në Termat e Referencës. Për efekt qartësie, një ndryshim në Punime, në afate, projektim, natyrën e punimeve, cilësi, formë, karakteristika, pozicion, dimensione, nivel ose vendosje të Punimeve që vjen si rezultat i një gabimi, defekti, mangësie, ceni në projektim, i Koncesionarit, i nënkontraktorit të Koncesionarit ose i një Shoqërie të Lidhur me Koncesionarin, nuk do të konsiderohet si ndryshim dhe do të korigjohet nga Koncesionari me kostot dhe shpenzimet e tij. Ndryshimet mund të kryhen në përputhje me kushtet e mëposhtme:

- (a) Koncesionari mund t'i kërkojë Autoritetit Kontraktues dhe Inxhinierit të Pavarur, ndryshime në Punime, duke paraqitur një njoftim me shkrim. Pas marrjes së miratimit nga Autoriteti Kontraktues, i cili mund të refuzohet, dhe nga Inxhinieri i Pavarur, Koncesionari kryen ndryshimet me shpenzimet e tij. Në rastin kur nevoja për ndryshim lind si pasojë e pasaktësive në Dokumentacionin e Autoritetit Kontraktues apo ka të bëjë me mospërmbushje të detyrimeve të kësaj Kontrate nga Autoriteti Kontraktues atëherë ndryshimet do të bëhen me kostot e Autoritetit Kontraktues, duke përfshirë këtu edhe kostot shtesë që mund të jenë të nevojshme për shërbimet e Inxhinierit të Pavarur. Palët mund të rregullojnë me marrëveshje mënyrën e përbalimit të kostove nga ana e Autoritetit Kontraktues. Nëse Koncesionari do të hasë vonesa për shkak të këtyre pasaktësive në afatet e kryerjeve të Punimeve atëherë ai do të përfitojë një shtyrje proporcionale dhe të arsyeshme të këtyre afateve.
- (b) Autoriteti Kontraktues, mund t'i kërkojë Koncesionarit ndryshime në Punime, duke paraqitur një njoftim me shkrim. Koncesionari i kryen ndryshimet pas marrjes së miratimit nga Inxhinieri i Pavarur. Kostot për ndryshimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë këtu edhe kostot shtesë që mund të jenë të nevojshme për shërbimet e Inxhinierit të Pavarur, përballohen nga Autoriteti Kontraktues dhe pagesat

e kostove në fjalë rregullohen sipas marrëveshjes përkatëse midis Palëve. Nëse Koncesionari do të hasë vonesa për shkak të kërkesës për ndryshim, në afatet e kryerjeve të Punimeve, atëherë ai do të përfitojë një shtytje proporcionale dhe të arsyeshme të këtyre afateve.

Skicat

- 10.10 Pas përfundimit të Punimeve dhe në çdo rast jo më vonë se Data e Synuar e Operimit, Koncesionari i dorëzon Autoritetit Kontraktues skicat e përfunduara (as is) të Projektit, në 4 kopje fizike dhe 1 kopje elektronike. Skicat duhet të jenë në format të tillë dhe të përmbajnë detaje të mjaftueshme që mund të lejojnë Autoritetin Kontraktues të operojë, mirëmbajë dhe tjetërsojë infrastrukturën e VIA-s. Koncesionari i përditëson skicat nëse është e nevojshme dhe i dorëzon Autoriteti Kontraktues kopjet e përditësuara. Dorëzimi i skicave nga Koncesionari dhe pranimi i tyre nga Autoriteti Kontraktues nuk e zhvesh Koncesionarin nga detyrimet dhe përgjegjësia e tij sipas kësaj Kontrate.

Grupi i Punës

- 10.11 Palët do të mundësojnë që përfaqësuesit e tyre dhe Inxhinieri i Pavarur të takohen të paktën një herë në çdo tre muaj deri në Datën e Operimit me qëllim rishikimin e planeve dhe mbarëvajtjen e Punimeve, diskutimin e ndryshimeve të mundshme dhe zgjidhjen me mirëbesim të çdo mosmarrëveshjeve që lidhet me Punimet.

Garancitë

- 10.12 Për qëllim të parashikimeve të neneve 10.6 deri në 10.9, Koncesionari garanton se:
- (a) Punimet dhe fazat përkatëse, duke përfshirë projektimin dhe EPC, do të jenë në përputhje me kushtet materiale të kësaj Kontrate, Termave të Referencës, Projektin e Detajuar Teknik, Legjislacionin e Zbatueshëm dhe Praktikën e Mirë të Industrisë, dhe
 - (b) Punimet do të jenë pa defekte materiale dhe pa mangësi, do të projektohen, implementohen, ndërtohen në përputhje me Praktikën e Mirë të Industrisë, duke përfshirë praktikën, teknikat, metodat, standartet dhe procedurat më të mira dhe të njohura dhe të zbatuara nga kontraktorët e aftë, të kujdesshëm dhe me eksperiencë në industrinë e aviacionit ndërkombëtar në lidhje me prokurimin, ngritjen dhe instalimin e pajisjeve, dhe të projektimit, projektimit inxhinierik dhe ndërtimit të aeroporteve të një madhësie dhe lloji të ngjashëm me VIA-n, dhe do të rezultojnë në një Aeroport të përfunduar dhe operacional;

Shkeljet

- 10.13 Nëse Koncesionari dështon në zbatimin e detyrimeve të tij sipas neneve 10.6 deri në 10.9, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë, pas marrjes së konfirmimit me shkrim nga Inxhinieri i Pavarur, të kryejë Punimet ose të kontrakttojë persona të tretë për kryerjen e tyre dhe mbajë nga Sigurimi i Kontratës, kosto që lidhen me kryerjen e punimeve nga personat e tretë në rast se dështimi është rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të Koncesionarit.
- 10.14 Koncesionari do të marrë Certifikatën e Aeroportit për VIA-n. Pas marrjes së një certifikimi të tillë, VIA do të duhet të qëndrojë e çertifikuar në çdo kohë gjatë Afatit të kësaj Kontrate.

Dokumentet e Projektit

- 10.15 Koncesionari do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktues, në një formë dhe

përmbajtje të pëlqyeshme për Autoritetin Kontraktues, si dhe të marrë miratimin me shkrim të Autoritetit Kontraktues, përpara Datës së Operimit, të dokumenteve të mëposhtme:

- (a) Masterplanin e VIA-s, të përditësuar;
- (b) Planin e Përgjithshëm të Aeroportit, të përditësuar;
- (c) Planin e Menaxhimit Mjedisor, të përditësuar;
- (d) Manualin e Aeroportit;
- (e) Manualin e Operimit dhe Mirëmbajtjes, i hartuar në përputhje me ICAO doc 9137;
- (f) Planin e Menaxhimit të Emergjencave;
- (g) Planin Strategjik të Marketingut;
- (h) Lejet dhe Licencat;
- (i) Lejen Mjedisore – VNM e thelluar;
- (j) Planin e Tranzicionit për fillimin e operimeve në VIA;
- (k) Skicat e përfunduara (as is);
- (l) Marrëveshjen për shërbimet e kontrollit ajror, të nënshkruar nga Koncesionari dhe Aibcontrol, ose nga pasuesi i tij;
- (m) Marrëveshjen e Operimit dhe Mirëmbajtjes;
- (n) Listën e Marrëveshjeve me Shoqëritë e Lidhura me Koncesionarin (nëse ka);
- (o) Treguesit Kryesorë të Performancës (KPI) që lidhen me operimin para Datës së Operimit;
- (p) Certifikatën e Aeroportit;
- (q) çdo policë sigurimi që nevojitet për fazën e operimit sipas Shtojcës 33.
- (r) Emrin e Vlerësuesit dhe kontrata me të, në lidhje me vlerësimin e përcaktuar në nenin 11.3 (d).

(dokumentet e mësipërm do të referohen së bashku si "**Dokumentet e Projektit**");

10.16 Koncesionari rishikon dhe përditëson dokumentet e përmendura në nenet 10.15 a) - 10.15 g), çdo katër (4) vjet duke filluar nga Data e Operimit. Koncesionari i dorëzon Autoritetit Kontraktues versionin e përditësuar të këtyre dokumenteve brenda 60 ditëve nga përvjetori i katërt i Datës së Operimit. Autoriteti Kontraktues miraton, rishikon dhe shpreh propozimet e tij mbi Masterplanin në përputhje me nenin 11.1.

Operimi dhe Mirëmbajtja

10.17 Me përmbushjen e kushteve të përvaktuara në Shtojcën 32, Palët nënshkruajnë Certifikatën e Operimit. Koncesionari fillon operimin në Datën e Operimit. Nëse Koncesionari nuk arrin të

fillojë operimin brenda Datës së Synuar të Operimit, Koncesionari do t'i paguajë Autoritetit Kontraktues nje penalitet në vlerën e dhjetë mijë eurove (10,000 €) për çdo muaj vonesë përtej Datës së Synuar të Operimit. Palët bien dakord që penaliteti i përcaktuar në këtë nen:

- (i) nuk paguhen nëse Data e Operimit është penguar ose shtyrë si pasojë e:
- një Ngjarjeje të Forcës Madhore dhe/ose Veprimi Material të Pafavorshëm Qeveritar; ose
 - nëse Palët bien dakord për një Datë të Synuar të mëvonshme të Operimit; dhe
 - vonesave ne marrjen e Lejeve dhe Licensave të nevojshme të lidhura me kolaudimin dhe përdorimin e Aseteve, përfshirë edhe certifikatën e përdorimit dhe/ose Certifikatës së Aeroportit, te cilat nuk lidhen me përmbushjen e detyrimeve (procedurale dhe materiale përkatëse) nga ana e Koncesionarit;
- (ii) do të paguhen për periudhë jo më të gjatë se 180 ditë, pas lëshimit të faturës përkatëse nga ana e Autoritetit Kontraktues. Nëse në përfundim të periudhës 180 ditore Koncesionari nuk ka paguar shumën totale ose një pjesë të shumës totale të penalteteve, dhe Inxhinieri i Pavarur konfirmon me shkrim mospërmbushjen nga ana e Koncesionarit, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të tërheqë vlerën e plotë të Sigurimit të Kontratës.

Për të mënjeluar çdo dyshim, Palet bien dakord që ne rast te vonesave ne lëshimin e Lejeve dhe Licensave të nevojshme të lidhura me kolaudimin dhe përdorimin e Aseteve, përfshirë edhe certifikatën e përdorimit, dhe/ose e Certifikatës së Aeroportit, te cilat shkaktohen per arsye qe nuk lidhen me përmbushjen e detyrimeve te procedurave përkatëse nga ana e Koncesionarit, atëherë Koncesionari do te perfitoje nje shtyrje te afateve të Datës së Operimit me nje kohëzgjatje proporcionale me këto vonesa.

Shërbimet Aeroportuale

- 10.18 Koncesionari do të sigurojë ofrimin e Shërbimeve Aeroportuale dhe Shërbimeve Tregtare për të gjithë Afatin e kësaj Kontrate në përputhje me Termat e Referencës, Manualin e Operimit dhe Mirëmbajtjes të Aeroportit, Treguesit Kryesorë të Performancës (KPI), Planin e Zbatimit, Planin e Emergjencës së Aeroportit, Masterplanin, Planin e Menaxhimit të Mjedisit, Praktikën e Mirë të Industrisë dhe Legjislacionin e Zbatueshëm, duke marrë përsipër të gjitha kostot dhe shpenzimet e nevojshme. Me përjashtim të çdo ndërprerje ose pezullimi të operacioneve në përputhje me nenin 7.8 ose që mund të rezultojë si pasojë e një Emergjence, Forcë Madhore, Veprimi Material të Pavorshëm Qeveritar ose ndonjë ndërprerje të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues ose Autoritetet Kompetente, siç parashikohet në këtë Kontrate Koncesionari merr përsipër të sigurohet që Aeroporti të hapet dhe të funksionojë në çdo kohë, gjatë Afatit së kësaj Marrëveshjeje.

Zyrat e Administratës

- 10.19 Koncesionari përpara Datës së Operimit, do t'i sigurojë Autoritetit Kompetent pa asnjë kosto ose shpenzim shtesë hapësirat e nevojshme për zyra dhe/ose ambiente të tjera si hapësirë parkimi) që i ofrohet çdo Autoriteti Kompetent që ofron shërbime shtetërore në VIA, përveç nëse është rënë dakord ndryshe midis Koncesionarit dhe Autoritetit Kompetent që i ofron këto shërbime.

- 10.20 Koncesionari, do ti garantojë (i) Autoritetit Kompetent që ofron Shërbime Shtetërore në VIA përpara Datës së Operimit dhe (ii) Inxhinierit të Pavarur pas Dates Efektive, zyra dhe ambiente të tjera të nevojshme, siç mund të kërkohen nga Autoritetet Kompetente ose nga Inxhinieri i Pavarur dhe për të cilat Koncesionari ka shprehur dakordësinë, pa asnjë kosto ose shpenzim shtesë për Autoritetin Kompetent ose Inxhinierin e Pavarur.
- 10.21 Çdo zyrë e lëshuar nga Koncesionari për Autoritetin Kompetent ose Inxhinierin e Pavarur do të dorëzohet, pa përfshirë mobiljet, pajisjet e zyrës dhe furnizimet me materiale, në të njëjtin standard dhe cilësi si zyrat, hapësirat dhe objektet që do të përdoren nga Koncesionari dhe do të jenë me dimensione dhe vendndodhje sipas dakordësimeve midis Autoritetit Kompetent ose Inxhinierit të Pavarur, sipas rastit, dhe Koncesionarit.

Perimetri i Sigurisë

- 10.22 Koncesionari do të instalojë dhe mirëmbajë, një perimetër të nevojshëm të sigurisë, gardhin ose barrierat rrethuese dhe kontrollimin e hyrjeve brenda dhe përreth Perimetrit të Rrethimit të Vendndodhjes, në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, duke marrë përsipër të gjitha kostot dhe shpenzimet e nevojshme.

Pajisjet

- 10.23 Koncesionari, me shpenzimet e tij, do të kujdeset dhe mirëmbajë në kushte të mira pune (duke përfshirë por pa u limituar, televizor me qark të mbyllur, pajisjet kompjuterike dhe ato të komunikimit) të një cilësie dhe sasi të mjaftueshme sipas nevojave për ofrimin e Shërbimeve Aeroportuale, duke përfshirë por pa u limituar në Shërbimet e sigurisë, Shërbimet CFR dhe shërbimet mjekësore në përputhje me Termat e Referencës, Manualin e Operimit dhe Mirembajtjes së Aeroportit, Projektin e Detajuar Teknik, Treguesit Kryesore të Performancës, Planin e Emergjencës së Aeroportit, Masterplanin, Planin e Menaxhimit Mjedisor, Praktikën e Mirë të Industrisë si dhe Legjislacionin e Zbatueshëm. Koncesionari duhet të sigurojë dhe mirëmbajë në gjendje të mirë me shpenzimet e tij, gjithashtu dhe pajisjet e ndihmës vizuale në një sasi dhe cilësi të mjaftueshme, siç është e nevojshme, në lidhje me ofrimin e shërbimeve të kontrollit të trafikut ajror nga ana e Autoritetit Kontraktues.

Emergjencat

- 10.24 Përgjatë Afatit të kësaj Kontrate, Koncesionari do të koordinojë me Autoritetin Kompetent mirëmbajtjen, kontrollin dhe implementimin e Planit të Emergjencës së Aeroportit dhe do të jetë përgjegjës për koordinimin e të gjitha veprimeve në rast Emergjence. Koncesionari pranon dhe bie dakord, që çdo Autoritet Kompetent mund të ndër marrë këto hapa sipas rastit për të zvogëluar ose parandaluar ndonjë rast Emergjence (duke përfshirë por pa u limituar në ndërprerjen ose pezullimin e operimit të VIA-s si rezultat i Emergjencave, në përputhje me Planin e Emergjencës së Aeroportit), por me kusht që pezullimi ose mbyllja të kenë një karakter të përkohshëm dhe proporcional me rastin e Emergjencës). Koncesionari, me mirëbesim dhe me kujdesin e duhur, do të ofrojë të gjithë ndihmën dhe asistencën e nevojshme për Autoritetet Kompetente.

Barazia

- 10.25 Përveç nëse kërkohet ndryshe nga kjo Kontratë, Koncesionari do të ofrojë qasje në Shërbimet Aeroportuale dhe Shërbimet Tregtare në kushte të njëjta për të gjithë Pasagjerët, Avionët dhe Përdoruesit e Aeroportit nga të gjithë shtetet.

Shërbimet.

10.26 Gjatë gjithë Afatit të kësaj Kontrate, Konkensionari, me shpenzimet e tij dhe në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, lidh marrëveshje me Autoritetin Kompetent ose palë të treta, sipas rastit, siç mund të jetë e nevojshme për të furnizuar ose siguruar VIA-n me shërbimet e mëposhtme, në masë të mjaftueshme, të sigurt dhe të besueshme:

- (a) ujë të pijshëm;
- (b) energji elektrike;
- (c) trajtim dhe evakuim të ujërave të zeza;
- (d) shërbime telekomunikimi (linja fikse dhe Ëireless); dhe
- (e) shërbimet e trajtimit të mbeturinave,

duke përfshirë, për secilin prej këtyre shërbimeve, çdo infrastrukturë të nevojshme që do të parashikohen në Projektin e Detajuar Teknik.

Ruajtja e mjedisit

10.27 Konkensionari do të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm sipas Legjislacionit të Zbatueshëm për të mbrojtur mjedisin në Vendndodhje dhe për të kufizuar dëmet për njerëzit dhe pronat që vijnë nga ndotja ose nga shkaqe të tjera të dëmshme për mjedisin që lidhen me ofrimin e Shërbimeve Aeroportuale dhe Shërbimeve Tregtare. Konkensionari do të sigurohet (për aq sa është në kontrollin e tij) që emëtimet në ajër, sipërfaqe dhe shkarkimet nëntokësore dhe shkarkimi dhe trajtimi i mbetjeve të VIA-s ose që krijohen nga veprimtaria e Konkensionarit në Vendndodhje përgjatë Afatit do të kryhen në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm dhe Planin e Menaxhimit Mjedisor. Për shmangien e çdo dyshimi, Konkensionari nuk është përgjegjës për ndotjen akustike të shkaktuar nga zhurmat e Avionëve.

10.28 Konkensionari garanton se do të sigurojë që të gjithë nënkontraktorët dhe marrësit e Shërbimeve Tregtare do të përmbushin Planin e Menaxhimit Mjedisor dhe Legjislacionin e Zbatueshëm mjedisor në lidhje me veprimtaritë që kryhen në Vendndodhje ose në lidhje me VIA-n.

Personeli dhe Trajnimet

10.29 Konkensionari me shpenzimet e tij:

- (a) do të punësojë pranë VIA-s ose do të bëjë përpjekjet më të mira për të punësuar si personel në VIA një numri personash të trajnuar, me përvojë, të mjaftueshëm për të operuar Aeroportin, për të ofruar Shërbimet Aeroportuale dhe Shërbimet Tregtare, të gjitha në përputhje me Termat e Referencës, Treguesit Kryesorë të Performancës, Masterplanin, Plani e Menaxhimit të Mjedisit dhe Manualin e Operimit dhe Mirëmbajtjes;
- (b) për aq sa është e mundur, dhe në përputhje me këtë Kontratë dhe në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm i cili buron nga traktate ose konventa nderkombetare ku Shqipëria është pjesë, të punësojë ose angazhojë si personel në Aeroport pa cenuar nevojat e saj operacionale, shtetas shqiptarë; dhe
- (c) do të ofrojë programe të rregullta dhe të vazhdueshme trajnimi profesional, për të gjithë punonjësit dhe personelin e angazhuar nga Konkensionari në përputhje me Termat e Referencës.



Mirëmbajtja

- 10.30 Koncesionari, me kostot dhe shpenzimet e tij, do të mirëmbajë, zëvendësojë ose përndryshe të sigurojë mirëmbajtjen e VIA-s, në përputhje me Manualin e Operimit dhe Mirëmbajtjes.

Standardet dhe Niveli i Shërbimeve

- 10.31 Koncesionari do të operojë dhe mirëmbajë VIA-n dhe do të performojë Shërbimet Aeroportuale në përputhje me Manualin e Operimit dhe Mirëmbajtjes, Praktikën e Mirë të Industrisë, Treguesit Kryesorë të Performancës, Termat e Referencës dhe këtë Kontratë.
- 10.32 Koncesionari nuk duhet të lejojë që niveli IATA i shërbimeve në VIA të jetë poshtë Nivelit C.

Anketat

- 10.33 Gjashtëdhjetë (60) ditë pas Datës së Operimit dhe përgjatë Afatit të kësaj Kontrate, Koncesionari merr përsipër të sigurojë që Anketuesi i Pasagjerëve të kryejë të paktën një herë në vit gjatë një muaj sezoni të lartë (qoftë për mbërritjet ose nisjet,) një anketë e cila mat nivelin e kënaqësisë së Pasagjerëve dhe t'i raportojë rezultatet Koncesionarit. Koncesionari i siguron Autoritetit Kontraktues një kopje të secilës anketë të Pasagjerëve, së bashku me të gjitha të dhënat mbështetëse përkatëse, brenda (30) ditëve pas kryerjes së anketës.
- 10.34 Duke filluar nga viti i parë që prej Datës së Operimit, dhe duke vijuar gjatë Afatit të kësaj Kontrate, Koncesionari do të marrë pjesë çdo vit në Anketën AETRA.

Kontrolli i Shërbimeve.

- 10.35 Autoriteti Kontraktues ka të drejtën të kontrollojë çdo vit nivelin dhe përmbushjen e Shërbimit Aeroportuale nga një ekspert i pavarur i emëruar nga Autoriteti Kontraktues, për tu siguruar që VIA operohet dhe mirëmbahet në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kësaj Kontrate. Nëse ky ekspert i pavarur vendos se VIA nuk po operohet dhe mirëmbahet në përputhje me kushtet e Kontratës, atëherë Autoriteti Kontraktues ka të drejtën të ndryshojë llojin dhe nivelin e Shërbimeve Aeroportuale, Treguesit Kryesorë të Performancës dhe përcaktimet e Manualit të Operimit dhe Mirëmbajtjes, pas miratimit nga Koncesionari, pëlqimi i të cilit nuk mund të vonohet ose mohohet pa shkaqe të arsyeshme.

Shërbimet në Tokë

- 10.36 Koncesionari merr përsipër të garantojë të paktën një (1) agjent *ground handling*, i cili do të jetë i kualifikuar për të ofruar këto shërbime për të gjitha fluturimet që nisen ose mbërrijnë në VIA, dhe do të mundet ta ofrojë shërbimin e *ground handling* të VIAs. Koncesionari do të mundësojë Autoritetit Kontraktues një kopje të secilës marrëveshje me agjente private për ofrimin e shërbimit *ground handling* në VIA të lidhur në përputhje me këtë nen, brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i saj. Për shmangjen e dyshimit, Koncesionari do të lejojë kompanitë ajrore që operojnë me Avionet e tyre në VIA të vetë-menaxhojnë Avionët e tyre me kusht që ky shërbim të kryhet nga stafi dhe me pajisjet e kompanisë ajrore.

Lejet e Sigurisë.

- 10.37 Koncesionari, me shpenzimin e tij, do të lëshojë ose do të mundësojë që Autoriteti Kompetent të lëshojë, lejet e sigurisë në përputhje me këtë nen, për t'u dhënë mundësi mbajtësve të këtyre lejeve të kenë akses në zonat e siguruar në VIA. Koncesionari do të lëshojë ose do të mundësojë që Autoriteti Kompetent të lëshojë leje sigurie për punonjës të caktuar të

Koncensionarit dhe përfaqësues të caktuar të Personave të tretë me të cilët ka hyrë në marrëveshje tregtare ose financiare dhe për përfaqësuesit e caktuar të Autoritetit Kontraktues dhe Autoritetit Kompetent për të mundësuar që përfaqësuesit e tyre të kryejnë detyrat e tyre zyrtare në VIA: Koncensionari nuk do të lëshojë ose lejojë lëshimin e lejes së sigurisë për ndonjë person tjetër përveç atyre të përcaktuar në këtë nen, pa njoftuar paraprakisht Autoritetin Kontraktues.

Zgjerimi i VIA-s

10.38 Koncensionari do të fillojë punimet për zgjerimin e terminalit dhe hapësirave të tjera të VIA-s, në përputhje me afatet e mëposhtme dhe me kushtet e parashikuara nga neni 3 i Shtojcës 6:

- (a) Koncensionari do të fillojë punimet për fazën e parë të zgjerimit të terminalit jo më vonë se përvjetori i katërt i Datës së Operimit. Faza e parë e zgjerimit të terminalit do të përfundojë brenda 24 muajve nga fillimi i punimeve përkatëse ose brenda një afati të përcaktuar me shkrim nga Palët;
- (b) Koncensionari do të fillojë punimet për fazën e dytë të zgjerimit të terminalit dhe ndërtimit të hangarëve të VIA-s, jo më vonë se përvjetori i tetë i Datës së Operimit. Faza e dytë e zgjerimit të terminalit dhe ndërtimit të hangarëve do të përfundojë brenda dy viteve nga fillimi i punimeve përkatëse ose brenda një afati të përcaktuar me shkrim nga Palët;

10.39 Koncensionari kryen zgjerimin e VIA-s sipas këtij neni në përputhje të plotë me Masterplanin, Termat e Referencës, Manualin e Operimit dhe Mirëmbajtjes të Aeroportit, Treguesit Kryesorë të Performancës (KPI), Planin e Zbatimit, Planin e Emergjencës së Aeroportit, Planin e Menaxhimit të Mjedisit, Praktikën e Mirë të Industrisë dhe Legjislacionin e Zbatueshëm.

10.40 Nëse Koncensionari nuk mbaron punimet për zgjerimin e VIA-s sipas nenit 10.38(a) dhe/ose sipas nenit 10.38(b), respektivisht brenda 30 muajve nga përvjetori i gjashtë i Datës së Operimit ose brenda 30 muajve nga përvjetori i dhjetë i Datës së Operimit, Koncensionari do të paguajë Autoritetit Kontraktues një penaltet në vlerën e dhjetë mijë eurove (10,000 €) për çdo muaj vonesë përtej përvjetorit përkatës. Palët bien dakord që penalteti në këtë nen:

- (a) nuk paguhen nëse data përkatëse e fillimit të punimeve të zgjerimit sipas nenit 10.38(a) dhe/ose sipas nenit 10.38(b) është penguar ose shtyrë si pasojë e:
 - (i) një Ngjarjeje të Forcës Madhore, dhe/ose Veprimi Material i Pafavorshëm Qeveritar ; ose
 - (ii) vonesave në lëshimin e Lejeve dhe Licencave si dhe çdo leje, licence miratimi të përcaktuar në këtë nen, të cilat shkaktohen për arsye që nuk lidhen me përmbushjen e detyrimeve (procedurale dhe materiale përkatëse) nga ana e Koncensionarit, atëherë Koncensionari do të përfitojë një shtyrje të afateve të Datës së Fillimit të Punimeve me një kohëzgjatje proporcionale me këto vonesa;
 - (iii) nëse Palët bien dakord për një datë të mëvonshme të fillimit të punimeve të zgjerimit ; dhe
- (b) do të paguhen për periudhë jo më të gjatë se 180 ditë, pas lëshimit të faturës përkatëse nga ana e Autoritetit Kontraktues. Nëse në përfundim të periudhës 180 ditore Koncensionari nuk ka paguar shumën totale ose një pjesë të shumës totale të penalteteve, dhe Inxhinieri i Pavarur konfirmon me shkrim mospërmbushjen nga ana



e Koncesionarit, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të tërheqë vlerën e plotë të Sigurimit të Kontratës.

- (c) Per te shmangur çdo dyshim, Palet bien dakort qe ne rast te vonesave ne lëshimin e Lejeve dhe Licencave si dhe cdo leje, licence miratimi te përcaktuar ne kete nen, te cilat shkaktohen per arsye qe nuk lidhen me përmbushjen e detyrimeve te procedurave përkatëse nga ana e Koncesionarit, atëherë Koncesionari do te perfitoje nje shtyrje te afateve te fillimit ete punimeve te Zgjerimit me nje kohëzgjatje proporcionale me këto vonesa.

Llogaritë Bankare

- 10.41 Koncesionari do të mbajë një ose më shumë Llogari Bankare, në përputhje me këtë Kontratë gjatë Afatit. Të Ardhurat Bruto të Koncesionarit duhet të ruhen në depozita në Llogaritë Bankare dhe mund të tërhiqen në përputhje në rastet e mëposhtme:
- (a) për të paguar Tarifat e përmendura në nenin 6.6;
 - (b) për të paguar Tarifën Koncesionare;
 - (c) për të paguar shumat e pagueshme sipas marrëveshjeve nënkontraktore për kryerjen e Punimeve, me kusht që këto marrëveshje t'i jenë vënë në dispozicion Autoritetit Kontraktues;
 - (d) për të paguar shpenzimet operative sipas Buxhetit Operacional në fuqi;
 - (e) për të financuar investimet sipas Buxhetit Operacional në fuqi;
 - (f) për të kryer pagesa kundrejt ortakëve të Koncesionarit dhe/ose Shoqërive të Lidhura, në përputhje me këtë Kontratë;
 - (g) për të kryer pagesa kundrejt Institucioneve Financiare në përputhje me Marrëveshjet e Financimit.
- 10.42 Koncesionari do të mbajë në Llogaritë Bankare nje vlerë të mjaftueshme për të paguar këstin e ardhshëm përkatës të Tarifës Koncesionare.
- 10.43 Koncesionari do të hapë dhe mbajë Llogaritë Bankare në një ose disa banka të licensuara nga Banka e Shqipërisë, me reputacion të lartë, të miratuar nga Autoriteti Kontraktues.
- 10.44 Pas kryerjes së pagesave kundrejt Autoritetit Kontraktues, Koncesionari ka të drejtë të mbajë çdo dhe të gjitha shumat e depozituara në Llogaritë Bankare në Data e Përfundimit ose në Datën e Zgjidhjes së Parakohshme, sipas rastit.
- 10.45 Koncesionari do të depozitojë të gjitha fondet e marra nga cilido person ose burim në Llogarinë Bankare për përdorim të mëtejshëm në përputhje me këtë Kontratë dhe Marrëveshjen e Financimit. Koncesionari do të depozitojë në Llogarinë Bankare të gjitha dhe çdo fond të marrë prej tij nga qiramarrësit, furnitorët, nënkontraktorët ose ndonjë person tjetër në lidhje me operimin dhe mirëmbajtjen e VIA-s.
- 10.46 Koncesionari nuk do të pranojë të shtyjë ose të heqë dorë nga pagesa në kohë e çdo shume që do të përbënte të Ardhura Bruto nëse do të paguhej në kohë.
- 10.47 Koncesionari do të marrë masat e nevojshme në mënyrë që asnjë e ardhur e paguar që lidhet



me, ose rrjedh nga aktivitetet në VIA, ose nga trafiku ajror i VIA-s, nuk do t'i paguhet drejtpërdrejt aksionerëve ose ndonjë Shoqërie të Lidhur, me përjashtim të Shpërndarjes së Kapitalit.

- 10.48 Përgjatë Periudhës së Garancisë, Koncesionari, pa marrë miratimin paraprak me shkrim të Autoriteti Kontraktues dhe/ose të Albcontrollit, sipas rastit, nuk do t'i japë ndonjë personi ndonjë zbritje, lehtësirë ose kredi ndryshe nga normat dhe çmimet e tregut ose ndonjë ulje të tarifave ose shumave të tjera të pagueshme zakonisht në këmbim të angazhimit të këtij personi për të ndërmarrë ndonjë shpenzim që përndryshe do të ishte ose mund të ishte ndërmarrë nga Koncesionari.

Pikat e furnizimit me karburant.

- 10.49 Në përputhje me Projektin e Zbatimit, Masterplanin dhe Termat e Referencës, Koncesionari do të jetë përgjegjës për mundësimin e një ose më shumë pikave me furnizimin e karburantit dhe shërbimet e karburantit në VIA dhe do të sigurojë ofrimin e shërbimeve të duhura të ruajtjes dhe shpërndarjes së karburantit në çdo kohë gjatë Afatit të kësaj Kontrate. Koncesionari do të sigurojë që pika(t) e furnizimit me karburant dhe shërbimet e shpërndarjes përbushin të gjitha standardet përkatëse dhe janë në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm. Koncesionari mund të sigurojë shërbimet e mësipërme drejtpërdrejt ose përmes ofruesve të shërbimeve nga palë të treta.

Shkeljet

- 10.50 Nëse Koncesionari nuk përbush ndonjë nga obligimet e tij të parashikuar në nenet 10.17 deri në 10.40, Autoriteti Kontraktues mund të përdorë Sigurimin e Kontratës dhe do të mbajë fondet e nevojshme për të rregulluar këto shkelje ose gabim. Çdo tërheqje nga Koncesionari mbi Sigurimin e Kontratës do të jetë e barabartë me kostot e arsyeshme, të dokumentuara dhe shpenzimet e bëra ose që do të bëhen nga Autoriteti Kontraktues për të ndrequr këto shkelje ose gabim. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Koncesionarin me shkrim për çdo tërheqje të propozuar mbi Sigurimin e Kontratës dhe rrethanat që çojnë në përdorimin e saj. Në qoftë se, në gjykimin e Autoritetit Kontraktues, rrethana të tilla nuk përbëjnë një Emergjencë, Koncesionari do të ketë 15 ditë nga marrja e një njoftimi të tillë:

- (a) për të rregulluar shkeljen ose gabimin përkatës dhe për të njoftuar me shkrim Autoritetin Kontraktues se kjo shkelje ose gabim është rregulluar; ose
- (b) për të njoftuar Autoritetin Kontraktues se shkelja ose dështimi përkatës nuk mund të rregullohen ose ndryshohen brenda 15 ditësh nga marrja e këtij njoftimi, dhe të propozojë një afat brenda së cilës shkelja ose gabimi mund të rregullohen por jo më shumë se 30 ditë nga marrja e këtij njoftimi, brenda së cilit të rregullohet kjo shkelje dhe të njoftohet me shkrim Autoriteti Kontraktues mbi rregullimin e kësaj shkelje ose gabimi.

Nëse Autoriteti Kontraktues nuk ka marrë një njoftim të tillë me shkrim nga Koncesionari deri në fund të periudhës 15 ditore, ai mund të shfrytëzojë Sigurimin e Kontratës për të rregulluar këtë shkelje ose gabim. Nëse në gjykimin e Autoritetit Kontraktues, këto rrethana përbëjnë një Emergjencë, Autoriteti Kontraktues pasi të njoftojë Koncesionarin me shkrim për këtë tërheqje nga Sigurimi i Kontratës, menjëherë të tërheqë për të kuruar një shkelje ose gabim të tillë, Koncesionari do të depozitojë fondet e nevojshme për rikthimin e Sigurimit të Kontratës brenda 30 ditëve

nga tërheqja nga Autoriteti Kontraktues dhe do të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktues për këtë veprim.

10.51 Koncesionari mund të hyjë në marrëdhënie kontraktore me Shoqëri të Lidhura me Ofertuesit ose me persona të tjerë në kuadër të ofrimit të Shërbimeve Aeroportuale dhe/ose Shërbimeve Tregtare. Koncesionari mund të japë me qira ambiente të VIA-s kundrejt Shoqërive të Lidhura me Ofertuesit ose kundrejt personave të tjerë, përveç ambienteve të VIA-s të cilët janë të rezervuar për Autoritetet Kompetente për ofrimin e shërbimeve përkatëse ose për forcat ligjzbatuese të Republikës së Shqipërisë, përfshirë forcat e armatosura. Kontratat e nënshkuara nga Koncesionari sipas këtij neni duhet të respektojnë kushtet e mëposhtme:

- (a) Koncesionari mund të kontraktojë me një person të tretë, përfshirë një Shoqëri të Lidhur, për ofrimin e Shërbimeve Aeroportuale, me kusht që pala e tretë të përmbushë plotësisht Kriteret përkatëse të Kualifikimit, financiare dhe të eksperiencës që plotësojnë Ofertuesi(t) përkatës për ofrimin e Shërbimeve Aeroportuale, sipas shtojcës 9 të Dokumenteve të Tenderit;
- (b) Parashikimin e zgjidhjes së parakohshme të secilës prej këtyre kontratave ose cedimin e tyre në favor të Autoritetit Kontraktues ose të një enti të caktuar prej tij, në rast zgjidhjeje të Kontratës. Zgjidhja e parakohshme ose cedimi i kontratave për ofrimin e Shërbimeve Aeroportuale dhe/ose Shërbimet Tregtare, përfshirë dhënien me qira të ambienteve të VIA-s nuk do të shoqërohet me përgjegjësi financiare ose të ngarkojë Autoritetin Kontraktues ose ceduesin e tij me detyrimin për të paguar dëmshpërblim, si rrjedhojë e drejtëpërdrejtë e zgjidhjes së parakohshme ose cedimit të kontratave të sipërpërmendura;
- (c) Detyrimet dhe përgjegjësia e Koncesionarit për ofrimin e Shërbimeve Aeroportuale dhe Shërbimeve Tregtare nuk do të kufizohet, shuhet ose lehtësohet si rrjedhojë e nënshkrimit të kontratave të parashikuara në këtë nen;
- (d) Koncesionari nënshkruan një ose më shumë kontrata të parashikuara në këtë nen në bazë të parimeve të vlerës së tregut të konkurrencës së lirë (*arm's length basis*), mosdiskriminit të kontraktuesve në situata të njëjta ose të ngjashme, transparencës dhe respektimit të Legjislacionit të Zbatueshëm;
- (e) Përgjatë Periudhës së Garancisë, nëse Koncesionari nënshkruan një kontratë sipas këtij neni me një Shoqëri të Lidhur me Ofertuesit ose një kontratë me çilindo person e cila parashikon pagesa vjetore nga ose në favor të Koncesionarit me një vlerë mbi njëqind mijë euro (100,000€), atëherë Koncesionari do t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktues një kopje të kontratës në fjalë, brenda 15 Ditë Pune nga nënshkrimi i saj;
- (f) Kohëzgjatja e afatit të kontratave të parashikuara në nenin 10.16 nuk mund të tejkalojë Afatin e Kontratës;
- (g) Nëse Autoriteti Kontraktues vlerëson se një ose më shumë kontrata të parashikuara nga ky nen nuk respektojnë parimet e nenit 10.50 (d), Autoriteti Kontraktues njofton Koncesionarin me shkrim, brenda 10 Ditësh Pune nga marrja e një kopje të nënshkruar. Palët do të takohen në mirëbesim brenda 15 Ditësh Pune për t'u konsultuar dhe vendosur mbi kontratat në fjalë. Nëse Koncesionari pranon që kontrata në fjalë nuk respekton parimet e parashikuara në nenin 10.50(d) ky i fundit do të zgjidhë menjëherë kontratën në fjalë ose të ndryshojë përmbajtjen e saj, nëse është e mundur në mënyrë që kjo kontratë të respektojë parimet e sipërpërmendura. Nëse Palët nuk arrijnë dakordësinë mbi përputhshmërinë e kontratës në fjalë me parimet e sipërpërmendura, Palët do të zgjidhin mosmarrëveshjen sipas nenit 21.

10.52 Koncesionari do të lëjojë përfaqësuesit dhe këshilltarët e Autoritetit Kontraktues, përfshirë NJZP, që gjatë orarit të një Dite Pune të inspektojnë regjistrat, bilanci financiarë dhe çdo dokument me natyrë financiare që mbahet nga Koncesionari ose për llogari të tij, me qëllim verifikim e përputhshmërisë nga ana e Koncesionarit me këtë Kontratë. Për këtë efekt, Koncesionari do të instalojë një sistem elektronik i cili i lejon NJZP-së qasjen e vazhdueshme në informacionet kryesore administrative, operacionale, financiare dhe të mirëmbajtjes së VIA-s. Për shmangien e cdo dyshimi, Autoriteti Kontraktues është i detyruar të njoftojë Koncesionarin me shkrim 7 (shtatë) ditë pune përpara për zhvillimin e inspektimit të parashikuar në këtë pikë.

Raportimet dhe Informacioni

Buxheti Operacional

10.53 Jo më vonë se 60 ditë përpara fillimit të çdo viti kalendarik gjatë Afatit, Koncesionari do t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues një Buxhet Operacional për vitin kalendarik që pason menjëherë ose një pjesë të tij, sipas rastit ("**Buxheti Operacional**"). Ky Buxhet Operacional:

- (a) parashikon të gjitha kontigjencat e parashikueshme në mënyrë të arsyeshme në lidhje me funksionimin e VIA; dhe
- (b) përmban parashikime të drejta dhe të sakta për të gjitha shpenzimet operative të VIA të cilat :
 - (i) do të bazohen në të gjitha faktet dhe rrethanat që është në dijeni Koncesionari;
 - (ii) do të jetë i përgatitur në mirëbesim në bazë të supozimeve të shkruara të deklaruara këtu për të cilat Koncesionari beson se është i arsyeshëm për sa i përket të gjitha çështjeve faktike dhe juridike materiale të vlerësuara si të tilla; dhe
 - (iii) do të jetë në përputhje me detyrimet e Koncesionarit, sipas Manualit të Mirëmbajtjes dhe Operimit.

10.54 Në qoftë se nuk është rënë dakord ndryshe nga Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari, secili Buxhet Operacional do të mbahet nga viti në vit në të njëjtën bazë dhe format, do të ofrojë detaje të mjaftueshme për të lejuar një krahasim domethënës me Buxhetet Operacionale për vitet e mëparshme (nëse është e zbatueshme) dhe do të përmbajë një krahasim paraprijës me Buxhetin Operacional (nëse është e zbatueshme) me komente që shpjegojnë çdo ndryshim. Nëse Koncesionari ka një bazë të arsyeshme për të besuar se shuma totale e Buxhetit Operacional aktual do të tejkalohet gjatë vitit përkatës kalendarik, Koncesionari do të përgatisë një Buxhet Operacional të ndryshuar dhe menjëherë të paraqesë një kopje të tij, së bashku me të gjithë dokumentacionin mbështetës dhe justifikimin për një rritje të tillë të parashikuar tek Autoriteti Kontraktues.

Ndërprerja dhe Pezullimi

10.55 Koncesionari do t'i sigurojë Autoritetit Kontraktues njoftim të menjëhershëm me shkrim për çdo ndërprerje ose pezullim të veprimtarisë ose Punimeve, ose mbylljes së VIA-s. Koncesionari, brenda 24 orëve nga çdo ndërprerje ose pezullim i veprimtarisë ose Punimeve, ose mbylljes së VIA, do t'i sigurojë Autoritetit Kontraktues një raport që detajon rrethanat e ndërprerjes, pezullimit ose mbylljes. Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtën të kërkojë nga Koncesionari çdo dhe të gjithë informacionin që ai e konsideron të nevojshëm ose të arsyeshëm, në lidhje me çdo ndërprerje ose pezullim të veprimtarisë ose Punimeve, ose mbylljes së VIA,

kërkesë e cila duhet të plotësohet nga Koncesionari brenda 7 ditëve nga marrjes së saj.

Pasqyrat Financiare.

- 10.56 Koncesionari, nga momenti që janë të disponueshme, por, në çdo rast, në një datë që jo më të vonë se Dita e fundit e Punës e çdo muaji Mars, gjatë Afatit të kësaj Kontrate, do t'i sigurojë Autoritetit Kontraktues një kopje të pasqyrave të tij financiare të audituara menjëherë për vitin e mëparshëm financiar ose një pjesë të tij, cilat do të përgatiten në përputhje me standartet IFRS dhe do të paraqiten në Euro.

Vërtetimi i Tarifës Koncesionare

- 10.57 Duke filluar nga viti i dyte i operimit, Koncesionari brenda datës 15 prill përgjatë Afatit të kësaj Kontrate, do t'i sigurojë Autoritetit Kontraktues një vërtetim të auditorit të tij të pavarur që përcakton:
- (a) Të Ardhurat Bruto për vitin kalendarik paraardhës, për gjithë vitin ose një pjesë e tij, të cilat do të bazohen në pasqyrat financiare përkatëse për vitin kalendarik paraardhës dhe vërtetimet bankare në lidhje me Llogaritë Bankare; dhe
 - (b) një llogaritje të Tarifës Koncesionare për atë vit financiar ose një pjesë të tij ("Vërtetimi i Tarifës Koncesionare"). Ky Vërtetim i Tarifës Koncesionare do të dorëzohet së bashku me një vërtetim të një personi të autorizuar rregullisht të Koncesionarit, që vërteton që ky person pranon dhe miraton përmbajtjen e Vërtetimit të Tarifës Koncesionare në emër të Koncesionarit.
 - (c) Autoriteti Kontraktues miraton Vërtetimin e Tarifës Koncesionare, me shkrim, brenda 10 Ditësh Pune nga marrja e një kopje të nënshkruar. Nëse Autoriteti Kontraktueskundershton Vërtetimin e Tarifës Koncesionare, palët do të takohen në mirëbesim brenda 15 Ditësh Pune për t'u konsultuar dhe vendosur. Nëse Palët nuk arrijnë dakordësinë mbi përputhshmërinë e kontratës në fjalë me parimet e sipërpërmendura, Palët do të zgjidhin mosmarrëveshjen sipas nenit 21.

Studimet Mjedisore

- 10.58 Koncesionari do t'i sigurojë Autoritetit Kontraktues:
- (a) në kohën e dorëzimit tek çdo Autoritet Kompetent, çdo studim mjedisor që kërkohet të ndërmerret, çdo raport që kërkohet të paraqitet, ose çdo informacion plotësues që kërkohet të sigurohet, nga ose në lidhje me VIA ose objektet e Aeroportit, në secilin rast sipas Legjislacionit të Zbatueshëm; dhe
 - (b) sa më shpejt që të jetë e mundur, çdo studim tjetër të ndërmarrë ose raport të përgatitur nga Koncesionari në lidhje me çështjen mjedisore të lidhur me VIA-n, me shpenzimet e Koncesionarit.

Ngjarjet Materiale

- 10.59 Gjatë Afatit të kësaj Kontrate, Koncesionari do të informojë menjëherë me shkrim Autoritetin Kontraktues, për çdo dhe të gjitha ngjarjet materiale ose zhvillimet që mund të lindin gjatë Projektit.

Shpërndarjet

10.60 Koncesionari nuk do të bëjë asnjë pagesë qoftë në lidhje me borxhin, kapitalin kundrejt çdo aksionari / ortakut të tij ose Shoqërie të Lidhur, përveç se në përputhje me kontratat e lidhur midis Koncesionarit dhe çdo aksionari / ortakut të tij të lidhur përveç nëse:

- (a) Data e Përfundimit të Punimeve ka kaluar; dhe
- (b) shuma e plotë e secilit kështë të Tarifës Koncesionare (përfshirë çdo interes të pagueshëm për çdo kështë të tillë që nuk paguhet në kohë) që do të janë bërë të pagueshme dhe të parashikueshme në ose para datës së propozuar të një pagese të tillë do të jetë paguar ose alokuar plotësisht;
- (c) Sigurimi i Kontratës, në masën që kërkohet të jetë në fuqi sipas kushteve të kësaj Kontrate, është në forcë dhe efekt të plotë;
- (d) Koncesionari nuk është në mospermbushje sipas kësaj Kontrate, Marrëveshjes së Financimit ose ndonjë kontrate tjetër të lidhur nga Koncesionari në lidhje me Projektin.

Plani i Financimit

10.61 Koncesionari do t'i mundësojë njoftimin me shkrim Autoritetit Kontraktues menjëherë për çdo ndryshim të propozuar material në Planin e Financimit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, çdo rritje ose ulje materiale në koston e vlerësuar të Punimeve, së bashku me një deklaratë që shpjegon natyrën e këtij ndryshimi dhe arsyet. Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë të aprovojë ose refuzojë çdo ndryshim të tillë material të propozuar në Planin e Financimit, miratimi i cili duhet të mos refuzohet ose vonohet në mënyrë të paarsyeshme. Cdo kosto e përballuar nga Koncesionari (përfshirë ato që lindin për shkak të shtyrjes së afateve të përmbushjes së detyrimeve të tij) të cilat nuk shkaktohen si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve të Koncesionarit, njihen si shpenzime në kuadër të kryerjes së investimit.

Përzgjedhja e Audituesve

10.62 Koncesionari, me koston dhe shpenzimin e tij: (a) do të krijojë një sistem për mbajtjen e llogarive dhe kostove në lidhje me VIA, i cili ndër të tjera, do të ruajë të gjitha transaksionet financiare dhe aktivitetin tregtar të VIA qofshin këto të regjistruara apo jo në librat dhe regjistrat e Koncesionarit (b) të kontrakttojë një firmë të audituesve të pavarur me status ndërkombëtar të njohur, të pranueshëm për Autoritetin Kontraktues, si auditorë të Koncesionarit. Koncesionari do të përgatisë dhe mirëmbajë llogaritë e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe IFRS. Viti financiar i Koncesionarit do të jetë një vit kalendarik, përveç nëse bihet dakord ndryshe nga Palët.

Certifikimi

10.63 Koncesionari do të marrë (a) Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001; (b) Sistemi i Menaxhimit të Ankesave ISO 10002 dhe (c) Certifikimet e Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit ISO 14001 në lidhje me VIA para [për t'u përcaktuar nga MIE]. Pas kësaj, Koncesionari do të mbajë secilin certifikim të tillë në çdo kohë gjatë Afatit të kësaj Kontrate.

Pagesat

10.64 Koncesionari do të jetë përgjegjës për pagesën kur është e pagueshme, të ndonjë detyrimi ose angazhimi të Koncesionarit që lind në lidhje me performancën e Shërbimeve Aeroportuale, kryerjen e Punimeve ose Shërbimeve Tregtare, në ose pas Datës Efektive. Koncesionari do t'i sigurojë Autoritetit Kontraktues çdo asistencë të kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues për qëllimin e mbledhjes së çdo llogarie të arkëtueshme në lidhje me VIA të

krijuara para Datës Efektive.

Konkurrenca

10.65 Nëse gjatë Afatit ndonjë nga Ofertuesit ose një Shoqëri e Lidhur me të operon një aeroport konkurrent të VIA-s në një distancë prej 100 km nga VIA, Ofertuesi do të sigurohet që vetë ai ose Shoqëria e Lidhur me të, sipas rastit, të mos diskriminojë ndaj VIA-s dhe të operojë të dy aeroportet sipas parimit *arm's length basis*.

10.66 Koncesionari nuk do të:

- (a) Themelojë persona të tjerë juridik;
- (b) Marrë pjesë në një bashkim të përkohshëm shoqërisht;
- (c) Nëshkruajë marrëveshje tregtare, kryejë investime kapitale ose të japë hua kundrejt palëve të treta, përveç nëse parashikohet shprehimisht në këtë Kontratë,

pa marrë miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

Bashkëpunimi

10.67 Koncesionari do të bashkëpunojë me Autoritetin Kontraktues dhe do të takojë në mirëbesim përfaqësuesit e tij, të NJZP ose të enteve të tjera shtetërore për të diskutuar mbi zbatimin e Kontratës, ofrimin dhe mbarëvajtjen e Shërbimeve Aeroportuale dhe Shërbimeve Tregtare. Duke filluar nga jo më vonë se 12 muaj përpara përfundimit të Afatit, Koncesionari do të ofrojë qasjen e duhur në sistemet, regjistrat, pajisjet, personelin dhe ambientet e VIA-s për të lehtësuar transferimin e aktiviteteve dhe ambienteve Autoritetit Kontraktues ose personit të caktuar prej tij.

Sigurimi i Kontratës

10.68 Koncesionari i dorëzon Autoritetit Kontraktues Sigurimin e Kontratës, në Datën e Nënshkrimit. Në rast të uljes së vlerës së Sigurimit të Kontratës në përputhje me këtë Kontratë, Koncesionari angazhohet se do të rikthejë menjëherë vlerën e Sigurimit të Kontratës në një vlerë të barabartë me pesë milion e dyqind e pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet e pesë euro (5,215,525 €, përgjatë Afatit të Kontratës.

Të ndryshme

10.69 Gjatë Afatit të Kontratës Autoriteti Kontraktues gëzon të drejtën ekskluzive për caktimin e emrit tregtar të VIA-s. Autoriteti Kontraktues njofton Koncesionarin me shkrim 15 Ditë Punë përpara ndryshimit të emrit tregtar të VIA-s.

11. DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Miratimet

11.1 Në kuadër të zbatimit të Kontratës, Autoriteti Kontraktues:

- (a) Jep miratimin, rishikon dhe shpreh propozime për ndryshimin e Masterplanit dhe Planit të Përgjithshëm të Aeroportit, nëse ka, pas konsultimit të Autoriteteve Kompetente. Autoriteti Kontraktues miraton Masterplanin brenda 30 Ditësh Punë nga marrja e Masterplanit dhe nëse Autoriteti Kontraktues nuk shprehet brenda këtij afati,

Masterplani do të konsiderohet i miratuar në heshtje. Autoriteti Kontraktues i komunikon me shkrim Koncesionarit arsyet e refuzimit dhe/ose propozimet për ndryshime si dhe afatin kohor brenda të cilit Koncesionari duhet të dorëzojë Masterplanin e rishikuar. Masterplani i rishikuar dhe dorëzuar brenda afatit të përcaktuar nga Koncesionari, nuk refuzohet në mënyrë të paarsyshme nga Autoriteti Kontraktues;

- (b) Jep miratimin, rishikon dhe shpreh propozime për ndryshimin e Projektit të Zbatimit, nëse ka, pas konsultimit të Autoriteteve Kompetente. Autoriteti Kontraktues miraton Projektin e Zbatimit brenda 30 Ditësh Pune nga marrja e Projektit të Zbatimit dhe nëse Autoriteti Kontraktues nuk shprehet brenda këtij afati, Projekti i Zbatimit do të konsiderohet i miratuar në heshtje. Autoriteti Kontraktues i komunikon me shkrim Koncesionarit arsyet e refuzimit dhe/ose propozimet për ndryshime si dhe afatin kohor brenda të cilit Koncesionari duhet të dorëzojë Projektin e Zbatimit të rishikuar. Projekti i Zbatimit i rishikuar dhe dorëzuar brenda afatit të përcaktuar nga Koncesionari, nuk refuzohet në mënyrë të paarsyshme nga Autoriteti Kontraktues;
- (c) Jep miratimin, rishikon dhe shpreh propozime për ndryshimin e Projektit të Detajuar Teknik, nëse ka, pas konsultimit të Inxhinierit të Pavarur dhe Autoriteteve Kompetente, nëse është e zbatueshme. Pas konsultimit me Inxhinierin e Pavarur, Autoriteti Kontraktues miraton Projektin e Detajuar Teknik brenda 30 Ditësh Pune nga marrja e dokumentit dhe nëse Autoriteti Kontraktues nuk shprehet brenda këtij afati, Projekti i Detajuar Teknik konsiderohet i miratuar në heshtje. Autoriteti Kontraktues i komunikon me shkrim Koncesionarit arsyet e refuzimit dhe/ose propozimet për ndryshime si dhe afatin kohor brenda të cilit Koncesionari duhet të dorëzojë Projektin e Detajuar Teknik të rishikuar. Projekti i Detajuar Teknik i rishikuar dhe dorëzuar brenda afatit të përcaktuar nga Koncesionari, nuk refuzohet në mënyrë të paarsyshme nga Autoriteti Kontraktues.

Shërbimet e trafikut ajror

- 11.2 Autoriteti Kontraktues garanton se të paktën 6 muaj përpara Dates se Operimit, ai ose Autoritetet Kompetente do të ofrojnë shërbimet e kontrollit të trafikut ajror në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, duke marrë përsipër të gjitha kostot dhe shpenzimet e nevojshme për ofrimin e këtyre shërbimeve. Autoriteti Kontraktues do të mundësojë që ai vetë ose një person i caktuar prej tij të kujdeset, mirëmbajë në kushte të mira pune pajisjet asistuese për navigim ajror duke përfshirë por pa u kufizuar tek radarët, sistemet e uljes në tokë, në sasinë dhe cilësinë e nevojshme në lidhje me angazhimet e Autoritetit Kontraktues për shërbimet e kontrollit të trafikut ajror. Për shmangien e çdo dyshimi, Koncesionari do të mirëmbajë dhe operojë, ose të mundësojë mirëmbajtjen dhe operimin e të gjithë infrastrukturës së nevojshme për ngritjen, uljen dhe lëvizjen e Avionëve në Vendndodhje, drejt ose nga Vendndodhja, duke përfshirë pistat, pistat lidhëse (taxiëays), dhe ndriçimin e nevojshëm për uljet, ngritjet apo lëvizjet e Avionëve në Vendndodhje, në përputhje me Praktikën e Mirë të Industrisë.

Garantimi i të Ardhurave

- 11.3 Në një periudhë prej 10 vjetësh, duke filluar nga Data e Operimit ("**Periudha e Garancisë**"), Autoriteti Kontraktues do të garantojë Koncesionarin si më poshtë:

- (a) Në Shtojcën 3, janë përcaktuar të Ardhurat Bruto minimale vjetore të pritshme të Koncesionarit ("**të Ardhurat Minimale**") dhe të Ardhurat Bruto maksimale vjetore të pritshme të Koncesionarit ("**të Ardhurat Maksimale**") gjatë Periudhës së Garancisë;



- (b) Në rastin kur të Ardhurat Bruto vjetore janë më pak se të Ardhurat Minimale, Autoriteti Kontraktues do t'i paguajë Koncesionarit diferencën midis të Ardhurave Bruto vjetore të llogaritura nga Vlerësuesi sipas nenit 11.3 (d) dhe të Ardhurave Minimale. (“**Garancia e të Ardhurave**”);
- (c) Në rastin kur të Ardhurat Bruto vjetore janë më shumë se të Ardhurat Maksimale, diferenca midis të Ardhurave Bruto vjetore minus Tarifën Koncesionare dhe të Ardhurave Maksimale do të ndahet 50:50 midis Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionarit;
- (d) Brenda Datës së Operimit, Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të zgjedhin një vlerësues, ndërmjet një nga pesë firmat ndërkombëtarisht të njohura (“**Vlerësuesi**”). Vlerësuesi, gjatë vitit të parë të Operimit, në përputhje me këtë nen dhe me marreveshjen midis tij dhe Palëve, do të kryejë një studim të tregut dhe do të përcaktojë çdo vit vlerat e tregut të Tarifave, të cilat do t'i bashkëlidhe Kontratës në Shtojcën 24. Të Ardhurat Bruto vjetore do të llogariten nga Vlerësuesi, në bazë të të Ardhurave Bruto faktike, ose vlerave të tregut, cilado qoftë më e larta. Koncesionari dhe Autoriteti Kontraktues bien dakord të pranojnë si përfundimtar dhe detyrues studimin e Vlerësuesit dhe llogaritjet e tij. Kostot e Vlerësuesit i paguan Koncesionari;
- (e) Modalitetet e pagesave sipas nenit 11.3 (b) dhe 11.3 (d) do të përcaktohen në Shtojcën 3.
- (f) Në rast vonesash nga ana e Autoritetit Kontraktues në lidhje me pagesën e Garancisë se të Ardhurave sipas këtij neni, atëherë Autoriteti Kontraktues do të jetë përgjegjës për një penalitet në një vlerë prej 5% në vit mbi shumën e papaguara, Një detyrim i tillë paguhet 30 ditë pasi detyrimi bëhet i kërkueshëm dhe i pagueshëm. Detyrimi sipas këtij neni 11.3 f) është detyrimi i vetëm i Autoritetit Kontraktues ndaj Koncesionarit. Detyrimet e Autoritetit Kontraktues sipas këtij neni 11.3 mund të kompensohen me çdo detyrim të Koncesionarit kundërsht Autoritetit Kontraktues përfshirë por pa u kufizuar në Tarifën Koncesionare.

Bashkëpunimi.

11.4 Me kërkesë të Koncesionarit, Autoriteti Kontraktues i ofron Koncesionarit:

- (a) asistencë të arsyeshme për të zbatuar Projektin dhe për të përfituar nga të drejtat e parashikuara në nenin 4;
- (b) bashkëpunim të arsyeshëm për të kërkuar ndihmën e Autoriteteve Kompetente në kuadër të kryerjes së Punimeve, operimit dhe mirëmbajtjes së VIA-s;
- (c) ndihmë të arsyeshme në marrjen e Miratimeve/Lejeve dhe Licencave përkatëse që kërkohen të merren nga Koncesionari;
- (d) ndihmën e mundshme dhe të arsyeshme për rimbursimin nga Autoritetet Kompetente të TVSH-së në favor të Koncesionarit në kohë dhe në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm;
- (e) nëse kundër Koncesionarit është ngritur ndonjë pretendim, ose Koncesionari është bërë palë në ndonjë procedurë gjyqësore në lidhje me Projektin, ndihmë të arsyeshme siç mund të kërkohet nga Koncesionari, me kusht që Koncesionari t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktues:

- (i) njoftim me shkrim për ndihmën e kërkuar menjëherë pas marrjes së ndonjë ankese, padie, thirrjeje ose urdhëri gjykatës; dhe
- (ii) faktet dhe informacionet e nevojshme;

Koncesionari do të rimburojë Autoritetin Kontraktues për cdo kosto të pësuar nga Autoriteti Kontraktues në mënyrë të arsyeshme për ofrimin e asistencës së kërkuar në përputhje me pikat (a) deri në (e) të këtij Neni 11.4.

Gëzimi i Plotë dhe i Qetë

- 11.5 Autoriteti Kontraktues do të garantojë vënien në dispozicion të Vendndodhjes sipas parashikimeve të përcaktuara në kete Kontrate si dhe do të garantojë Gëzimin e Plotë dhe të Qetë dhe të Drejtën e Kalimit në lidhje me Vendndodhjen, në përputhje me nenin 7. Në rast të vonesave të shkaktuara në përmbushjen e detyrimeve të Koncesionarit sipas kesaj Kontrate, të cilat rrjedhin nga pamundësia e Koncesionarit për të përfituar nga Gëzimi i Plotë dhe i Qetë i Vendndodhjes, si pasojë e mospërmbushjes nga ana e Autoritetit Kontraktues, gjatë gjithë Afatit, Koncesionari do të përfitojë një shtyrje të cdo afati të detyrimeve të tij, në mënyrë proporcionale me kohëzgjatjen e kesaj pamundësie.

Rruga lidhëse

- 11.6 Autoriteti Kontraktues do të sigurojë që rruga lidhëse e VIA-s me autostradën Fier-Vlorë, në përputhje me Dokumentet e Tenderit, të përmirësohet, mirëmbahet dhe lidhet me këtë autostradë në një lidhëse më të afërt, sipas standartit të parashikuar nga Legjislacioni i Zbatueshëm përpara Datës së Operimit. Me përjashtim të çdo mbylljeje ose pezullimi të operacioneve që mund të rezultojnë nga efektet e ndonjë Emergjence ose të ndonjë Force Madhore, Autoriteti Kontraktues bie dakord dhe angazhohet të sigurojë që rruga lidhëse me VIA-n të jetë e hapur e mirëmbajtur, dhe funksionale gjatë Afatit të Kontratës.

Shërbimet e nevojshme (Utilities)

- 11.7 Autoriteti Kontraktues do të sigurojë që Datën e Fillimit të Punimeve, Vendodhja të jetë e lidhur me rrjetin e infrastrukturës publike dhe e pajisur me shërbimet dhe kapacitetet e nevojshme, përfshirë por pa u kufizuar në, ujë, energjinë elektrike, kanalizime të ujrave të bardha dhe të zeza, të shtrira deri në Perimetrin e Rrethimit të Vendndodhjes. Autoriteti Kontraktues do të sigurojë gjatë gjithë Afatit të Kontrates duke filluar që nga Data e Fillimit të Punimeve funksionimin e plote dhe mirëmbajtjen e sistemit të hidrovoreve dhe/ose kanaleve kulluese veprimtaria e të cilave prek ose ka të bëjë me Vendndodhjen. Në rast se Koncesionari, gjatë Afatit të Kontrates has pengesa të zbatimit të detyrimeve të kesaj Kontrate si rezultat i mosfunksionimit të hidrovoreve dhe/ose kanaleve kulluese, rrjetit të infrastrukturës publike dhe shërbimeve të nevojshme të përcaktuara në kete paragraf, atëherë Koncesionari ka të drejtë të përfitojë shtyrje të afateve përkatëse të zbatimit të këtyre detyrimeve, me të njëjtën kohëzgjatje duke filluar nga momenti i shfaqjes së pengesës deri në përfundimin e saj.

NJZP-ja

- 11.8 Autoriteti Kontraktues do të garantojë krijimin dhe ekzistencën e NJZP-së, ku një nga anëtarët do të jetë përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila do të jetë përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues dhe pikë kontakti për Koncesionarin, dhe do të sigurohet mbi zbatimin e suksesshëm të Projektit. Autoriteti Kontraktues do të plotësojë personelin e NJZP-së me personel të përshtatshëm teknik dhe administrativ. Kostot dhe shpenzimet e NJZP-së do të paguheshin nga Autoriteti Kontraktues.

Vazhdimësia

- 11.9 Në përputhje me këtë Kontratë, Autoriteti Kontraktues angazhohet të mos ndërmarrë asnjë veprim, dhe që asnjë Autoritet Kompetent nuk do të kryejë asnjë veprim që mund të ketë efekt material jo të favorshëm mbi Punimet, operimin e VIA-s, ofrimin e Shërbimeve Aeroportuale dhe Shërbimeve Tregtare, nëse kërkohet në rast Emergjence, ose për të zvogëluar dëmet që rezultojnë nga dështimi i Koncesionarit për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate; në këtë rast ndërprerjet do të konsiderohen si të autorizuara, me kusht që Autoriteti Kontraktues të garantojë se këto ndërprerje nga Autoriteti Kontraktues të kryera në përputhje me këtë nen, do të kufizohen në një periudhë kohore dhe për aq sa është e nevojshme për të përballuar Emergjencën ose për të zvogëluar dëmet në fjalë.
- 11.10 Në rast të një ndërprerje të paautorizuar nga ana e Autoritetit Kontraktues ose një Autoriteti Kompetent, ose në rastin e një ndërprerje të autorizuar në rastin e një Emergjence (me kusht që kjo Emergjencë nuk është shkaktuar me faj ose nga neglizhenca e Koncesionarit), e cila shkakton vonesa në Punime, mbylljen ose pezullimin e operimit të VIA-s, atëherë Koncesionari mund të kërkojë zgjatjen:
- (a) E Afatit të Kontratës, për një kohëzgjatje të barabartë me kohëzgjatjen e ndërprerjes ose pezullimit të Punimeve;
 - (b) E Datës së Përfundimit të Punimeve, për një kohëzgjatje të barabartë me kohëzgjatjen e ndërprerjes të Punimeve, por vetëm në rastin kur kjo ndërprerje ka ndikuar negativisht në ecurinë e Punimeve.

12. NGJARJA E FORCËS MADHORE

12.1 Ngjarje e Forcës Madhore nënkupton çdo ngjarje që:

- (a) ndalon Palën e prekur të kryejë detyrimet e saj në përputhje me Kontratën;
- (b) është jashtë kontrollit të arsyeshëm, dhe jo rezultat i fajit ose neglizhencës, të Palës së prekur; dhe
- (c) Pala e prekur nuk mund të shmangë një akt apo ngjarje të tillë me ushtrimin e të gjithë kujdesit dhe aftësive të arsyeshme (duke përfshirë shpenzimin e shumave të arsyeshme),

duke iu nënshtruar përmbushjes së kushteve të mësipërme, "**Ngjarja e Forcës Madhore**" përfshin por nuk kufizohet vetëm në aktet ose ngjarjet e mëposhtme:

- (i) fenomenet natyrore, të tilla si stuhitë, uraganet, përmytjet, rrufetë, shpërthimet vullkanike dhe tërmetet;
- (ii) shpërthime ose zjarre që lindin nga rrufeja (jashtë parametrave të sistemit mbrojtës të rrufesë të Projektit) pajisjet supersonike ose shkaqe të tjera që nuk lidhen me veprimet ose mosveprimet e Palës që kërkon të çlirohet nga performanca;
- (iii) akte të luftës ose trazira publike, trazira civile, protesta, kryengritje, sabotazhë, epidemi, pandemi, kontaminim radioaktiv, akte terroriste, rebelime;
- (iv) greva (ose akt i organizuar me efekt të njëjtit me grevën) ose mosmarrëveshje pune;

- (v) ndërprerja e pjesshme ose e plotë e operimit të VIA-s ose një pjese të VIA-s gjatë vlefshmërisë së një vendimi për gjendjen e emergjencës ose të fatkeqësisë natyrore në territorin e Republikës së Shqipërisë, ose njësisë qeverisëse vendore ku ndodhet VIA;
- (vi) cdo akt i detyrueshem i autoriteteve shtetërore i leshuar si rrjedhojë e sa më sipër;
- (vii) ngjarja e një fenomeni gjeoteknik të paparashikuar, i cili mund të ndikojë negativisht në Punimet për ndërtimin, operimin e Aeroportit;

me kusht që një Ngjarje e Forcës Madhore nuk përfshin:

- (i) padisponueshmërinë e forcës punëtore, pajisjeve, materialeve, shërbimeve komunale ose burimeve të tjera (me përjashtim të rastit kur padisponueshmëria vjen si pasojë e Ngjarjes së Forcës Madhore);
- (ii) vështirësi ekonomike ose financiare apo mungesë fondesh ose pamundësi për të përmbushur detyrimin për të paguar para në afat apo pamundësi për të përftuar financim (me përjashtim të rastit kur mungesa e materialeve vjen si pasojë e Ngjarjes së Forcës Madhore);;
- (iii) mungesë materialesh që nevojiten për zhvillimin, ndërtimin ose mirëmbajtjen e Projektit (me përjashtim të rastit kur mungesa e materialeve vjen si pasojë e Ngjarjes së Forcës Madhore).

12.2 Përveçse është parashikuar në nenin 15.1 dhe 15.2, një Ngjarje e Forcës Madhore nuk i jep asnjërës prej Palëve të drejtën që të zgjidhë këtë Kontratë dhe asnjë nga Palët nuk do të jetë në shkelje të Kontratës apo përgjegjëse, në rast dështimi për përmbushjen të detyrimeve të tyre respektive apo vonese, për sa kohë që ky dështim apo vonesë në përmbushjen e detyrimeve ka ndodhur për shkak të një Ngjarjeje të Forcës Madhore.

12.3 Përveçse është parashikuar në nenin 12.2, afatet e parashikuara në këtë Kontratë, do të zgjaten ditë pas dite kur njëra nga Palët pezullon detyrimet e veta nën këtë Kontratë për shkak të një ngjarjeje të Forcës Madhore sipas nenit 12.1.

12.4 Pala e cënuar nga Forca Madhore do të përfitojë lehtësimin në bazë të nenit 12.2 dhe 12.3 vetëm nëse:

- (a) ka njoftuar menjëherë me shkrim Palën tjetër, për Ngjarjen e Forcës Madhore, duke treguar se Forca Madhore në fjalë ka penguar apo vonuar në mënyrë të arsyeshme përmbushjen e detyrimeve të Palës së prekur dhe duke deklaruar masën e parashikuar dhe kohëzgjatjen e mundshme të Ngjarjes së Forcës Madhore në fjalë (nëse një gjë e tillë është e mundur);
- (b) ka ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për të zvogëluar ndikimin dhe zbutur pasojat e Forcës Madhore sa më shpejt të jetë e mundur; dhe
- (c) përveçse kur pengohet nga një Ngjarje e Forcës Madhore, i paraqet Palës tjetër një raport (apo një plan rekuperimi dhe rehabilitimi në rast epidemie apo karantinimi që afekton Vendndodhjen apo Projektin), në lidhje me masat e marra në përputhje me nenin 12.4 (b) dhe një përditësim të këtyre raporteve rregullisht sa është e nevojshme në lidhje me zgjatjen parashikuar dhe kohëzgjatjen e mundshme të Ngjarjes së Forcës



Madhore dhe në rast epidemie apo karantinimi një raport për masat zbutëse dhe të recuperimit që janë marrë për kalimin e efekteve negative.

- 12.5 Neni 12.2 dhe 12.3 nuk e zhvesh Palën e prekur nga Ngjarja e Forcës Madhore nga kryerja e detyrimeve sipas Kontratës ose nga përgjegjësia për moskryerjen e tyre nëse mos kryerja e tyre ka ndodhur përpara Ngjarjes së Forcës Madhore, ose nuk lidhet me Ngjarjen e Forcës Madhore.

13. VEPRIMI MATERIAL I PAFAVORSHËM QEVERITAR

- 13.1 "Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar" nënkupton rastet kur, Autoriteti Kontraktuesose ndonjë Autoritet Kompetent vendor apo qendror, pas Datës Efektive të kësaj Kontrate merr apo dështon të ndërmarrë një veprim, efekti i të cilit ndikon në mënyrë materiale dhe negativisht mbi Koncesionarin për sa i perket të drejtave, asetëve, shpenzimeve apo të ardhurave (përfshirë por pa u kufizuar në to, Tatimet apo Taksat), apo pozicionin ekonomik dhe financiar të saj, duke përfshirë, por pa u kufizuar në to:

- (a) shpronësimin, konfiskimin ose shtetëzimin e VIA-s dhe/ose të të drejtave të Koncesionarit të parashikuara në nenin 4;
- (b) ndalimin ose kufizimin mbi transferimin e fitimeve të Koncesionarit dhe shërbimet e huasë nga Republika e Shqipërisë (duke përfshirë ndalimin dhe kufizimet e shkëmbimit valutor);
- (c) çdo detyrim, akt, apo Ndryshim në Ligj që do të prekte në mënyrë ekskluzive dhe që ndikon negativisht dhe në mënyrë materiale Koncesionarin dhe do të bënte të pamundur zbatimin e detyrimeve të Koncesionarit sipas Kontratës. Për të evituar çdo dyshim, Ndryshim në Ligj, lidhur me Tatimet apo Taksat, nuk do të konsiderohet si Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar në rast se është i aplikueshëm për të gjithë tatimpaguesit apo subjektet e taksave në Shqipëri, pa asnjë dallim ose diskriminim;

- 13.2 Nëse Koncesionari mendon në mënyrë të arsyeshme se ka ndodhur ose pritet të ndodhë një Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar, Koncesionari duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues dhe të sigurojë informacion të detajuar në lidhje me Veprimin Material të Pafavorshëm Qeveritar dhe mënyrën si ndikon materialisht dhe është i pafavorshëm për Koncesionarin për të drejtat e tij ose për përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate.

- 13.3 Brenda tridhjetë (30) Ditë Pune nga njoftimi drejtuar Autoritetit Kontraktues, Palët do të takohen, diskutojnë dhe vendosin në mirëbesim një zgjidhje të kënaqshme reciproke, me qëllim që të rivendosin Koncesionarin në pozicionin tregtar që do të kishte nëse ky Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar nuk do të kishte ndodhur ose në një pozitë tregtare të barasvlershme. Nëse Palët vendosin se nuk mund të gjendet një zgjidhje e kënaqshme për të adresuar ndikimin e Veprimit Material të Pafavorshëm Qeveritar në përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Kontrate dhe nëse Veprimi Material i Pafavorshëm Qeveritar ndodh gjatë Afatit dhe zgjat më shumë se tre (3) muaj, Koncesionari ka të drejtën:

- (a) të vazhdojë zbatimin e detyrimeve të tij në bazë të Kontratës duke përfutur shtyrje të afateve të përmbushjeve të detyrimeve të tij (nëse është rasti), ose
- (b) të zgjidhë këtë Kontratë në përputhje me nenin 15.6.

- 13.4 Çdo Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar do të konsiderohet si mospërmbushje e Kontratës nga ana e Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionari ka të drejtë të marrë të gjitha dëmshpërblimet sipas nenit 16.

14. SIGURIMI

- 14.1 Koncesionari, me kostot dhe shpenzimet e tij, do të marrë ose do të bëjë të mundur që të merret, dhe do të mbajë në fuqi gjatë gjithë Afatit të kësaj Kontrate, policat e sigurimit të lëshuara nga:
- (a) Sigurues ndërkombëtarë me reputacion të mirë dhe një vlerësim afatgjatë të paktën "A" sipas një ose më shumë agjencive kryesore të vlerësimit; ose
 - (b) Në rastin e një kompanie sigurimesh të licencuar në Shqipëri, nëse nuk ka vlerësim afatgjatë "A", sigurues me reputacion të mirë, i,
- të cilat duhet të jenë në përputhje me Praktikën e Mirë të Industrisë dhe në përputhje me Shtojcën 33.
- 14.2 Autoriteti Kontraktues do të caktohet si një person i siguruar shtesë në të gjitha policat e sigurimit sipas Shtojcës 33 dhe në rast të zgjidhjes së Kontratës do të përfitojë nga të drejtat e parashikuara në të njëjtën shtojcë.
- 14.3 Autoriteti Kontraktues nuk do të mbajë asnjë rrezik ose përgjegjësi për dështimin e Koncesionarit për të marrjen ose mbajtjen e të gjitha policave të sigurimit të kërkuara për tu marrë sipas Shtojcës 33 dhe nuk do të jetë përgjegjës ndaj Koncesionarit për humbje të cilat nuk janë siguruar.
- 14.4 Koncesionari do të njoftojë Autoritetin Kontraktues me shkrim për çdo ndryshim në secilën prej policave të sigurimit që parashikohen në Shtojcën 33, brenda 15 Ditë Pune nga ky ndryshim.
- 14.5 Dështimi nga ana e Koncesionarit për të marrë dhe/ose mbajtur në fuqi përgjatë Afatit, njëerën prej policave të kërkuara të sigurimit të parashikuara në Shtojcën 33 do të përbejë një shkelje materiale të Kontratës nga ana e Koncesionarit.

15. ZGJIDHJA E KONTRATËS

Zgjidhja e Parakohshme

Ngjarja e Forcës Madhore.

- 15.1 Nëse ndonjë Ngjarje e Forcës Madhore do të ndodhë dhe do të vazhdojë për një periudhë prej të paktën 180 ditë në total brenda një periudhe të pandërprerë prej 12 muajsh atëherë secila Palë do të ketë të drejtën të zgjidhë këtë Kontratë.
- 15.2 Nëse një Ngjarje e Forcës Madhore do të ndodhë dhe pasojat e saj do të ndikojnë materialisht dhe do të përkeqësojnë pozicionin ekonomik ose tregtar të Koncesionarit nga ajo që ishte në Datën Efektive ose nga ajo që është ose çfarë do të kishte qenë po të mos kishte ndodhur Ngjarja e Forcës Madhore dhe kjo ngjarje ose pasojat e saj vazhdojnë për një periudhë prej të paktën 180 ditë nga data në të cilën Koncesionari do t'i japë njoftim me shkrim Autoritetit Kontraktues, atëherë Koncesionarit, pavarësisht nga çdo sigurim i pagueshëm në lidhje me Ngjarjen e Forcës Madhore, do të ketë të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë.

Njoftimi i Zgjidhjes së Parakohshme

- 15.3 Nëse Autoriteti Kontraktues ose Koncesionari, sipas rastit, vendos të zgjidhë këtë Kontratë atëherë Autoriteti Kontraktues ose Koncesionari, sipas rastit, do të njoftojë Palën tjetër me shkrim për vendimin e saj për të zgjidhur këtë Kontratë, e cila do të jetë efektive 30 Ditë Pune



pas dorëzimit të njoftimit nga Pala njoftuese, dhe do t'u dërgojë një kopje të këtij njoftimi me shkrim Institucioneve Financiare.

Zgjidhja e Parakohshme nga Autoriteti Kontraktues

E drejta për të zgjidhur

- 15.4 Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë të zgjidhë parakohe këtë Kontratë në rast se do të ndodhet në ndonjë prej rrethanave të mëposhtme, e cila nuk është rrjedhojë e një veprimi ose mosveprimi të Autoritetit Kontraktues:
- (a) Koncesionari nuk arrin të bëjë asnjë pagesë në lidhje me Tarifën Koncesionare, dhe tarifat shtetërore të përcaktuara në nenin 6.6, mospërmbushje që ka vazhduar e pandrequr për 90 ditë ose më shumë pas datës në të cilën duhet të ishte kryer si pagesë;
 - (b) Koncesionari nuk kryen ndonjë ose të gjitha Shërbimet Aeroportuale të përcaktuara në Shtojcën 2, gjatë çdo periudhe të vazhdueshme prej të paktën 48 orësh ose ndonjë Shërbimi tjetër Aeroportual gjatë ndonjë periudhe të vazhdueshme prej të paktën 72 orësh;
 - (c) Koncesionari nuk kryen ndonjë aktivitet në Vendndodhje duke ngadalësuar në mënyrë të konsiderueshme përparimin e Punimeve (në përputhje me Planin e Punimeve) për 20 Ditë Pune radhazi pas fillimit të tyre;
 - (d) Nëse Data e Operimit nuk ka ndodhur në një datë e cila do të jetë 90 ditë pas Datës së Synuar të Operimit, periudhë e cila nuk mund të zgjatet përveçse në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate;
 - (e) Nëse Data e Fillimit të Punimeve nuk ka ndodhur në një datë e cila do të jetë 90 ditë pas Datës së Synuar të Fillimit të Punimeve, periudhë e cila nuk mund të zgjatet përveçse në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate;
 - (f) dështimi i Koncesionarit për të zgjidhur në favor të tij çdo veprim që çon në falimentim, shpërbërje dhe / ose likuidim të Koncesionarit;
 - (g) Koncesionari merr një vendim të formes së prere të një gjykate për t'u vendosur në falimentim ose për të filluar procedurat e likuidimit;
 - (h) Koncesionari kryen ndonjë shkelje tjetër materiale ose mospërmbushje në lidhje me kryerjen e ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate, shkelje (përveç në rastin e ndonjë shkelje të referuar në nenin 15.4(a) e cila rregullohet nga afatet e përcaktuara në kete dispozite) ka vazhduar e pandrequr për 60 ditë ose më shumë pas dorëzimit të njoftimit nga Autoriteti Kontraktues ndaj Koncesionarit për shkeljeje ose mospërmbushje, sipas rastit.

Njoftimi i zgjidhjes së parakohshme

- 15.5 Nëse ndonjë ose më shumë nga ngjarjet e përcaktuara në Nenin 15.4 do të ndodhin, Autoriteti Kontraktues mund të zgjidhë këtë Kontratë me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Koncesionarit, një kopje e të cilit do t'i dërgohet gjithashtu edhe Institucioneve Financiare.

Përfundimi nga Koncesionari

E drejta për të zgjidhur



15.6 Koncesionari do të ketë të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë në rast se do të ndodhet në ndonjë prej rrethanave të mëposhtme:

- (a) Autoriteti Kontraktues kryen një shkelje materiale ose mospërbushje në lidhje me ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate (dhe shkelja ose mospërbushja ka vazhduar e pandrequr për 60 ditë ose më shumë pas dorëzimit të njoftimit me shkrim për shkeljen ose mospërbushjen nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues.
- (b) Në rast të një Veprimi Material të Pafavorshëm Qeveritar, sipas nenit 13.3.
- (c) Autoriteti Kontraktues deshton t'i sigurojë Koncesionarit Gezimin e Plote dhe të Qete të Vendndodhjes për 90 ditë ose më shumë pas dorëzimit të njoftimit me shkrim për shkeljen ose mospërbushje nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues.

Njoftimi

15.7 Nëse ndonjë ose më shumë nga ngjarjet e përcaktuara në Nenin 15.6 do të ndodhin, Koncesionari mund të zgjidhë këtë Kontratë me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Autoritetit Kontraktues, një kopje e të cilit do t'i dërgohet gjithashtu edhe Institucioneve Financiare.

Efektet e Zgjidhjes së Parakohshme

Të Përgjithshme

15.8 Pas Datës së Zgjidhjes së Parakohshme, në përputhje dhe pa paragjykuar ndonjë të drejtë të Palëve, më poshtë:

- (a) kjo Kontratë do të pushojë së qënuri në fuqi (përveç neneve të Kontratës që parashikojnë vazhdimësinë e detyrimeve pas Datës së Zgjidhjes së Parakohshme), dhe me përjashtim të të drejtave dhe detyrimeve të Palëve të lindura përpara Datës së Zgjidhjes së Parakohshme;
- (b) Të Drejtat e Koncesionit të Koncesionarit do të përfundojnë;
- (c) pa paragjykuar ushtrimin e ndonjë të drejte zëvendësimi të Institucioneve Financiare sipas nenit 19.4, Koncesionari do t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktues, pa asnjë kosto ose shpenzim posedimin e VIA-s (i cili do të jetë një aeroport i plotë dhe operacional), përveç në rastin e përfundimit sipas nenit 15.1, në rastin dhe për aq sa VIA ka pësuar ndonjë dëm fizik që rezulton nga Ngjarja e Forcës Madhore), e operuar dhe mirëmbajtur në përputhje me Termat e Referencës, Manualin e Operimit dhe Mirëmbajtjes, Planin e Emergjencës së Aeroportit, Masterplanin, Planin e Menaxhimit të Mjedisit dhe të gjithë Legjislacionin e Zbatueshëm, Vendndodhjen, Pronën e Paluajtshme, të gjithë Pronat e Luajtshme në pronësi ose të dhënë me qira nga Koncesionari dhe si dhe të gjitha Skicat *as it is* dhe dokumente ose të dhëna të tjera që lidhen posaçërisht me Punimet të cilat janë në zotërim ose kontroll të Koncesionarit, dhe Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtën të:
 - (i) hyjë dhe marrë kontrollin e menjëhershëm operacional të VIA-s, Vendndodhjes dhe cdo pronë të tillë të luajtshme;
 - (ii) kërkojë që e gjithë Vendndodhja dhe Prona e Paluajtshme, Asetet t'i dorëzohen menjëherë Autoritetit Kontraktues;



- (iii) zgjedhë dhe zëvendësojë Koncesionarin me një Operator Pasardhës;
 - (iv) marrë posedimin e të gjithë Pasurisë së Luajtshme dhe Pasurise se Paluajtshme në pronësi ose dhënë me qira nga Koncesionari; dhe
 - (v) të transferojë pronësinë e Pasurisë së Paluajtshme nga Koncesionari te Autoriteti Kontraktues.
- (d) Koncesionari do të lehtësojë vazhdimin e punësimit në VIA të secilit dhe të gjithë punonjësve të përfshirë në funksionimin dhe mirëmbajtjen e VIA-s në Datën e Zgjidhjes;
- (e) nëse Koncesionari nuk arrin të dorëzojë posedimin e VIA-s në përputhje me Nenin 15.8 (c) Koncesionari do t'i paguajë Autoritetit Kontraktues çdo dhe të gjitha dëmet që mund të përcaktohen nga një gjykatë arbitrazhi e caktuar në përputhje me nenin 21.
- (f) përveç nëse afati i Sigurimit të Kontratës do të ketë mbaruar në përputhje me këtë Kontratë, ose nëse Autoriteti Kontraktues do të ketë një kërkesë të papaguar, pas përmbushjes së kësaj kërkesë ndaj Koncesionarit, Autoriteti Kontraktues do të dorëzojë menjëherë çdo kopje origjinale të Sigurimit të Kontratës në zotërimin e tij Koncesionarit.

Pagesat e Zgjidhjes

Zgjidhja për shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore

15.9 Pavarësisht nga dispozitat e nenit 15.8 (c), në rast të zgjidhjes të kësaj Kontrate për arsye të Ngjarjes së Forcës Madhore, pagesat e zgjidhjes së pagueshme nga Autoriteti Kontraktues si kompensim për zgjidhjen e parakohshme të kësaj kontrate do të përfshijnë:

- (a) detyrimet që ka Koncesionari ndaj huadhënësve sipas Marrëveshjes së Financimit deri në momentin e zgjidhjes së kontratës,
- (b) Autoriteti Kontraktues do ti paguajë Koncesionarit një shumë të barabartë me Kapitalin Neto minus:
 - (i) çdo shumë që i është paguar Koncesionarit nga siguracionet në lidhje me Kapitalin Neto, siç është vërtetuar sipas nenit 15.12; ose
 - (ii) në rast se Koncesionari do të ketë dështuar të marrë dhe mirëmbajë policat e sigurimit në përputhje me këtë Kontratë, shuma, siç përcaktohet në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues, e të ardhurave të sigurimit që do t'i ishin paguar Koncesionarit nëse Koncesionari do të kishte marrë dhe mirëmbajtur policat e sigurimit në përputhje me këtë Kontratë,

Autoriteti Kontraktues do të jetë përgjegjës për çdo rimbursim sipas këtij neni 15.9 (b)(ii), vetem nëse Autoriteti Kontraktues përcakton se VIA, pavarësisht dëmtimeve fizike, mbetet e përdorshme si një aeroport në një nivel shërbimi të IATA të paktën të barabartë me Nivelin D. Nëse Koncesionari kundërshton përcaktimin e nivelit të shërbimit IATA nga Autoriteti Kontraktues, në të cilin VIA rezulton e përdorshme si aeroport, mosmarrëveshja e tillë do të zgjidhet në përputhje me procedurat e përshkruara në nenin 21.

Përfundimi nga Autoriteti Kontraktues



- 15.10 Pavarësisht nga dispozitat e nenit 15.8 (c), në rast të përfundimit të kësaj Kontrate nga Autoriteti Kontraktues në përputhje me nenin 15.4, pagesat e zgjidhjes së pagueshme nga Autoriteti Kontraktues si kompensim për zgjidhjen e parakohshme të kësaj kontrate do të përfshijnë detyrimet që ka Koncesionari ndaj huadhënësve sipas Marrëveshjes së Financimit deri në momentin e zgjidhjes së kontratës,

Përfundimi nga Koncesionari

- 15.11 Pavarësisht nga dispozitat e Nenit 15.8 (c) në rastin e përfundimit të kësaj Kontrate nga Koncesionari në përputhje me nenin 15.6, pagesat e zgjidhjes së pagueshme nga Autoriteti Kontraktues si kompensim për zgjidhjen e parakohshme të kësaj kontrate do të përfshijnë:

- (a) detyrimet që ka Koncesionari ndaj huadhënësve sipas Marrëveshjes së Financimit deri në momentin e zgjidhjes së kontratës,
- (b) Autoriteti Kontraktues do t'i paguajë Koncesionarit një shumë të barabartë me:
 - (i) Kapitalin Net të Rregulluar minus çdo shumë që i është paguar Koncesionarit nga policat e sigurimit në lidhje me Kapitalin Net të Rregulluar, siç është vërtetuar sipas nenit 15.12 ose në rast se Koncesionari do të ketë dështuar të marrë dhe mirëmbajë policat e sigurimit në përputhje me këtë Kontratë, shuma, siç përcaktohet në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues, e të ardhurave të sigurimit që do t'i ishin paguar Koncesionarit nëse Koncesionari do të kishte marrë dhe mirëmbajtur policat e sigurimit në përputhje me këtë Kontratë;
 - (ii) totalin të gjitha shumave e kërkueshme dhe të pagueshme që mund të lindin si rezultat i drejtpërdrejtë i zgjidhjes së Kontratës, sipas çdo kontrate të lidhur nga Koncesionari në lidhje me Projektin (përfshirë po pa u kufizuar, kontrata pune, nënkontraktorë apo kontrata shërbimi) të cilat nuk i janë transferuar Autoritetit Kontraktues, me kusht që në asnjë rast Autoriteti Kontraktues të mos jetë përgjegjës për një shumë më të madhe se 50,000 Euro për çdo kontratë. Koncesionari do të vendosë në dispozicion të Autoritetit Kontraktues brenda 120 ditëve një kopje të ndonjë kontrate të tillë dhe çdo ndryshim material në të së bashku me një certifikatë të një përfaqësuesi të autorizuar të Koncesionarit, që përcakton çdo dhe të gjitha shumat që mund të dalin prej saj si rezultat i drejtpërdrejtë i përfundimit të kësaj Kontrate) duke përkrahur ato dispozita të cilat mund të japin shkas për shuma të tilla dhe vërtetojnë që provizione të tilla përputhen posaçërisht me Praktikën e Mirë të Industrisë.

- 15.12 Pas marrjes së njoftimit me shkrim për zgjidhjen e Kontratës, sipas rastit, nga Koncesionari ose Autoriteti Kontraktues:

- (a) Koncesionari do të vërtetojë Autoritetit Kontraktues me shkrim:
 - (i) që nga përfundimi i kësaj Kontrate nuk i ka lindur asnjë të drejtë Koncesionarit ose ndonjë bashkëpunëtor të Koncesionarit për të kërkuar rikuperimin e të ardhurave nga ndonjë policë e sigurimit nga Koncesionari ose cdo bashkëpunëtor i tij; ose
 - (ii) që nga përfundimi i kësaj Kontrate i ka lindur një drejtë Koncesionarit dhe / ose bashkëpunëtorët të Koncesionarit për të kërkuar rikuperimin e të ardhurave sipas një ose më shumë policave të sigurimit të mbajtura nga Koncesionari dhe / ose bashkëpunëtorët, pretendimet që janë bërë në lidhje me një sigurim të tillë



dhe Koncesionari dhe / ose bashkëpunëtorët kanë rikuperuar nën sigurimin e tillë shumën totale të të ardhurave, që do të përcaktohet në një certifikatë me shumën e tillë, të ardhurat do të miratohen nga siguruesit ose ndërmjetësit e sigurimeve të Koncesionarit dhe / ose bashkëpunëtorët pasi të kenë paguar rregullisht Koncesionarin dhe / ose bashkëpunëtorët, sipas rastit;


- (b) Koncesionari do t'i vërtetojë Autoritetit Kontraktues me shkrim çdo shumë që i detyrohet Autoritetit Kontraktues në përputhje me Nenin 15.11, sipas rastit, e llogaritur që nga Data e Përfundimit, duke përcaktuar llogaritjet e tilla;
 - (c) Koncesionari do t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues një certifikatë të audituesit të Koncesionarit, ku përcaktohe llogaritja dhe shuma totale të çdo dhe të gjitha gjendjeve të parave të Koncesionarit që nga Data e Zgjidhjes së Parakohshme duke përfshirë, pa u kufizuar, në çdo rezervë të Koncesionarit (përfshirë pa u kufizuar, ato nën Marrëveshjes se Financimit dhe shumat e depozituara në Llogaritë Bankare;
 - (d) Aksionarët do t'i vërtetojnë Autoritetit Kontraktuesi me shkrim se ata e kanë liruar Koncesionarin nga çdo pagesë, performancë ose detyrim tjetër ndaj tyre që mund të ketë lindur para Datës së Përfundimit;
- 15.13 Pas marrjes ose parashikimeve të njoftimit me shkrim të përshkruar 15.7 Koncesionari do t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktues me shkrim një listë të specifikuar të të gjitha shumave të pretenduara sipas Nenit 15.11, listë e cila do të sigurojë llogaritjet e hollësishme të secilës shumë të pretenduar, kontratën përkatëse sipas së cilës kërkohet një shumë e tillë dhe një përshkrim tekstual i arsyes që shuma e tillë u bë e pagueshme para Datës së Përfundimit të Kontratës ose është bërë e pagueshme si rezultat i përfundimit të kësaj Kontrate. Kjo listë do t'i bashkëngjitet një certifikatë të një zyrtari të autorizuar të Koncesionarit, që vërteton për dhe në emër të Koncesionarit, për arsyeshmërinë dhe saktësinë e deklaratave të bëra.
- 15.14 Autoriteti Kontraktues do t'i paguajë Koncesionarit shumën e përcaktuar në përputhje me Nenin 15.11 në një llogari të përcaktuar nga Koncesionari, brenda një periudhe kohore jo më pak se 60 ditë pas marrjes së certifikimeve përshkruar më sipër.
- 15.15 Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtën e kompensimit ndaj çdo shume që Autoriteti Kontraktues i detyrohet Koncesionarit në përputhje me këtë nen 15 dhe çdo shumë që Koncesionari i detyrohet Autoritetit Kontraktues sipas kësaj Kontrate;

Dorëzimi i Vendndodhjes

- 15.16 Pas Datës së Përfundimit ose ndonjë zëvendësimi të Koncesionarit me një subjekt zëvendësues, në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate, Koncesionari do të largojë menjëherë, dhe në çdo rast brenda 60 ditëve pas përfundimit ose zëvendësimit të tillë, do të lirojë Vendndodhjen dhe të procedoje në përputhje me nenin 15.8 (c). Nëse Koncesionari nuk arrin të lirojë Vendndodhjen siç u përmend më lart, Koncesionari do t'i paguajë Autoritetit Kontraktues çdo dhe të gjithë dëmet që mund të përcaktohen nga një gjykatë arbitrazhi.

Kostot e përfundimit

- 15.17 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet specifikisht në këtë Kontratë, secila Palë do të mbartë kostot dhe shpenzimet e veta (duke përfshirë, pa limitim, çdo detyrim tatimor) të bërë gjatë kryerjes së detyrimeve të saj sipas këtij Neni.
- 15.18 Dëmshpërblimet e përcaktuara në këtë nen janë dëmshpërblimet e vetme të Palëve në lidhje me zgjidhjen e Kontratës.



16. DËMSPËRBLIMI

Përgjegjësia ndaj Palëve të Treta

Koncesionari

- 16.1 Koncesionari do të dëmshpërblejë Autoritetin Kontraktues dhe çdo Person të Autoritetit Kontraktues dhe do ta mbajë Autoritetin Kontraktues dhe çdo Person të lidhur me Autoritetin Kontraktues të pacënuar kundrejt palëve të treta, për çdo Humbje të çfarëdo lloji që ka pësuar ose do të pësojë Autoriteti Kontraktues dhe çdo Person i lidhur me të, për arsye të ndonjë dëmtimi ose vdekjeje ose shkatërrimi të ndonjë prone, cënimi të të drejtave të çdo personi në masën që Humbja e tillë lind, ose është pasojë e akteve, veprimeve dhe/ose mosveprimeve të Koncesionarit dhe/ose të punonjësve dhe/ose nënkontraktorëve apo agjentëve të tij, si pjesë e Shërbimeve Aeroportuale, Shërbimeve Tregtare, Punimeve, Zgjerimit në përputhje me Termat e Referencës, me përjashtim të masës që Humbja e tillë është shkaktuar nga, ose i atribuohet neglizhencës ose sjelljes kundraligjshme me faj të Autoritetit Kontraktues dhe ose çdo Personi të lidhur me Autoritetin Kontraktues ose ndonjë Ngjarje e Forcës Madhore, ose Emergjence.

Autoriteti Kontraktues

- 16.2 Autoriteti Kontraktues do të dëmshpërblejë Koncesionarin dhe çdo Person të lidhur me Koncesionarin dhe do ta mbajë Koncesionarin dhe çdo Person të lidhur me Koncesionarin të pacënuar, kundrejt palëve të treta, për çdo Humbje të çfarëdo lloji që ka pësuar ose do të pësojë Koncesionari dhe çdo Person i lidhur me Koncesionarin, për arsye të ndonjë dëmtimi ose vdekjeje ose shkatërrimi të ndonjë prone, cënimi të të drejtave të çdo personi në masën që Humbja e tillë lind, ose është pasojë, e akteve, veprimeve dhe/ose mosveprimeve të Autoritetit Kontraktues, me përjashtim të masës që Humbja e tillë është shkaktuar nga, ose i atribuohet neglizhencës ose sjelljes së kundraligjshme me faj të Koncesionarit ose çdo Personi të lidhur me Koncesionarin duke përfshirë, por pa u kufizuar, nënkontraktorët, ose ndonjë Ngjarje e Forcës Madhore ose Emergjence.

Shkeljet

Koncesionari

- 16.3 Koncesionari do të dëmshpërblejë Autoritetin Kontraktues dhe çdo Person të lidhur me Autoritetin Kontraktues dhe do ta mbajë Autoritetin Kontraktues dhe çdo Person të lidhur me Autoritetin Kontraktues të pacënuar, ndaj palëve të treta, për çdo Humbje të çfarëdo lloji që ka pësuar ose do të pësojë Autoriteti Kontraktues dhe çdo Person i lidhur me Autoritetin Kontraktues për arsye të ndonjë shkelje nga ana e Koncesionarit ose përfaqësuesve të tij, të deklarimeve dhe garancive, detyrimeve dhe përgjegjësive që rrjedhin nga kjo Kontratë, me përjashtim të masës që Humbja e tillë është shkaktuar nga, ose i atribuohet neglizhencës ose sjelljes së kundraligjshme me faj të Autoritetit Kontraktues ose çdo Personi të lidhur me Autoritetin Kontraktues, ose ndonjë Ngjarje e Forcës Madhore, Emergjence ose ndonjë Veprimi të Pafavorshëm Material Qeveritar.

Autoriteti Kontraktues

- 16.4 Autoriteti Kontraktues do të dëmshpërblejë Koncesionarin dhe çdo Person të lidhur me Koncesionarin dhe do ta mbajë Koncesionarin dhe çdo Person të lidhur me Koncesionarin të pacënuar ndaj palëve të treta për çdo Humbje të çfarëdo lloji që ka pësuar ose do të pësojë Koncesionari dhe çdo Person i lidhur me Koncesionarin për arsye të ndonjë shkelje nga ana e Autoritetit Kontraktues ose përfaqësuesve të tij, të deklarimeve dhe garancive, detyrimeve dhe përgjegjësive që rrjedhin nga kjo Kontratë, me përjashtim të masës që Humbja e tillë është

shkaktuar nga, ose i atribuohet neglizhencës ose sjelljes së kundraligjshme me faj të Koncesionarit ose të një Personi të lidhur me Koncesionarin, duke përfshirë, por pa u kufizuar, nënkontraktorët, Ngjarje e Forcës Madhore ose Emergjencë.

Shkeljet Mjedisore

- 16.5 Koncesionari do të dëmshpërblejë Autoritetin Kontraktues dhe çdo Person të lidhur me Autoritetin Kontraktues dhe do ta mbajë Autoritetin Kontraktues dhe çdo Person të lidhur me Autoritetin Kontraktues të pacënuar, ndaj palëve të treta për çdo Humbje të çfarëdo lloji që ka pësuar ose do të pësojë Autoriteti Kontraktues ose çdo Person i lidhur me Autoritetin Kontraktues në lidhje me Projektin për cilëndo nga arsyet në vijim (të njohura ose jo):
- (a) Çdo mospërbushje nga ana e Koncesionarit e Legjislacionit të Zbatueshëm mjedisor në fuqi (duke përfshirë por pa u kufizuar në emetimin e jashtëligjshëm të Materialeve të Rrezikshme); dhe
 - (b) Çdo pretendim nga cilido Person për dëmtim të shëndetit, pronës, mirëqënies ose të drejtave si rezultat i emetimit në mjedis të Materialeve të Rrezikshme nga ana e Koncesionarit.

Referencat

- 16.6 Të gjitha referencat në këtë nen ndaj një "Personi të Koncesionarit" do të përfshijnë të gjithë punonjësit, drejtorët dhe oficerët e Koncesionarit.
- 16.7 Të gjitha referencat në këtë nen ndaj një "Person të Autoritetit Kontraktues" do të përfshijnë të gjithë punonjësit e Autoritetit Kontraktues, përfshirë NJZP, dhe Autoriteteve Kompetente.

Procedurat

- 16.8 Nëse Pala e Dëmshpërblyer merr njoftim për ndonjë padie, veprimi, kërkesë, procedim ose hetim të sjellë nga ndonjë Person tjetër përveç Palës Dëmshpërblyese dhe beson me mirëbesim se Pala Dëmshpërblyese mund të jetë e detyruar të sigurojë dëmshpërblimin në përputhje me këtë Kontratë, Pala e Dëmshpërblyer do t'i japë menjëherë Palës Dëmshpërblyese njoftimin me shkrim ("Njoftim për Dëmshpërblim") i cili përcakton në detaje të arsyeshme informacionin e nevojshëm në lidhje me padinë, veprimin, pretendimin, procedimin ose hetimin, që rëndon mbi Palën e Dëmshpërblyer. Dështimi i Palës së Dëmshpërblyer për t'i dërguar Palës Dëmshpërblyese Njoftimin për Dëmshpërblim, nuk do të lehtësojë Palën Dëmshpërblyese për çdo përgjegjësi që mund të ketë ndaj Palës së Dëmshpërblyer përveç në masën që dështimi për të njoftuar e pengon materialisht Palën Dëmshpërblyese në aftësinë e saj për të mbrojtur padinë, veprimin, pretendimin, procedimin ose hetimin për të cilin kërkohet dëmshpërblimi.
- 16.9 Pas marrjes së një Njoftimi për Dëmshpërblim, Pala e Dëmshpërblyer dhe Pala Dëmshpërblyese mund të bien dakord që Pala Dëmshpërblyese do të marrë përsipër mbrojtjen e një padie, veprimi, pretendimi, procedimi ose hetimi.
- 16.10 Nëse Pala e Dëmshpërblyer dhe Pala Dëmshpërblyese bien dakord që Pala Dëmshpërblyese do të marrë përsipër mbrojtjen e çdo padie, veprimi, pretendimi, procedimi ose hetimi për të cilin është thirrur të dëmshpërblejë Palën e Dëmshpërblyer në përputhje me këtë nen, Pala Dëmshpërblyese nuk do të zgjidhë me marrëveshje një padi, veprim, kërkesë, procedim ose hetim të tillë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës së Dëmshpërblyer, përveç nëse Pala e Dëmshpërblyer nuk ka pretendim ose nuk pranon të ketë shkelur ligjin, dhe padia, veprimi, pretendimi, procedimi ose hetimi kanë si objekt kërkimin e një dëmshpërblimi monetar i cili



mbulohet plotësisht nga dëmshpërblimi i Palës Dëmshpërblyese.

- 16.11 Nëse Pala e Dëmshpërblyer dhe Pala Dëmshpërblyese bien dakord që Pala Dëmshpërblyese do të marrë përsipër mbrojtjen e çdo padie, veprimi, pretendimi, procedimi ose hetimi për të cilin është thirrur të dëmshpërblejë Palën e Dëmshpërblyer në përputhje me këtë nen, Pala Dëmshpërblyese do të informojë Palën e Dëmshpërblyer në mënyrë të arsyeshme për ecurinë e çdo padie, veprimi, pretendimi, procedimi ose hetimi. Nëse kërkohet nga Pala Dëmshpërblyese, Pala e Dëmshpërblyer do të bashkëpunojë në masën e kërkuar në mënyrë të arsyeshme në mbrojtjen ose procedimin e çdo padie, veprimi, pretendimi, procedimi ose nxitjeje për të cilën Pala Dëmshpërblyese është thirrur për të dëmshpërblyer Palën e Dëmshpërblyer sipas këtij neni.
- 16.12 Nga shuma e çdo Humbje e cila paguhet si dëmshpërblim sipas këtij neni do të zbritet:
- (a) vlera e çdo përfitimi (përveç përfitimeve nga policat e sigurimit) të realizuar, drejtpërdrejt ose indirekt, në çdo juridiksion nga Pala e Dëmshpërblyer si rezultat i kësaj Humbje;
 - (b) shuma e të ardhurave nga policat e sigurimit të marra nga Pala e Dëmshpërblyer në lidhje me Humbjen. Nëse Pala e Dëmshpërblyer përfiton të ardhura nga policat e sigurimit, Pala e Dëmshpërblyer do t'i paguajë Palës Dëmshpërblyese një shumë të barabartë me vlerën më të vogël midis:
 - (i) shumës së këtyre ardhurave; dhe
 - (ii) shumës së dëmshpërblimit të paguar nga Pala Dëmshpërblyese.
- 16.13 Pala Dëmshpërblyese nuk do t'i paguajë Palës së Dëmshpërblyer asnjë dëmshpërblim në lidhje me fitimin e munguar ose dëmin jo të drejtëpërdrejtë.
- 16.14 Asnjë Pale nuk do të dëmshpërblehet më shumë se një herë për të njëjtën Humbje. Autoriteti Kontraktues nuk do të ngarkojë me përgjegjësi Koncesionarin për asnjë Humbje që mund të jete shkaktuar nga ngjarje, veprime apo mosveprime të ndodhura përpara datës kur bëhet marrja në Dorëzim e Vendndodhjes.
- 16.15 Këto dispozita nga 16.1 në 16.14 do të mbetet në fuqi edhe pas (3) tre vjetesh pas datës së Përfundimit të kësaj Kontrate dhe pavarësisht nga zgjidhja e saj, njëra Palë do t'i kërkojë shumën që i detyrohet Palës tjetër sipas këtij neni, në përputhje me këtë Kontratë, brenda afatit prej (3) tre vjetesh nga Data e Përfundimit të Kontrates.

17. DORËZIMI

Të përgjithshme

- 17.1 Koncesionari do të kryejë në Datën e Mbarimit të Afatit, dorëzimin e rregullt të Vendndodhjes dhe të Aseteve të Aeroportit tek Autoriteti Kontraktues, pa asnjë barrë, peng, apo detyrime ndaj të tretëve, sipas udhëzimeve të Autoritetit Kontraktues tek Operatori Pasardhës që do të hyjë në vend të tij në çdo rast sipas parashikimeve të këtij Neni 17, përfshirë por pa u kufizuar në Kushtet e Dorëzimit dhe Kërkesat e Dorëzimit për Vendndodhjen dhe Asetet e Aeroportit.
- 17.2 Secila Palë do të mbulojë kostot e shpenzimet e saj për transferimin e Vendndodhjes dhe të Aseteve të Aeroportit tek Autoriteti Kontraktues, sipas këtij Neni.
- 17.3 Kur gjatë Periudhës së Dorëzimit vërtetohet një rast apo një ngjarje për të cilën njëra nga Palët ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë sipas Nenit 15, dhe Pala dëshiron të ushtrojë këtë të drejtë,



të drejtat dhe procedura e zgjidhjes së kontratës do të rregullohen sipas Nenit 15.

Plani i Tranzicionit

- 17.4 Jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë përpara Datës së Fillimit të Periudhës së Dorëzimit, Konçesionari do t'i paraqesë Autoriteti Kontraktues për rishikimin dhe miratimin e tij, një draft të planit të plotë të tranzicionit ("**Plani Tranzitor i Dorëzimit**") që parashikon të gjithë përgjegjësitë dhe detyrimet e Konçesionarit për transferimin e Vendndodhjes dhe të Aseteve të Aeroportit tek Autoriteti Kontraktues apo tek Operatori Pasardhës. Plani Tranzitor i Dorëzimit, ndër të tjera, do t'i japë Autoriteti Kontraktues çdo lloj informacioni tjetër (verbal apo të shkruar) që do të kërkohej në mënyrë të arsyeshme nga Garantuesi dhe/apo që në mënyrë të arsyeshme do të jetë i nevojshëm apo duhet për transferimin e Vendndodhjes dhe të Aseteve të Aeroportit tek Autoriteti Kontraktues, apo tek Operatori Pasardhës, sipas rastit.
- 17.5 Autoriteti Kontraktues do të bëjë komentet apo ndryshimet e tij në draftin e Planit Tranzitor të Dorëzimit jo më vonë se tridhjetë (30) ditë përpara Datës së Fillimit të Periudhës së Dorëzimit, dhe Konçesionari do të paraqesë versionin final të Planit Tranzitor të Dorëzimit me këto komente dhe/apo ndryshime tek Autoriteti Kontraktues, jo më vonë se Data e Fillimit të Periudhës së Dorëzimit, me kusht që në rast se Autoriteti Kontraktues nuk bën asnjë koment brenda periudhës prej tridhjetë (30) ditësh, atëherë Autoriteti Kontraktues do të konsiderohet se e ka miratuar Planin Tranzitor të Dorëzimit. Në rast se Autoriteti Kontraktues nuk miraton një pjesë të Planit Tranzitor të Dorëzimit ai do të njoftojë Konçesionarin i cili do ta përgatisë dhe do ta riparaqesë për miratimin e Autoritetit Kontraktues, sa më shpejt që praktikisht të jetë e mundur, planin e rishikuar. Çdo mosmarrëveshje për finalizimin e Planit Tranzitor të Dorëzimit që nuk zgjidhet brenda dhjetë (10) ditëve të punës do të zgjidhet sipas Nenit 21.3. Garantuesi dhe Konçesionari do të bëjnë përpjekjet e tyre të arsyeshme që eksperti i pavarur të marrë një vendim jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas caktimit të tij.

Procesi

- 17.6 Menjëherë pas dorëzimit të draftit të parë të Planit Tranzitor të Dorëzimit por në çdo rast jo më vonë se dyzet (40) ditë përpara Datës së Fillimit të Periudhës së Dorëzimit, Autoriteti Kontraktues do takohet me Konçesionarin që të diskutojnë dorëzimin e rregullt të Vendndodhjes dhe të Aseteve të Aeroportit tek Autoriteti Kontraktues konform Kërkesave të Dorëzimit ("**Takimi për Dorëzimin**"). Qëllimi i Takimit për Dorëzimin është që palët të bien dakord për procedurat e veprimet e detajuara të Procesit të Dorëzimit. Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Konçesionarin për Inxhinierin e Dorëzimit që Autoriteti Kontraktues ka caktuar për mbikqyrjen e Procesit të Dorëzimit, qëllimin e punës së Inxhinierit të Dorëzimit që do të caktohet vetëm nga Autoriteti Kontraktues dhe kostot e Inxhinierit të Dorëzimit do të mbulohen nga Autoriteti Kontraktues. Konçesionari do të përgatisë procesverbalin e Takimit për Dorëzimin dhe do ta paraqesë tek Autoriteti Kontraktues.
- 17.7 Menjëherë pas Takimit për Dorëzimin, por në çdo rast jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara Datës së Fillimit të Periudhës së Dorëzimit, Konçesionari do të sigurojë akses të plotë për Inxhinierin e Dorëzimit, i cili do të inspektojë dhe vlerësojë Vendndodhjen dhe Asetet e Aeroportit ("**Inspektimi Fillestar**"). Inxhinieri i Dorëzimit do të përgatisë një raport të gjetjeve të tij në lidhje me punimet e rinovimit, rindërtimit, riparimet apo rivendosjes në punë ("**Punimet e Rinovimit**"), të cilat kërkohej për tu kryer në Vendndodhje dhe në Asetet e Aeroportit në mënyrë që Vendndodhja dhe Asetet e Aeroportit të jenë kënaqshme për Kushtet e Dorëzimit në Datën e Dorëzimit, si dhe një përlllogaritje të kostove të Punimeve të Rinovimit ("**Kostot e Rinovimit**"), të cilat do ia dorëzojë Konçesionarit dhe Autoritetit Kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur, menjëherë pas Inspektimit Fillestar, por në çdo rast jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas Inspektimit Fillestar. Konçesionari do të ketë një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh nga data e marrjes së këtij raporti, për të ngritur objeksionet e tij, nëse ka

të tilla, në lidhje me Inspektimin Fillestar, Punimet e Rinovimit dhe/ose Kostot e Rinovimit. Në rast se këto objeksione nuk zgjidhen në negociim mes Palëve brenda një periudhe 30 (tridhjetë) ditore, nga data në të cilën objeksionet janë ngritur, atëherë Koncesionari ose Autoriteti Kontraktues, mund ta referojnë çështjet për zgjidhje sipas nenit 21.3. Palët do të përdorin përpjekjet e tyre më të mira dhe të arsyeshme, që eksperti i pavarur të konkludojë jo më vonë se brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga dita e caktimit të tij. Koncesionari ndërkohë do të procedojë me Procesin e Dorëzimit, në përputhje me nenin 17, ndërkohë që Mosmarrëveshja pritet të zgjidhet.

- 17.8 Më pas, Inxhinieri i Dorëzimit do të supervizojë përmbushjen nga Koncesionari të Kërkesave të Dorëzimit përgjatë Procesit të Dorëzimit, duke përfshirë edhe zbatimin e Punimeve të Rinovimit. Koncesionari do të (i) sigurojë akses dhe lehtësi të tillë për Inxhinierin e Dorëzimit, përgjatë orëve normale të punës, në Vendndodhjen dhe Asetet e Aeroportit, ashtu siç kërkohet nga Inxhinieri i Dorëzimit në Mënyrë të arsyeshme, dhe (ii) do të bashkëpunojë maksimumin e mundshëm me Inxhinierin e Dorëzimit, përgjatë të gjithë dhe çdo faze të Procesit të Dorëzimit.
- 17.9 Koncesionari, Autoriteti Kontraktues dhe Inxhinieri i Dorëzimit do të takohen përsëri brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve pas Takimit të Dorëzimit, me qëllim për të finalizuar procedurat e detajuara dhe hapat e Procesit të Dorëzimit. Me pas, Koncesionari, Autoriteti Kontraktues dhe Inxhinieri i Dorëzimit do të takohen rregullisht mbi baza mujore, në tamime të vendosura paraprakisht (në orare të dakordësuara nga Koncesionari dhe Autoriteti Kontraktues) deri në Datën e Dorëzimit, për të diskutuar dhe për të ri-shikuar çdo çështje që mund të dalë, në lidhje me procesin e Dorëzimit dhe/ose përmbushjen e Kërkesave të Dorëzimit. Koncesionari do të përgatisë të gjitha shënimet / procesverbalet e të gjitha takimeve dhe do ja dorëzojë ato Autoritetit Kontraktues.

Kërkesat e Dorëzimit

- 17.10 Koncesionari do të sigurojë Autoritetit Kontraktues të gjithë asistencën e arsyeshme, e cila në opinionin e Autoritetit Kontraktues është e nevojshme për të kënaqur Kërkesat e Dorëzimit. Përveç përgjegjësive të tij, në këtë nen 17, Koncesionari do të jetë përgjegjës për të përmbushur kërkesat e mëposhtme ("Kërkesat e Dorëzimit").

Vendndodhja dhe Asetet e Aeroportit

- 17.11 Në Datën e Dorëzimit, Koncesionari do të dorëzojë dhe transferojë të drejtat e Vendndodhjes dhe Aseteve të Aeroportit tek Autoriteti Kontraktues. Në momentin e këtij transferimi, dhe nga Data e Dorëzimit, Vendndodhja dhe Asetet e Aeroportit do të jenë në përputhje me Kushtet e Dorëzimit.
- 17.12 Koncesionari përgjatë Periudhës së Dorëzimit, do të marrë përsipër me shpenzimet dhe kostot e tij, të zbatojë dhe përfundojë Punimet e Rinovimit, pavarësisht faktit nëse kostot aktuale të Punimeve të Rinovimit tejkalojnë ose jo Kostot e Rinovimit të identifikuar nga Inspektimi Fillestar i Inxhinierit të Dorëzimit.
- 17.13 Përpara ose në datën e Dorëzimit, Koncesionari, dhe Autoriteti Kontraktues do të nënshkruajnë:
- (a) Një apo disa marrëveshje sipas të cilave Pasuritë e Luajtshme të zotëruara nga Koncesionari do t'i transferohen Autoritetit Kontraktues, në Datën e Dorëzimit;
 - (b) Një apo disa marrëveshje apo akte noteriale (lloji i marrëveshjeve do të jetë në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshem),



qilindur të zotëruar nga Koncesionari, sipas të cilave Pasuritë e Paluajtshme të zotëruara nga Koncesionari do t'i transferohen në pronësi Autoritetit Kontraktues, në Datën e Dorëzimit;

(c) Një apo disa marrëveshje ndërmjet Koncesionarit dhe Autoritetit Kontraktues dhe kontraktorëve / nën-kontraktorëve të cilët sigurojnë Shërbimet e Aeroportit, në diskrecion dhe dëshirën e Autoritetit Kontraktues, sipas të cilave çdo kontratë ndërmjet Koncesionarit dhe këtyre kontraktorëve / nën-kontraktorëve, në lidhje me sigurimin e Shërbimeve të Aeroportit, rinovohet apo i transferohet Autoritetit Kontraktues në Datën e Dorëzimit; dhe

(d) Një apo disa marrëveshje ndërmjet Koncesionarit dhe Autoritetit Kontraktues dhe qiramarrësve të Pasurive të Paluajtshme, në diskrecion dhe dëshirën e Autoritetit Kontraktues, sipas të cilave çdo kontratë qiraje ndërmjet Koncesionarit dhe këtyre qiramarrësve, në lidhje me qiratë e Pasurive të Paluajtshme, rinovohet apo i transferohet Autoritetit Kontraktues në Datën e Dorëzimit.

Punonjësit

17.14 Koncesionari do të:

(a) Ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të informuar punonjësit se marrëdhënia e tyre e punës përfundon në Datën e Dorëzimit;

(b) Sigurojë për Autoritetin Kontraktues informacion të mjaftueshëm për ti mundësuar atij, që ti japë oferta për çdo punonjësi që ai dëshiron dhe mund të zgjedhë (në diskrecionin të tij absolut) për ofruar punësim, i cili mund të fillojë pas ose në Datën e Dorëzimit të ngjarjeve të mëtejshme etj. kështu, është sig e mund të bëjnë dakord Autoriteti Kontraktues dhe punonjësi(t);

(c) Ndërmarrë përsëri veprimet e nevojshme për të transferuar tek Autoriteti Kontraktues të punonjësit të punësimit të punësimit të Autoritetit Kontraktues;

(d) Ftojë përgjegjës për të gjitha dhe çdo të drejta nga punësimi, për punonjësit, që janë të përfshirë për punonjësit deri në Datën e Dorëzimit;

(e) Sigurojë për çdo punonjës që transferohet nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, që të dhënat e këtyre punonjësve të jenë mbajtur në mënyrë të rregullt dhe diligente dhe të dorëzohen Autoritetit Kontraktues.

Librat dhe të Dhënat

Në Datën e Dorëzimit, Koncesionari do të kthejë Autoritetit Kontraktues në formë elektronike dhe/ose kopje të printuara, nëse kërkohen në forma të tilla nga Autoriteti Kontraktues, të gjithë informacionin dhe të dhënat, të cilat në mënyrë të arsyeshme janë të nevojshme për të mundësuar operimin e efikas të Aseteve të Aeroportit. Jo më vonë se 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë përpara Datës së Dorëzimit, Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të bien dakord në lidhje me listën e dokumenta dhe të dhëna të cilat do të kthehen Autoritetit Kontraktues.

17.16 Të gjithë informacioni që do të jepet Autoritetit Kontraktues, do të jetë i saktë, gjithëpërfshirës dhe i përditësuar, në çdo aspekt.

Pretendimet e Mungohme

17.17 Vendndodhja e Aseteve të Aeroportit do t'i transferohen Autoritetit Kontraktues nga do pretendim i punonjësit, të cilët nga të gjitha dhe çdo pretendim, apo veprime të palëve të treta.



Garancitë e Kontratës

- 17.18 Koncesionari do t'i transferojë Autoritetit Kontraktues, të gjitha të drejtat e garancive që nuk kanë shkaduar si dhe të gjitha garancitë e nënkontraktorëve dhe furnizuesve, të lidhura me Shërbimet Aeroportuale dhe Asetet e Aeroportit.

Teknologjia dhe njohuritë (knoë-hoë)

- 17.19 Në përputhje me të drejtat e ndonjë pale të tretë, duke përfshirë të drejta prioritare nën këtë Kontratë, Koncesionari do t'i sigurojë Autoritetit Kontraktues (i) një licensë të përvokueshme pa pagesë apo rentë (*royalty free license*) për përdorimin e të gjithë dokumentacionit teknik, duke përfshirë pasurinë intelektuale dhe industriale të VIA-s; dhe (ii) një kopje të të gjithë dokumentacionit teknik, që përfshin specifikimet funksionale, manualët e operimit, proceset e biznesit dhe tabelat përkatëse, të nevojshme për të mbështetur operimin e vazhdueshëm të Aseteve të VIA-s.

Studimi Mjedisor

- 17.20 Koncesionari dhe Autoriteti Kontraktues bashkërisht do të përgatisin një studim mjedisor në lidhje me Vendndodhjen në Periudhën e Dorëzimit. Koncesionari do të jetë përgjegjës: (i) për ndreqjen dhe eliminimin e çdo kontaminimi mjedisor, të identifikuar në këtë studim mjedisor; ose (ii) për të paguar Autoritetit Kontraktues kostos e ndreqjes dhe eliminimit të këtij kontaminimi. Koncesionari bien dakord dhe pranon se nëse një kontaminim mjedisor zbulohet për gjatë 3 viteve pas Datës së Dorëzimit, dhe ky kontaminim atribuohet aktivitetëve përparës të Datës së Dorëzimit, Koncesionari do të jetë përgjegjës i vetëm për këtë kontaminim mjedisor, pa e të absolut për të cilin pr...

Defektet e Fshehura

- 17.21 Koncesionari do të jetë përgjegjës për të korrigjuar çdo defekt të fshehur të Aseteve të Aeroportit, apo çdo pjesë të Aseteve të Aeroportit, të ndërtuara për gjatë 3 (tre) viteve të fundit të Afatit të kësaj Kontrate, dhe ai merr përsipër të ndreqë dhe riparojë këto defekte për çdo kusht dhe kusht apo numrit të defekteve. Koncesionari do të jetë përgjegjës gjithashtu për të ndrequr çdo dëmtim fizik, të shkaktuar nga punimet e Koncesionarit për të riparuar këto defekte, për një periudhë prej 2 (dy) viteve pas Datës së Mbarimit të Afatit. Për qëllim të këtij neni, defektet e fshehur do të thotë çdo defekt, i cili në mënyrë të arsyeshme nuk mund të zbulohet nga autoritetet vërehej nga Autoriteti Kontraktues.

- 17.22 Përpara ose në datën e Dorëzimit, Koncesionari do të dorëzojë të Autoritetit Kontraktues (i) një garanci bankare të përvokueshme në formë dhe përmbajtje të pranueshme dhe të kënaqshme për Autoritetin Kontraktues, për të siguruar garancitë e dhëna nga Koncesionari në seksionin (a) më sipër dhe atyre të nenit 18.4.7, e lëshuar nga një bankë me reputacion dhe e licensuar në Republikën e Shqipërisë dhe e pranueshme për Autoritetin Kontraktues, në favor të Autoritetit Kontraktues, në vlerën e 5% (pesë përqind) të kostove kapitale në total të të gjitha Aseteve të Aeroportit, të ndërtuara për gjatë 3 (tre) viteve të fundit të Afatit të kësaj Kontrate, të vlefshme për një periudhë 3 (tre) vjeçare pas Datës së Mbarimit të Afatit; ose (ii) evidencë të kënaqshme për Autoritetin Kontraktues të policave të sigurimit, për llogari dhe në përfitim të Autoritetit Kontraktues për defektet e fshehura (të specifikuar në paragrafin (a) më sipër) dhe ndreqjen e rregullimit të tyre dhe kontaminimit mjedisor, që atribuohet aktivitetëve përpara datës së Dorëzimit.

Prezantimet e Mundshme

Raporti i Dorëzimit

- 17.23 Jo më vonë se 120 (njëqind e njëzet) ditë përpara Datës së Mbarimit të Afatit, Koncesionari do



të dorëzohet tek Autoriteti Kontraktues një raport që përshkruan për çdo çështje të theksuar në nenet 17.10 - 17.22, veprimet që janë ndërmarrë nga Koncesionari, dhe që kanë qenë të nevojshme për të siguruar përputhshmërinë e tyre me detyrimet e përcaktuara në këto nene. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së këtij raporti, Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të takohen bashkarisht për të rënë dakord mbi veprimet që duhet të merrën dhe programin për të bërë dorëzimet dhe për pranimet. Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari dështojnë të bien dakord brenda 10 (dhjetë) ditësh pas fillimit të diskutimeve, kjo çështje do të referohet për zgjidhje sipas nenit 21.3, për të marrë një vendim. Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të përdorin përpjekjet e tyre më të mirë dhe të arsyeshme, që Eksperti i Pavarur të marrë vendim jo më vonë se 30 ditë pasi ai është caktuar si i tillë.

Përfundimi

- 17.24 Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë përpara Datës së Dorëzimit, Koncesionari dhe Autoriteti Kontraktues së bashku me Inxhinierin e Dorëzimit, do të performojnë një inspektim të Vendndodhjes dhe Aseteve të Aeroportit (“**Inspektimi i Dorëzimit**”). Përpara ose në Datën e Dorëzimit, Autoriteti Kontraktues do të lëshojë në favor të Koncesionarit një Certifikatë të Dorëzimit, në formën e paraqitur në Aneksin 24, e cila çertifikon se gjendja e Vendndodhjes dhe Aseteve të Aeroportit janë në përputhje të plotë me Kushtet e Dorëzimit dhe se Kërkesat e Dorëzimit janë përmbushur (“**Certifikata e Dorëzimit**”), ose ai njofton me shkrim Koncesionarin në lidhje me vendimin e tij për të mos lëshuar Certifikatën e Dorëzimit, duke përcaktuar arsyet për këtë vendim (“**Njoftimi i Refuzimit**”). Autoriteti Kontraktues mund të refuzojë të lëshojë Certifikatën e Dorëzimit, vetëm në rast se: (i) Koncesionari ka dështuar të përfundojë të gjitha Punimet e Rinovimit; ose (ii) Vendndodhja ose Asetet e Aeroportit për çfarëdo arsye nuk përmbushin Kushtet e Dorëzimit; ose (iii) Kërkesat e Dorëzimit nuk janë përmbushur të plota. Nëse Autoriteti Kontraktues nuk lëshon certifikatën e Dorëzimit, apo Njoftimin e Refuzimit brenda afatit të kërkuar, atëherë Certifikata e Dorëzimit do të merret e mirëqenë si e lëshuar, sipas këtij neni.
- 17.25 Çdo Njoftim Refuzimi do të përcaktojë arsyet e qarta dhe detajuara të këtij refuzimi. Koncesionari mundet, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së Njoftimit të Refuzimit, të kontestojë mbi shkaqet të arsyeshme çështjet e ngritura në Njoftimin e Refuzimit, dhe në mënyrë të detajuar dhe të qartë të japë arsyet e kontestimit. Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari bashkarisht do të përdorin përpjekjet e tyre më të mirë dhe të arsyeshme të arrijnë një marrëveshje konsensuale të përbashkët për të gjitha çështjet e ngritura në Njoftimin e refuzimit, por në rast se ata nuk e arrijnë këtë marrëveshje brenda 10 (dhjetë) ditësh nga marrja e kontestimit nga Autoriteti Kontraktues, atëherë secila prej palëve mund ta referojë çështjen tek eksperti i pavarur, sipas nenit 21. Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të përdorin përpjekjet e tyre më të mira dhe të arsyeshme, që eksperti i pavarur të marrë vendim jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë pasi ai është caktuar si i tillë.
- 17.26 Nëse është rënë dakord apo përcaktuar nga eksperti i pavarur që (i) Koncesionari nuk ka përfunduar Punimet e Rinovimit; (ii) Vendndodhja ose Asetet e Aeroportit nuk përmbushin në çdo aspekt Kushtet e Dorëzimit; (iii) Kërkesat e Dorëzimit nuk janë përmbushur tërësisht, atëherë pa paragjykuar të drejtat e tjera të Autoritetit Kontraktues, Koncesionari do të paguajë Autoritetit Kontraktues, një shumë të barabartë me koston e përllogaritur të (A) përfundimit të Punimeve të Rinovimit, (B) prokurimit që Vendndodhja dhe Asetet e Aeroportit të përmbushin të gjitha Kushtet e Dorëzimit, dhe (C) përmbushjen e Kërkesave të Dorëzimit, siç përcaktohen nga eksperti i pavarur (“**Shuma e Dorëzimit**”). Kjo shumë do të bëhet jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pasi shumën të përcaktohet nga eksperti i pavarur. Në rast se Koncesionari nuk bie dakord me Shumën e Dorëzimit, atëherë ai mund ta referojë këtë mosmarrëveshje për zgjidhje në përputhje me nenin 21.

- 17.27 Autoriteti Kontraktues mund të konfiskojë Sigurimin e Kontrates në rast se Koncesionari dështon të paguajë Shumën e Dorëzimit, ashtu siç kërkohet në Nenin 17.

Operatori Pasardhës

- 17.28 Autoriteti Kontraktues mundet në çdo moment përgjatë Periudhës së Dorëzimit, të emërojë një Operator Pasardhës. Në këtë rast, Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Koncesionarin për këtë emërim, duke specifikuar në njoftim emrin e Operatorit Pasardhës dhe pikën e tij të kontaktit përgjatë procesit të Dorëzimit.
- 17.29 Në rast se Operatori Pasardhës emërohet, atëherë të gjitha referencat e Autoritetit Kontraktues në këtë nen 17, do ti aplikohen bashkarisht Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Pasardhës; sidoqoftë dorëzimi i çdo sendi fizik mund ti dorëzohet Autoritetit Kontraktues ose Operatorit Pasardhës, sipas udhëzimeve të Autoritetit Kontraktues.

18. KUFIZIMET E TRANSFERIMIT TEK KONCESIONARI

- 18.1 Koncesionari njofton në kohë Autoritetin Kontraktues lidhur me transaksionin e propozuar dhe i paraqet Autoritetit Kontraktues çdo detaj të kërkuar në mënyrë të arsyeshme prej Autoritetit Kontraktues, në përputhje me detyrimet e mëposhtme:


- 18.2 Koncesionari merr përsipër që:

- (a) Nga Data Efektive deri në Datën e Operimit, transferimi i kuotave / aksioneve apo interesave të Koncesionarit midis Ofertuesve, do të jetë subjekt i miratimit paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues, i cili nuk do të vonohet apo refuzohet në mënyrë të paarsyeshme. Çdo miratim apo refuzim nga Autoriteti Kontraktues do të jepet brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit me shkrim. Në rast mospërgjigjeje të Autoritetit Kontraktues brenda afatit tridhjetë (30) ditor miratimi konsiderohet i dhënë;
- (b) Nga Data Efektive, transferimi i kuotave / aksioneve apo interesave të Koncesionarit tek Persona të tretë, do të jetë subjekt i miratimit paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues, i cili nuk do të vonohet apo refuzohet në mënyrë të paarsyeshme. Në çdo rast ortaku / aksionari i ri do të përmbushë kriteret financiare dhe teknike të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e transferuesit në këtë Kontratë. Çdo miratim apo refuzim nga Autoriteti Kontraktues do të jepet brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit me shkrim. Në rast mospërgjigjeje të Autoritetit Kontraktues brenda afatit tridhjetë (30) ditor, Koncesionari ka të drejtë t'i drejtohet përsëri Autoritetit Kontraktues me kërkesën për miratim. Në rast mospërgjigjeje të Autoritetit Kontraktues brenda një afati të dytë dhjetë (10) ditor, miratimi konsiderohet i dhënë.

- 18.3 Përveç sa parashikohet në paragrafin 18.2.(a), jo më herët se 3 muaj nga Data e Operimit, secili ortak/aksionar mund ti transferojë kuotat/aksionet, apo interesat e tij që mban dhe zotëron tek Koncesionari, tek një Shoqëri e Lidhur me atë ortak/aksionar, duke i dhënë një njoftim Autoritetit Kontraktues, të paktën 20 ditë përpara këtij transferimi.

- 18.4 Koncesionari siguron që çdo përfitues ose cesionar i aksioneve të Koncesionarit apo çdo cesionar i të drejtave ose detyrimeve sipas kësaj Kontrate, nën diskrecionin e arsyeshëm të Autoritetit Kontraktues, aderon në këtë Kontratë ose nënshkruan marrëveshje apo dokumente që mund të kërkohen nga Autoriteti Kontraktues, duke vepruar në mënyrë të arsyeshme, për t'i dhënë efekt të plotë detyrimeve sipas kësaj Kontratë.

- 18.5 Çdo kërkesë e Koncesionarit dhe / ose e ortakeve/aksionareve të tij për transferimin e aksioneve/kuotave apo interesave që pjesëtarët zotërojnë tek Koncesionari, do të shoqërohet



edhe me: (i) dokumentin përkatës së regjistrimit të cesionarit në regjistrin përkatës tregtar; (ii) evidenca që cesionari është në gjendje aktive dhe nuk ndodhet në gjendje paaftësie pagese, procedurë likuidimi, falimentimi, apo shpërndarjeje; (iii) evidenca financiare (bilance të audituara) të 3 viteve të fundit, që demonstrojnë kapacitetin financiar të cesionarit; (iv) evidenca që demonstrojnë kapacitetin teknik të cesionarit; (v) listë të përfituesve fundorë të cesionarit, të cilët zotërojnë direkt apo indirekt, të paktën 25% të kuotave / aksioneve / interesave të Koncesionarit. Në mungesë të këtyre dokumentave dhe evidencave, kërkesa do të konsiderohet e pa-plotë.

19. TRANSFERIMI, KALIMI DHE ZËVËNDËSIMI

Transferimi nga Koncesionari

- 19.1 Koncesionari nuk mund të kalojë apo transferojë (a) këtë Kontratë, apo çdo kontratë apo marrëveshje tjetër të lidhur me të, (b) të drejtat dhe detyrimet e tij të përcaktuara këtu apo në kontratat apo marrëveshjet e tjera të lidhura me këtë Kontratë, (c) apo çdo aset, pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktues. Koncesionari nuk do të transferojë Marrëveshjen e Operimit dhe Mirëmbajtjes dhe as të ndryshoje Operatorin pa miratimin paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues nuk do të vonojë apo refuzojë në mënyrë të paarsyeshme këtë miratim, duke i dhënë përgjigje Koncesionarit në lidhje me këtë kërkesë për miratim, jo më vonë se 40 (dyzet) ditë kalendarike nga dita në të cilën Autoriteti Kontraktues ka marrë kërkesën nga Koncesionari. Miratimi në heshtje nuk do të zbatohet për këtë pikë.

Transferimi nga Autoriteti Kontraktues

- 19.2 Autoriteti Kontraktues nuk mund të transferojë këtë Kontratë apo të drejtat dhe detyrimet e tij, pa aprovimin paraprak të Koncesionarit.

Krijimi i Barrëve Siguruese

- 19.3 Për arsye të financimit të Punimeve, Koncesionari mund të krijojë barrë siguruese mbi të drejtat dhe interesat, në përputhje me, dhe sipas kësaj Kontrate, apo çdo marrëveshjeje tjetër të lidhur me Projektin, në cilën ai është palë, mbi Pasuritë e Paluajtshme dhe asetet e tjera në pronësi të tij, në përputhje me Marrëveshjen e Financimit. Mbajtësi dhe përfituesi i çdo barre siguruese të krijuar nën këtë nen 19.3 nuk do të pengohet nga Autoriteti Kontraktues që të ekzekutojë barrët siguruese, në përputhje me to. Pavarësisht sa më sipër, Koncesionari duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për vendosjen e barrëve siguruese dhe të marrë miratimin e tij paraprak.

Zëvendësimi nga Institucionet Financiare

Shoqëria Zëvendësuese

- 19.4 Palët pranojnë se, në rastin e një mospërmbushjeje nga Koncesionari nën këtë Kontratë, apo nën Marrëveshjen e Financimit, dhe vazhdimin të rastit të mospërmbushjes deri në skadimin e afatit për korrigjim, Institucionet Financiare apo Përfaqësuesit e Institucioneve Financiare, siç mund të jetë rasti, kanë të drejtë të nominojnë një Shoqëri Zëvendësuese për Autoritetin Kontraktues, e cila do të zëvendësojë Koncesionarin.

Kushtet

- 19.5 Përpara këtij zëvendësimi, Institucionet Financiare do të duhen të paraqesin evidenca të mjaftueshme dhe të kënaqshme tek Autoriteti Kontraktues, për Shoqërinë Zëvendësuese që:



- (a) ajo është ligjërishit dhe në formë të vlefshme e themeluar dhe regjistruar si një shoqëri tregtare sipas së drejtës shqiptare, dhe që ka mundësinë dhe kapacitetin për të qenë palë në marrëveshje të tilla, që mund të kërkohen për zëvendësimin;
- (b) ka kapacitetin financiar dhe teknik të mjaftueshëm, për të performuar dhe përfunduar të gjitha detyrimet e Koncesionarit nën këtë Kontratë dhe se ajo i përmbush të gjitha kriteret e përcaktuara në Dokumentat e Tenderit;
- (c) ka kapacitetin të paguajë detyrimet financiare, të cilat Autoriteti Kontraktues ka të drejtë ti marrë nga Koncesionari përpara apo në momentin e këtij zëvendësimi; dhe
- (d) përmbush të gjitha kërkesat ligjore të përcaktuara në Ligj, apo në legjislacionin përkatës për partneritetin publik-privat dhe koncesionet, apo atë për prokurimin publik.

Zëvendësimi

19.6 Institucionet Financiare, apo përfaqësuesit e Institucioneve Financiare, siç mund të jetë rasti, kanë të drejtë të bëjnë efektive zëvendësimin brenda një kohe të arsyeshme pas skadimit të periudhës së korigjimit, ashtu siç mund të përcaktohet aty. Me qëllim kryerjen e këtij zëvendësimi, Institucionet Financiare, apo përfaqësuesit e Institucioneve Financiare, ashtu siç mund të jetë rasti, do të njoftojnë qëllimin e tyre tek Autoriteti Kontraktues dhe do ti japin atij të gjithë informacionin, ashtu sic mund të jetë e nevojshme dhe të kërkohet nga Autoriteti Kontraktues për të verifikuar që kushtet e përcaktuara në këtë nen janë përmbushur. Autoriteti Kontraktues, brenda një kohe të arsyeshme nga ky njoftim, dhe në çdo rast brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve do të informojë Institucionet Financiare apo përfaqësuesit e tyre, në lidhje me pranimin, ose jo, të zëvendësimit, pranim, i cili nuk mund të mos jepet, në rast se kushtet e përcaktuara në këtë nen janë përmbushur.

20. HEQJA DORË NGA IMUNITETI

20.1 Në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, Palët, në mënyrë të përvokueshme dhe të pakushtëzuar, heqin dorë dhe pranojnë se nuk do të ngrejnë pretendime për imunitet për veten, të ardhurat, pasuritë ose pronat respektive, për çdo procedurë lajmërimi, padie, juridiksioni, procesi gjyqësor, arbitrazhi, vendimi të ndërmjetëm, vendimi gjyqësor, ekzekutimi të vendimit. Për të evituar çdo dyshim, heqja dorë nga imuniteti nuk përfshin pasuritë të cilat janë subjekt i parashikimeve të Konventës së Vjenës për marrëdhëniet diplomatike të vitit 1961.

20.2 Palët pranojnë që vendimi përfundimtar i shpallur në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve do të jetë detyrues dhe i ekzekutueshëm nga organet gjyqësore të Republikës së Shqipërisë ose të juridiksonit përkatës i cili ka shpallur vendimin përfundimtar.

21. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

21.1 Palët do të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të zgjidhur me mirëbesim çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga apo lidhet me këtë Kontratë (përfshirë çdo pretendim për ekzistencën, vlefshmërinë ose zgjidhjen e saj). Pala që ngre pretendimin mbi mosmarrëveshjen njofton fillimisht përfaqësuesin ligjor të Palës tjetër. Palët do të takohen në mirëbesim brenda pesëmbëdhjetë (15) Ditëve Pune që nga data e parashtrimit të mosmarrëveshjes për të zgjidhur mosmarrëveshjen.

21.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lind në lidhje me parashikimet e Neneve 7.8, 11.10, 12 në lidhje me Punimet e Ndërtimit dhe çdo Mosmarrëveshje sipas Nenit 10.2 (përveç atyre mbi Defektet sipas Nenit 10.4) të cilat nuk mund të zgjidhet miqësisht me mirëbesim brenda tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së kërkesës me shkrim të njëres Palë drejtuar tjetrës për zgjidhje miqësore të Mosmarrëveshjes, kjo problematike mund ti njoftohet Inxhinierit të Pavarur nga



secila prej Palëve, vendimi i së cilit do të jetë i apelueshëm nga secila prej Palëve, në përputhje me nenin 21.3.

- 21.3 Në rast të mos arritjes së një zgjidhjeje sipas pikës 21.1 dhe 21.2 më lartë, Palët do të referojnë të gjitha mosmarrëveshjet në një proces ndërmjetësimi të padetyrueshëm si një kusht paraprak për çdo procedurë tjetër të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Koncesionari dhe Autoriteti Kontraktues do të bien dakord bashkërisht për emërimin e një ndërmjetësi brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas njoftimit me shkrim nga Pala që ngrenë pretendimin mbi mosmarrëveshjen. Në rast se Palët nuk arrijnë të bien dakord në lidhje me përzgjedhjen e një ndërmjetësi apo nëse ndërmjetësi i përzgjedhur refuzon detyrën, atëherë Pala që ngre pretendimin mbi mosmarrëveshjen ka të drejtë të referojë çështjen në procedurë arbitrazhi sipas paragrafit 23.3. Ndërmjetësi duhet të ketë eksperiencën dhe ekspertizën e duhur për të ndërmjetësuar çështje komplekse të lidhura me aspekte të punimeve ndërtimore dhe/ose çështjeve operacionale të menaxhimit të aeroportëve ose të ngjashme, dhe duhet të zotërojë në mënyrë profesionale gjuhën angleze. Te gjitha bisedimet dhe negociatat, pjesë e ndërmjetësimit, do të mbahen konfidenciale, do të zhvillohen në gjuhën angleze dhe nuk do të delegohen tek ndonjë procedurë tjetër, paralele ose të mëpasshme, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes deri sa të përfundojnë me një marrëveshje të ligjshme dhe detyruese. Në rast se Koncesionari dhe Autoriteti Kontraktues pranojnë rekomandimet e ndërmjetësuesit apo arrijnë një marrëveshje bilaterale për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, kjo marrëveshje do të formulohet me shkrim dhe, pasi të nënshkruhet nga përfaqësuesit e të dy Palëve, do të jenë detyruese për Koncesionarin dhe Autoritetin Kontraktues. Te dy Palët do të ndajnë proporcionalisht shpenzimet e ndërmjetësimit, por do të përballojnë secili me vehte kostot për përgatitjen e tyre për, dhe pjesëmarrjen në, këtë proces ndërmjetësimi. Në rast se Palët nuk arrijnë një marrëveshje brenda 30 ditëve pas emërimit të ndërmjetësuesit atëherë secila palë mund të paraqesë mosmarrëveshjen për zgjidhje me procedurë arbitrazhi sipas paragrafit 23.3 me poshtë.
- 21.4 Te gjitha mosmarrëveshjet që lidhen dhe janë rezultat i kësaj Kontrate, të cilat nuk zgjidhen sipas paragrafëve 21.3 më lart, do t'i nënshtrohen procedurës së arbitrazhit sipas rregullave dhe procedurave përkatëse të arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (Rregullat e ICC). Gjykata e arbitrazhit do të përbehet nga një ose më shumë arbitra të përzgjedhur sipas Rregullave të ICC dhe vendi i arbitrazhit do të jetë Londra dhe gjuha e procedurave të arbitrazhit do të jetë gjuha angleze.
- 21.5 Për efekt qartësie, lindja e çdo mosmarrëveshjeje apo vazhdimi i procedurave të zgjidhjes së mosmarrëveshjes nuk do të cenojë detyrimet e Palëve, përfshirë detyrimet për kryerjen e pagesave në zbatim të kësaj Kontrate. Një shumë do të konsiderohet e kërkueshme dhe do të paguhet plotësisht në pritje të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Rakordimi i shumave të paguara do të kryhet menjëherë pas dhe bazuar në zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes.

22. **LIGJI RREGULLUES**

Kjo Kontratë dhe çfarëdo mosmarrëveshje apo pretendim që rrjedh nga apo lidhet me të (duke përfshirë pretendimet jashtëkontraktuale) rregullohet nga dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.



23. **NJOFTIMET**

- 23.1 Çdo njoftim apo komunikim ndërmjet Palëve në lidhje me këtë Kontratë duhet të kryhet në formë të shkruar, dhe konsiderohet i dorëzuar nëse dorëzohet personalisht, me postë rekomandë të parapaguar, me korrier në adresën e Palës tjetër e cila jepet më poshtë, me faks (me marrje të konfirmimit të transmetimit) në numrin e faksit të Palës tjetër, ose postë elektronike në adresën e marrësit ose (sipas rastit), me kusht që, nëse nuk është dhënë adresë postare apo poste elektronike dhe/ose numri faks për marrjen e njoftimeve, këto njoftime nuk do të dorëzohen

nëpërmjet këtyre mënyrave të komunikimit.

23.2 Adresat për dërgim e Palëve do të jenë ato të dhëna më poshtë, ose një adresë tjetër që çdo Palë mund t'ia njoftojë me shkrim Palës tjetër për këtë qëllim.

(a) Për Koncesionarin”

[ADRESA]

[EMAIL]

[FAX]

(b) Për Autoriteti Kontraktues

[ADRESA]

[EMAIL]

[FAX]

23.3 Një njoftim do të konsiderohet se është marrë:

(a) Në momentin e marrjes, nëse dorëzohet personalisht;

(b) Në Ditën e tretë të Punës pas datës së postimit nëse dërgohet me postë rekomande të parapaguar;

(c) Pas marrjes së konfirmimit të dorëzimit nëse dërgohet me transmetim faksimil;

(d) Në rastin e dërgesës me postë elektronike, në momentin e mbërritjes në serverin e marrësit dhe nëse dërguesi nuk merr mesazh që ka ndodhur gabim.

23.4 Çdo njoftim që konsiderohet si i marrë në një ditë që nuk është Ditë Pune, apo pas orës 17:00 me orën lokale në vendndodhjen e marrësit në një Ditë Pune, do të konsiderohet se është marrë në orën 09:00 me orën lokale në vendndodhjen e marrësit në Ditën e nesërme të Punës.

23.5 Të gjitha njoftimet, korrespondencat ose komunikimet e tjera ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit në lidhje me këtë Kontratë ose në lidhje me Projektin do të jenë në gjuhën shqipe.

24. DISPOZITA TË NDRYSHME

24.1 Kjo Kontratë rregullon të gjitha veçoritë dhe të gjitha marrëdhëniet kontraktuale në lidhje me Projektin. Secila prej Palëve do të sigurohet që nënshkrimi pas Datës së Nënshkrimit i çdo marrëveshje tjetër që lidhet me Projektin nuk do të sjellë si pasojë mospërbushjen nga ajo Palë e detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate.

24.2 Kjo Kontratë, duke përfshirë Shtojcat e saj dhe Ofertën detyruese të Ofertuesve, përbëjnë të gjithë Kontratën midis Palëve në lidhje me Projektin dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme, të lidhura me shkrim ose me gojë ndërmjet Palëve në lidhje me Projektin.

24.3 Në lidhje me shkëmbime të informacionit konfidencial, Pala marrëse do të mbajë konfidencial dhe nuk do t'i bëjë publik, pa miratimin paraprak me shkrim të Palës dhënëse, të gjitha



vizatimet, regjistrat, të dhënat, bilancet, raportet, dokumentet dhe informacionet konfidenciale, qoftë me natyrë teknike, tregtare apo financiare, që i janë dhënë nga ose në emër të Palës dhënëse në lidhje me Projektin, me përjashtim të sa më poshtë:

- (a) që aktualisht apo në të ardhmen bëhet publik përveç rastit kur bëhet publik si rezultat i shkeljes së detyrimit të konfidencialitetit, ose që mund të merret nga burime të tjera përveç Palëve;
- (b) kur dhe në masën e kërkuar nga Legjislacioni i Zbatueshëm për t'ju dhënë çdo personi të autorizuar nga Legjislacioni i Zbatueshëm për ta marrë atë;
- (c) kur dhe në masën e kërkuar për t'u dhënë nga rregullat e ndonjë burse të njohur në të cilën aksionet e Palës që jep informacionin janë apo propozohen për kuotim apo listim herë pas here;
- (d) kur dhe në masën e kërkuar për t'u dhënë në një gjykatë, arbitër apo gjykatë administrative gjatë procedurave para saj në të cilat Pala që jep informacionin është palë;
- (e) që njëra Palë i jep Inxhinierit të Pavarur, një zyrtari apo punëmarrësi të saj ose një Shoqërie të Lidhur apo zyrtar ose punëmarrësi të Shoqërisë së Lidhur të cilët e kërkojnë informacionin për t'i mundësuar kryejën e duhur të detyrave të tyre, me kusht që këta persona të zbatojnë detyrimet e konfidencialitetit njëjloj me ato që parashikohen në këtë nen 20;
- (f) që njëra Palë i jep ndonjerit prej konsulentëve, bankave, financierëve, siguruesve ose këshilltarëve të saj ose ndonjërës prej Shoqërive të lidhura apo konsulentëve, bankave, financierëve, siguruesve ose këshilltarëve të Shoqërisë së lidhur, me kusht që këta persona të zbatojnë detyrimet e konfidencialitetit njëjloj me ato që parashikohen në këtë nen 24.3;
- (g) që Koncesionari i jep një investitori të mundshëm në mirëbesim, ose një blerësi të mundshëm në mirëbesim të aksioneve të Koncesionarit (ose konsulentëve, bankave, financierëve ose këshilltarëve të tyre profesionalë), me kusht që këta persona të zbatojnë detyrimet e konfidencialitetit njëjloj me ato që parashikohen në këtë nen 24.3; ose

Për shmangien e dyshimit, secila Palë do të jetë përgjegjëse për çdo shkelje të detyrimit të konfidencialitetit sipas këtij neni 24.3.

- 24.4 Kjo Kontratë ose ndonjë prej dispozitave të saj mund të ndryshohet vetëm pas miratimit me shkrim të të dyja Palëve, dhe duke nënshkruar instrumentin përkatës (aneksin), i cili bëhet pjesë e pandarë dhe përbërëse e Kontratës vetëm pas miratimit dhe nënshkrimit nga të dyja Palët.
- 24.5 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu Palët të lidhin këtë Kontratë.
- 24.6 Në rast se një apo disa nga dispozitat që përmbahen në këtë Kontratë, apo në çdo instrument tjetër të cilit i referohemi këtu, do të konsiderohet, për çdo arsye, e pavlefshme, e paligjshme ose e pazbatueshme në çdo aspekt, atëherë deri në kufirin maksimal të lejuar nga Legjislacioni i Zbatueshëm, kjo pavlefshmëri, paligjshmëri apo pazbatueshmëri nuk do të ndikojë në ndonjë dispozitë tjetër të kësaj Kontrate apo të ndonjë instrumenti tjetër dhe Palët do të zgjidhin me mirëkuptim ndreqjen e kësaj dispozite në një mënyrë që ajo të mos jetë e pavlefshme, e paligjshme apo e pazbatueshme.

- 24.7 Në rastet kur njëra Palë i jep Palës një periudhë falje, lehtësie ose shtyrje afati, ose nuk zbaton apo nuk ushtron ndonjë prej të drejtave ose mjeteve të saj ligjore, ose vonon të veprojë si më lart, të drejtat dhe mjetet ligjore të asaj Palë lidhur me këtë Kontratë nuk pakësohen, ose nuk shuhen në asnjë rast.
- 24.8 Asnjëra prej Palëve nuk konsiderohet sikur heq dorë nga ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate, përveçse kur një heqje dore e tillë bëhet shprehimisht me shkrim. Mungesa e këmbënguljes nga secila prej Palëve për të përmbushur në mënyrë korrekte secilën prej dispozitave të kësaj Kontrate, apo për të përfituar nga secila prej të drejtave të saj, sipas kësaj Kontrate, nuk interpretohet si heqje dorë nga një dispozitë e tillë, ose heqje dorë nga të drejta të tilla në të ardhmen.
- 24.9 Palët në çdo kohë bëjnë të gjitha veprimet e tjera dhe nënshkruajnë dhe dorëzojnë çdo akt dhe dokument tjetër që konsiderohet i nevojshëm për të përmbushur dhe zbatuar dispozitat e kësaj Kontrate. Kjo Kontratë është bërë ekskluzivisht për përfitimet e Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit dhe asnjë palë e tretë nuk do të ketë ndonjë të drejtë më poshtë ose do të konsiderohet të jetë përfituese e kësaj, përveç kur parashikohet shprehimisht këtu.
- 24.10 Përveç dhe në masën e përcaktuar specifikisht në këtë Kontratë, asnjë Palë nuk do të ketë të drejtë për ndonjë të drejtë tjetër dëmshpërblimi ose për ndonjë të drejtë tjetër sipas Kontratës, në lidhje me ndonjë shkelje ose mospërmbushje sipas kësaj Kontratëje nga Pala tjetër.
- 24.11 Kjo Kontratë është hartuar në katër (4) kopje në gjuhën shqipe dhe katër (4) kopje në gjuhën angleze. Në rast mospërputhjeje midis versionit në gjuhën shqipe dhe atij në gjuhën angleze do të ketë përparësi versioni në gjuhën angleze.



FAQJA E NENSHKRIMIT

Per Autoritetin Kontraktor

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
së Republikës së Shqipërisë

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

Per Konsorciumin

MABCO CONSTRUCTIONS SA,

YDA INSAAT SANAYI VE TICARET ANONİM ŞİRKETİ

2A GROUP SH.P.K

Përfaqësuar me Prokurë nga:

VALON LLUKA

Për Koncesionarin

VALON LLUKA

Përfaqësuar nga:

✓ Datë:

15.06.2024